



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Numër | 07

Korrik | 2015

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 7

BOTUES © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

Faqja e internetit www.bqk-kos.org

Adresa elektronike economic.analysis@bqk-kos.org

KRYEREDAKTOR Arben MUSTAFA

REDAKTOR Albulena XHELILI

AUTORË Krenare MALOKU
Hana GAFURRI
Taulant SYLA
Zana GJOCAJ
Bejtush KIÇMARI

REDAKTOR TEKNIK Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
ASK	Agjencia e Statististikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl.: Capital Adequacy Ratio</i>)
CIS	Commonwealth of Independent States
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (<i>angl.: European Bank for Reconstruction and Development</i>)
ECB	Banka Qendrore Evropiane (<i>anglisht: European Central Bank</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Financave
NIM	Margjina Neto e Interesit (<i>angl.: Net Interest Margin</i>)
NPL	Kreditë joperformuese (<i>angl.: Non-Performing Loans</i>)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomu i Kosovës
OECD	Organizata për Bashkpunim Ekonomik dhe Zhvillim (<i>anglisht: Organization for Economic Cooperation and Development</i>)
OJSHEF	Organizatrat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (<i>angl.: Rule of Law Index</i>)
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl.: Return on Average Assets</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl.: Return on Average Equity</i>)
ROE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl.: Return on Average Equity</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl.: Risk Weighted Assets</i>)
SDR	Të Drejtat Speciale të Tirazhit (<i>angl.: Special Drawing Rights</i>)
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
 Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2015),
 Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 7, Prishtinë: BQK.
 Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në verzionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	11
2. Përmbledhje -----	13
3. Mjedisi i jashtëm ekonomik-----	16
4. Ekonomia e Kosovës -----	22
5. Sistemi Financiar i Kosovës-----	25
5.1. Karakteristikat e Përgjithshme -----	25
5.2 Ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm -----	27
6. Sektori Bankar i Kosovës -----	29
6.1 Struktura e Sektorit Bankar -----	29
6.2. Aktiviteti i Sektorit Bankar -----	30
6.3. Performanca e Sektorit Bankar -----	43
6.4 Rreziqet e Sektorit Bankar -----	47
6.5. Analiza Stres-Test-----	61
6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë-----	66
7. Sektori Pensional -----	70
7.1 Struktura e Sektorit Pensional -----	70
7.2. Performanca e Sektorit Pensional-----	71
8. Sektori i Sigurimeve-----	72
8.1 Struktura e Sektorit të Sigurimeve -----	72
8.2. Aktiviteti i Sektorit të Sigurimeve -----	73
8.3. Performanca e Sektorit të Sigurimeve-----	74
9. Sektori Mikrofinanciar dhe Ndihmësit Financiar-----	76
9.1. Aktiviteti i Sektorit Mikrofinanciar -----	76
9.2. Performanca e Sektorit Mikrofinanciar -----	78
9.3 Ndihmësit Financiar-----	79
10. Shtojca statistikore -----	80
11. Referencat-----	98

LISTA E FIGURAVE	16
Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rificancimit e ECB-së	16
Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude'	17
Figura 3. Struktura e aseteve të ProCredit Holding	18
Figura 4. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave te ProCredit Holding	18
Figura 5. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave dhe ROE dhe CAR të ProCredit Holding	19
Figura 6. Struktura e aseteve të Raiffeisen Bank International	19
Figura 7. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave te Raiffeisen Bank International	20
Figura 8. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave dhe ROE CAR të Raiffeisen Bank International	20
Figura 9. Struktura e aseteve të NLB Group	20
Figura 10. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave te NLB Group	21
Figura 11. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave, ROE dhe CAR të NLB Group	21
Figura 12. Rritja Reale e PBB-së	22
Figura 13. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij	22
Figura 14. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar	23
Figura 15. Ndryshimi vjetor i aseteve të sistemit financiar dhe sektorëve përkatës	25
Figura 16. Struktura e aseteve të sistemit financiar	25
Figura 17. Norma e ndërmjetësimit financiar sipas sektorëve ndaj PBB-së	26
Figura 18. Norma e ndërmjetësimit financiar të sektorit bankar ndaj PBB-së	26
Figura 19. Struktura e kërkesave të jashtme	27
Figura 20. Struktura e detyrimeve të jashtme	27
Figura 21. Asetet e jashtme neto sipas institucionieve financiare	28
Figura 22. Ekspozimi në kuadër të aseteve dhe detyrimeve	28
Figura 23. Struktura e aseteve të bankave komerciale	29
Figura 24. HHI për asete, kredi dhe depozita	29
Figura 25. Struktura e aseteve të sektorit bankar	30
Figura 26. Rritja vjetore e aseteve të sektorit bankar	30
Figura 27. Struktura e letrave me vlerë	31
Figura 28. Kontributi në rritjen e kredive sipas sektorëve	32
Figura 29. Rritja vjetore e kredive të reja dhe gjithsej kredive	32
Figura 30. Kreditë e reja sipas sektorëve	32
Figura 31. Rritja vjetore e kredive të reja	33
Figura 32. Kategoritë kryesore të kredive të reja	33
Figura 33. Gjithsej kreditë, kreditë e reja, kreditë e paguara dhe kreditë e pakthyera	33
Figura 34. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike	35
Figura 35. Struktura e kredive te sektorit te industrisë sipas nënkategorive	35
Figura 36. Ndryshimi vjetor në kreditë sipas sektorëve ekonomik	36
Figura 37. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit	37
Figura 38. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit	37

Figura 39. Struktura e maturimit të kredive sipas veprimtarisë ekonomike-----	37
Figura 40. Struktura e depozitave dhe rritja vjetore -----	38
Figura 41. Struktura e depozitave të ndërmarrjeve sipas sektorëve -----	39
Figura 42. Depozitat e jo-rezidentëve dhe norma e interesit në depozita -----	39
Figura 43. Struktura e depozitave sipas maturimit -----	40
Figura 44. Struktura e depozitave të afatizuara -----	40
Figura 45. Mesatarja e normave të interesit -----	41
Figura 46. Normat mesatare të interesit në kredi për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -----	41
Figura 47. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve-----	41
Figura 48. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve-----	42
Figura 49. Normat mesatare të interesit në kredi sipas veprimtarisë ekonomike -----	42
Figura 50. Normat mesatare të interesit në depozita për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -	42
Figura 51. Profiti neto, të hyrat dhe shpenzimet -----	43
Figura 52. Struktura e përgjithshme e të hyrave -----	43
Figura 53. Struktura e të hyrave sipas kategorive -----	44
Figura 54. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive-----	44
Figura 55. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive-----	44
Figura 56. Rritja vjetore e shpenzimeve sipas kategorive kryesore-----	45
Figura 57. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive -----	45
Figura 58. Rritja vjetore e provizioneve për humbjet e kredive dhe kredive joperormuese -----	46
Figura 59. Treguesit e profitabilitetit -----	46
Figura 60. Raporti shpenzime/të hyra -----	46
Figura 61. Harta e rreziqeve të sektorit bankar -----	47
Figura 62. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar -----	48
Figura 63. Raporti mjete likuide 'gjithëpërfshirëse'/ detyrime afatshkurtëra -----	49
Figura 64. Rezervat e sistemit bankar-----	49
Figura 65. Hendeku i likuiditetit -----	49
Figura 66. Raporti NPL/gjithsej kreditë-----	50
Figura 67. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve-----	51
Figura 68. NPL-të sipas sektorëve -----	51
Figura 69. Struktura e kredive sipas klasifikimit-----	51
Figura 70. Ecuria e kredive sipas klasifikimeve kreditore-----	52
Figura 71. NPL-të dhe provizionet-----	52
Figura 72. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	52
Figura 73. Kapitalizimi i sistemit bankar -----	53
Figura 74. Kapitali rregullativ dhe RWA-të -----	54
Figura 75. Struktura e kapitalit rregullativ të sistemit bankar-----	54
Figura 76. Struktura e kapitalit të klasit të parë -----	55
Figura 77. Struktura e kapitalit të klasit të dytë-----	55
Figura 78. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut-----	56

Figura 79. Raporti i RWA-ve ndaj gjithsej mjeteve të sektorit -----	56
Figura 80. Pozicionet e hapura në valutëtëhuaj ndaj Kapitalit të Klasit të Parë-----	57
Figura 81. Kreditë dhe detyrimet në valutë të huaj-----	57
Figura 82. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	58
Figura 83. Hendekui mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit -----	58
Figura 84. Struktura e investimeve të fondeve pensionale-----	70
Figura 85. Mjetet nën menaxhimin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës -----	70
Figura 86. Mjetetnën menaxhimin e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve-----	71
Figura 87. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit -----	72
Figura 88. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit -----	73
Figura 89. Detyrimet dhe ekuiteti i kompanive të sigurimit -----	73
Figura 90. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	74
Figura 91. Asetet e institucioneve mikrofinanciare -----	76
Figura 92. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve-----	76
Figura 93. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve ekonomik -----	76
Figura 94. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit -----	77
Figura 95. Struktura e lizingut të IMF-ve sipas sektorëve -----	77
Figura 96. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve -----	77
Figura 97. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve sipas sektorëve -----	78

LISTA E TABELAVE ----- 26

Tabela 1. Numri i institucioneve financiare -----	26
Tabela 2. Struktura e asetëve të sektorit bankar-----	31
Tabela 3. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar -----	38
Tabela 4. Tregues kyç të efikasitetit të sektorit bankar-----	47
Tabela 5. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar-----	47
Tabela 6. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë -	59
Tabela 7. Rezultatet e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë-----	61
Tabela 8. Përmbledhje e rezultateve të stres- testit: rreziku kreditor -----	64
Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku i likuiditetit -----	65
Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së ----	67
Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar -----	68
Tabela 12. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela -----	68
Tabela 13. Struktura e fondeve pensionale sipas pronësisë -----	70
Tabela 14. Depërtimi dhe densiteti i sektorit të sigurimeve të vendeve të rajonit-----	72
Tabela 15. Bruto primet e arkëtuara -----	74
Tabela 16. Dëmet e paguara -----	74
Tabela 17. Treguesit shtesë të efikasitetit të sektorit -----	79

LISTA E KUTIVE ----- 18

Kutia 1. Performanca e grupeve kryesore bankare që operojnë në Kosovë-----	18
Kutia 2. Kreditë e reja -----	32
Kutia 3. Anketa mbi Kreditimin Bankar -----	34
Kutia 4. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë -----	59

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Sistemi financiar i Kosovës vazhdoi të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë edhe gjatë pjesës së dytë të vitit 2014. Rreziqet ndaj të cilave ekspozohet sistemi financiar në përgjithësi vazhdojnë të jenë të mirë menaxhuara, përderisa performanca financiare në të gjithë sektorët përbërës është përmirësuar. Stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik, i manifestuar me normë pozitive të rritjes ekonomike, si dhe qëndrueshmëri në rrafshin fiskal dhe atë të çmimeve, vazhdon të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Varësia e lartë e ekonomisë në mallra të importuara ka bërë që niveli i përgjithshëm i çmimeve të ndikohet nga trendet në rënie të çmimeve globale, të cilat kanë ndikuar që norma e inflacionit në Kosovë të jetë mjaft e ulët. Kosova vazhdon të ketë pozicion të qëndrueshëm fiskal, të shprehur me normë të ulët të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Për vitin 2015, parashikimet e BQK-së sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të ketë përshpejtim të rritjes ekonomike, në të cilën zgjerimi i mëtejshëm i kreditimit bankar pritet të ketë kontribut të rëndësishëm.

Aktiviteti kreditues i sektorit bankar është rimëkëmbur në vitin 2014 pas ngadalësimit të rritjes që shënoi në dy vitet paraqake. Ndikim të rëndësishëm në përshpejtimin e rritjes së aktivitetit kreditues ka pasur lehtësimi i standardeve kreditore dhe përmirësimi i kushteve të kreditimit nga ana e bankave, përderisa edhe kërkesa për kredi ka shënuar rritje. Rritja e aktivitetit kreditues në vend është financuar kryesisht nga rritja e depozitave të mbledhura brenda vendit. Gjatë vitit 2014, sektori bankar u karakterizua me zvogëlim të konsiderueshëm të normës së interesit në kredi, që është paraprirë edhe nga zvogëlimi i normës së interesit në depozita. Zvogëlimi i kostos së financimit bankar paraqet një zhvillim shumë të favorshëm për ekonominë e vendit, duke qenë se lartësia e normave të interesit shpeshherë ishte vlerësuar si një pengesë e rëndësishme për zhvillimin e aktivitetit afarist në vend. Prandaj, zvogëlimi i kostos së financimit pritet të reflektohet në një aktivitet më të madh afarist në vend dhe, rrjedhimisht, të krijojë kushtet edhe për zgjerim të mëtejshëm të shkallës së ndërmjetësimit financiar. Treguesit e shëndetit financiar vazhdojnë të reflektojnë shkallën e lartë të qëndrueshmërisë që ka sektori bankar i Kosovës, i cili po vazhdon të ketë pozicion të kënaqshëm likuiditeti, nivel të lartë kapitalizimi, si dhe cilësi të mirë të portofolit kreditor.

Rritje e aktivitetit u shënuar edhe në kuadër të sektorëve tjerë financiar, përfshirë sektorin pensional, sektorin e sigurimeve, sektorin e institucioneve mikrofinanciare, si dhe atë të ndihmësve financiar. Sektori pensional vazhdoi të shënojë performancë të mirë financiare, duke shënuar rritje të çmimit të aksionit në mjetet e investuara dhe, rrjedhimisht, kthim pozitiv nga investimet. Ndërsa, me performancë më të dobët financiare vazhdon të karakterizohet sektori i sigurimeve, i cili megjithatë ka zvogëluar humbjet në krahasim me vitin e kaluar.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë e përkushtuar për avancimin e infrastrukturës që siguron ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Në këtë drejtim, përveç avancimit në fushën e rregullativës dhe mbikëqyrjes mikroprudenciale, BQK-ja ka filluar edhe zhvillimin e politikës për mbikëqyrje makroprudenciale, e cila paraqet një mjet shumë të rëndësishëm për fuqizimin e kapaciteteve të nevojshme për sigurimin e stabilitetit financiar.

Bedri Hamza

Guvernator

2. Përmbledhje

Ekonomia globale gjatë vitit 2014 u karakterizua me rritje të aktivitetit ekonomik. Përmirësimi i aktivitetit ekonomik është përkthyer edhe në përmirësim të ciklit kreditor në eurozonë, ku gjatë vitit 2014, kreditimi i sektorit privat ka shënuar një rritje modeste të bazuar kryesisht në rritje të kërkesës për financim të investimeve fikse të ndërmarrjeve si dhe lehtësim të standardeve kreditore nga bankat. Rënia e vazhdueshme e e çmimeve në tregjet ndërkombëtare u reflektua edhe në eurozonë e cila, në dhjetor 2014, u karakterizua me normë të ulët të inflacionit prej 0.5 përqind. Në rajonin e eurozonës pritet përforsim i mëtejme i aktivitetit ekonomik, mbështetur kryesisht në rënien e mëtejme të çmimeve të naftës, rritjen e besueshmërisë së konsumatorëve dhe zhvillimet pozitive në tregjet e punës. Gjithashtu, rritja e vazhdueshme e eksporteve të eurozonës si rezultat i zhvlerësimit të euros si dhe programi i lehtësimit sasior nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) pritet të kenë ndikim pozitiv në aktivitetin ekonomik.

Evropa Juglindore gjatë vitit 2014 u karakterizua me performancë më të dobët të aktivitetit ekonomik krahasuar me vitin paraprak. Ngjashëm me vendet e eurozonës, presionet deflacioniste ishin të pranishme edhe në vendet rajonit gjatë vitit 2014. Përkundër performancës më të dobët të aktivitetit ekonomik, vendet e rajonit gjatë vitit 2014 shënuan rritje të ndërmjetësimit financiar. Me përjashtim të Malit të Zi që shënoi rënie të kreditimit, të gjitha vendet e tjera u karakterizuan me përsheptim të rritjes së kredive. Vendet e rajonit të Evropës Juglindore gjithashtu shënuan përmirësim të portfolios kreditore me përjashtim të Bosnje dhe Hercegovinës dhe Maqedonisë të cilat raportuan rritje të kredive jo-performuese gjatë vitit 2014. Për vitin 2015, FMN dhe Banka Botërore parashikojnë një përsheptim të rritjes ekonomike në rajonin e Evropës Juglindore.

Ekonomia e Kosovës edhe gjatë vitit 2014 u karakterizua me stabilitet të përgjithshëm makroekonomik, të manifestuar me normë pozitive të rritjes ekonomike, si dhe qëndrueshmëri në rrafshin fiskal dhe atë të çmimeve. Gjatë vitit 2014, rritja reale e aktivitetit ekonomik sipas vlerësimeve preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës ishte 0.9 përqind. Varësia e lartë e ekonomisë në mallra të importuara ka bërë që niveli i përgjithshëm i çmimeve të ndikohet nga trendet në rënie të çmimeve globale, të cilat kanë ndikuar që norma e inflacionit në Kosovë të jetë mjaft e ulët. Kosova vazhdon të ketë pozicion të qëndrueshëm fiskal, të shprehur me normë të ulët të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Për vitin 2015, parashikimet e BQK-së sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të përsheptojë ritmin e rritjes mbështetur në pritjet për rritjen e kërkesës së brendshme dhe investimeve. Parashikimet pozitive mbështeten edhe në kontributin e rëndësishëm të rritjes së kreditimit bankar.

Sistemi financiar i Kosovës, gjatë vitit 2014, është karakterizuar me zgjerim të aktivitetit dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Aktiviteti kreditues i sektorit bankar është rimëkëmbur pas ngadalësimit të rritjes që shënoi në dy vitet paraprake, duke përforsuar kështu rolin e sektorit bankar në financimin e aktivitetit ekonomik në vend. Vlera e gjithsej kredive deri në dhjetor 2014 arriti në 1.88 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.2 përqind. Ndikim të rëndësishëm në përsheptimin e rritjes së aktivitetit kreditues ka pasur lehtësimi i standardeve kreditore dhe përmirësimi i kushteve të kreditimit nga ana e bankave, përderisa edhe kërkesa për kredi ka shënuar rritje. Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve mbetet e ngjashme me vitet paraprake, ku kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë paraqesin kategorinë më të madhe me pjesëmarrje prej 53.4 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet. Rritja e aktivitetit kreditues në vend është financiar kryesisht nga rritja e depozitave të mbledhura brenda vendit. Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore prej 3.6 përqind, duke arritur në 2.53 miliardë euro në dhjetor 2014. Gjatë vitit 2014, struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime, ku vërehet një zvogëlim i

theksuar i peshës së depozitave të afatizuara, të cilat në vitet kaluara përfaqësonin pjesën më të madhe të gjithsej depozitave, përderisa vërehet rritje e depozitave të transferueshme dhe të kursimit. Ky zhvillim në strukturën e depozitave sipas afatit të maturimit kryesisht është pasojë e rënies së theksuar e normës së interesit në depozita, gjë që mund të ketë dekurajuar afatimin e depozitave nga depozitorët.

Gjatë vitit 2014, sektori bankar u karakterizua me zvogëlim të konsiderueshëm të normës së interesit në kredi, që u parapri edhe nga zvogëlimi i normës së interesit në depozita. Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 9.2 përqind në dhjetor 2014 nga 11.1 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita në dhjetor 2014 u zvogëluar në 1.1 përqind nga 2.4 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Rrjedhimisht, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita në dhjetor 2014 u zvogëluar në 8.1 pp, nga 8.7 pp sa ishte në dhjetor 2013.

Treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar vazhdojnë të reflektojnë shkallë të lartë të qëndrueshmërisë. Gjatë vitit 2014, sektori bankar ka shënuar një përmirësim të theksuar të performancës financiare duke regjistruar profit neto në vlerë prej 60.1 milionë euro, kryesisht si rezultat i reduktimit të shpenzimeve, veçanërisht atyre për provizione dhe shpenzimeve të interesit në depozita. Pozita e likuiditetit të sistemit bankar mbetet në nivel të kënaqshëm, duke marr parasysh që në dhjetor 2014 raporti i aseteve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtëra qëndroi në 43.3 përqind, që është dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore. Niveli i kapitalit të sektorit bankar është përforcuar gjatë vitit 2014, kryesisht si rrjedhojë e përmirësimit të theksuar të performancës financiare, duke rezultuar në ngritje të cilësisë së kapitalit si dhe treguesve të kapitalizimit të sektorit. Në dhjetor 2014, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit arriti në 17.8 përqind krahasuar me 16.7 përqind një vit më parë. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor ka treguar tendencë rënëse gjatë vitit 2014, ku pjesëmarrja e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive ka zbritur në 8.3 përqind nga 8.7 përqind në dhjetor 2013. Gjithashtu sektori bankar ka rritur shkallën e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione për mbulim të humbjeve të mundshme nga kreditë, ku raporti i mbulimit të kredive joperformuese me provizione është rritur në 114.4 përqind nga 110.6 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut vazhdon të mbetet në nivel të ulët duke marrë parasysh rënien e mëtutjshme të pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë, rënien e kredive në valutë jo-euro, si dhe ndjeshmërinë e ulët të aseteve dhe detyrimeve ndaj lëvizjeve në norma të interesit duke marrë parasysh faktin se pjesa më e madhe e kredive dhe depozitave bartin norma fikse të interesit. Për më tepër, rezultatet e analizës stres-test vazhdojnë të sugjerojnë aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar për të përballuar tronditjet e konsideruara në kuadër të skenarëve hipotetik.

Infrastruktura bankare gjatë vitit 2014 vazhdoi të zgjerohet. Rritja e numrit të bankomatëve dhe pajisjeve POS rezultoi me rritje të numrit dhe vlerës së tërheqjeve përmes bankomatëve dhe shitjeve përmes POS-ve. Gjatë kësaj periudhe, është rritur edhe numri dhe vlera e transaksioneve të kryera përmes sistemit ndërbankar të pagesave në Kosovo (SEKN). Po ashtu, është shënuar rritje e numrit të gjithsej llogarive bankare, llogarive bankare E-banking, si dhe numrit të kartelave debiti dhe krediti. Të gjitha këto zhvillime ndikuan në rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe sektorët tjerë financiar, përfshirë sektorin pensional, sektorin e sigurimeve, sektorin e institucioneve mikrofinanciar. Sektorin pensional vazhdon të jetë sektori me normën më të lartë të rritjes së aseteve në kuadër të sistemit financiar të Kosovës, ku vlera e aseteve të sektorit, deri në dhjetor 2014, arriti në 1.1 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 19.1 përqind. Sektorin pensional gjithashtu vazhdoi të

shënojë performancë të mirë financiare, duke shënuar rritje të çmimit të aksionit në mjetet e investuara dhe, rrjedhimisht, kthim pozitiv nga investimet. Sektori i sigurimeve ka shënuar rritje të aktivitetit, mirëpo performanca financiare e këtij sektori vazhdon të jetë më e pafavorshme megjithëse në krahasim me vitin e kaluar është zvogëluar shuma e regjistruar si humbje. Sektori mikrofinanciar gjatë vitit 2014 ka ndërprerë trendin e tkurrjes së aktivitetit të ndjekur gjatë viteve të fundit, duke mbajtur vlerën e gjithsej asetëve në 112.9 milionë euro, dhe ka përmirësuar performancën financiare.

3. Mjedisi i jashtëm ekonomik

Aktiviteti ekonomik në nivel global gjatë vitit 2014 u zhvillua në një ambient më të lehtësuar makroekonomik. Ekonomia e SHBA-ve u karakterizua me përforcim të rritjes ekonomike, nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme, përderisa eurozona përfundimisht filloi rikuperimin ekonomik përkundër pasigurive për pasojat eventuale të problemeve në Greqi.


Aktiviteti ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2014 është rikuperuar gradualisht, me përmirësimin e besueshmërisë së konsumatorëve dhe përmirësimin gradual të kushteve në tregun e punës. Megjithatë, rritja e aktivitetit ekonomik mbeti e koncentruar në ekonominë qendrore të eurozonës, gjegjësisht në Gjermani, përderisa pjesë të ndryshme të eurozonës vazhduan të karakterizohen me rritje të dobët gjegjësisht rënie ekonomike. Në vitin 2014, rritja ekonomike në eurozonë arriti në 0.9 përqind, kundrejt rënies ekonomike të shënuar në vitin paraprak prej 0.5 përqind. Megjithëse vazhdon të konsiderohet si një rritje ekonomike modeste, sinjalet për përforcim të mëtejshëm të aktivitetit në rajonin e eurozonës mbështeten kryesisht në rënien e mëtejshme të çmimeve të naftës, gjë që pritet të reflektohet në rritje të besueshmërisë së konsumatorëve dhe rrjedhimisht në rritjen e shpenzimeve. Rritja e besueshmërisë së konsumatorëve është mbështetur kryesisht nga çmimet më të ulëta të energjisë në vitin 2014, por edhe zhvillimeve pozitive në tregjet e punës. Gjithashtu, rritja e aktivitetit ekonomik pritet të mbështetet nga rritja e vazhdueshme e eksporteve të eurozonës si rezultat i zhvlerësimit të euros si dhe nga fillimi i implementimit të programit të lehtësimit sasior nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Për vitin 2015, FMN parashikon një rritje ekonomike prej 1.5 përqind në eurozonë.

Sipas BQE-së, shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë në vitin 2014 zbriti në 0.4 përqind, nga 1.4 përqind sa ishte në vitin 2013. Rënia e vazhdueshme e çmimeve në tregjet ndërkombëtare ka rezultuar në një deflacion prej 0.6 përqind përkatësisht 0.3 përqind në janar dhe shkurt të vitit 2015.

Për të ju kundërvënë rrezikut të ngritur të deflacionit në eurozonë dhe për të rimëkëmbur ekonominë ende të brishtë në rajon, BQE ka vendosur që të lansojë programin e lehtësimit sasior që nga muaji mars i vitit 2015. Duke blerë letra me vlerë të qeverive evropiane dhe agjencive e institucioneve evropiane në tregjet dytësore në baza mujore në vlerë prej 60 miliard euro, programi i lehtësimit sasior synon ndikimin direkt në uljen e kostos së financimit dhe normat e kthimit në investime (yield), për të nxitur investimet e korporatave. Efekti i programit të BQE-së ka ndikuar që norma e kthimit në investimet në obligacione qeveritare të Gjermanisë, me maturitet 10 vjeçar ka rënë në nivele rekorde prej 0.18 përqind në mes të muajit maj, përderisa norma e kthimit në obligacionet qeveritare të Francës ka qenë 0.45 përqind. Rritja e diferencës me normën e kthimit në obligacionet qeveritare në SHBA (1.97 përqind), kryesisht reflekton efektet e lehtësimit të theksuar sasior nga BQE. Programi i lehtësimit sasior në shkallë të gjerë pritet të zgjatë deri në shtator të vitit 2016.

Në vitin 2014, BQE mbajti të pandryshuar normën bazë të rifinancimit, gjë që ndikoi në një rritje të lehtë të normave 1 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në vitin 2014, norma

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor (2014) dhe ECB (2014)


Në vitin 2014, BQE mbajti të pandryshuar normën bazë të rifinancimit, gjë që ndikoi në një rritje të lehtë të normave 1 mujore të interesit të kreditimit ndërbanke Euribor. Në vitin 2014, norma mesatare 1 mujore e Euribor është ngritur në mesatarisht 0.023 përqind nga 0.018 përqind në shtator 2014 (figura 1). Në anën tjetër, norma Euribor për periudhën 12 mujore ka shënuar rënie në mesatarisht 0.33 përqind në vitin 2014, nga mesatarja prej 0.36 përqind në shtator 2014.

Performanca e aktivitetit ekonomik në rajonin e Evropës Juglindore gjatë vitit 2014 përgjithësisht vlerësohet të ketë qenë më e dobët krahasuar me vitin 2013. Rritja mesatare ekonomike në vendet e rajonit në vitin 2014 vlerësohet të ketë qenë rreth 1.5 përqind (2.6 përqind në vitin 2013). Rritjen më të lartë ekonomike në rajon shënuan Maqedonia (3.8 përqind) dhe Kosova (2.7 përqind), përderisa Serbia ishte vendi i vetëm në rajon që u karakterizua me rënie ekonomike në vitin 2014. Për vitin 2015, FMN parashikon një përshejtim të rritjes ekonomike në 2.8 përqind në vendet e Evropës Juglindore.

Ngjashëm me vendet e eurozonës, vendet e Evropës Juglindore janë karakterizuar me shkallë më të ulët të inflacionit, gjegjësisht deflacion në vitin 2014 kundrejt vitit paraprak. Norma mesatare e inflacionit në vendet e rajonit në vitin 2014, sipas FMN-së, ishte 0.4 përqind. Serbia dhe Shqipëria u karakterizuan me shkallë më të lartë të inflacionit prej 2.1 përkatësisht 1.6 përqind, përderisa Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia u karakterizuan me deflacion.

Çmimet e naftës (brentcrude)¹ në vitin 2014 shënuan rënie mesatare vjetore prej rreth 9.1 përqind. Me rënie të çmimit gjatë vitit 2014 u karakterizua edhe ari. Në vitin 2014, çmimi i arit ishte për rreth 10.3 përqind më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Mallrat ushqimore në nivel global gjatë vitit 2014 janë karakterizuar me rënie të çmimeve krahasuar me vitin paraprak. Gjatë vitit 2014, krahasuar me vitin paraprak, mallrat ushqimore kishin një çmim më të ulët prej mesatarisht 3.7 përqind, përderisa drithërat kishin çmim më të ulët për mesatarisht 12.5 përqind.

Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: World Bank, EIA (2014), dhe kalkulimet të BQK-së

Rënia e çmimeve të naftës, politika agresive monetare dhe përmirësimi i aktivitetit ekonomik veçanërisht në Gjermani, janë përkthyer edhe në përmirësim të ciklit kreditor në eurozonë. Gjatë vitit 2014, pas më shumë se dy vitesh, kreditimi i sektorit privat ka shënuar një rritje modeste. Rritja e kreditimit të sektorit privat, sipas anketës për kreditim bankar të BQE-së, i atribuohet kryesisht rritjes së kërkesës për financim të investimeve fikse të ndërmarrjeve si dhe lehtësimit të standardeve kreditore nga bankat.

Me rritje të aktivitetit kreditor u karakterizuan edhe vendet në rajonin e Evropës Juglindore. Me përjashtim të Malit të Zi që shënoi rënie të kreditimit, të gjitha vendet e tjera u karakterizuan me përshejtim të rritjes së kredive. Megjithatë, rritja e kreditimit në vendet e Evropës Juglindore u mbështet kryesisht në rritjen e kreditimit për ekonomitë familjare, përderisa kreditimi i ndërmarrjeve është vlerësuar të ketë stagnuar. Sa i përket depozitave në bankat komerciale në vendet e Evropës Juglindore, Shqipëria dhe Kosova u karakterizuan me ngadalësim të rritjes së gjithsej depozitave në vitin 2014, përderisa të gjitha vendet tjera kishin përshejtim të rritjes së depozitave. Vendet në Evropën Juglindore raportuan kryesisht rënie të

¹ 'BrentCrude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

kredive jo-performuese gjatë vitit 2014, me përjashtim të Bosnje dhe Hercegovinës dhe Maqedonisë që raportuan përkeqësim të kualitetit të portofolios kreditorë.

Programi i lehtësimit sasior nga BQE është përkthyer edhe në dobësimin e monedhës së euros kundrejt valutave kryesore gjatë vitit 2014. Norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan në vitin 2014 ishte pothuajse në nivel të njëjtë me vitin paraprak (0.1 përqind rritje), megjithëse në katër muajt e fundit të vitit 2014 euro u karakterizua me rënie të madhe kundrejt dollarit amerikan (10 përqind rënie vjetore në dhjetor 2014). Ndaj sterlinës britanike dhe ndaj frankës zvicerane, euro ka shënuar rënie mesatare vjetore prej 5.0 përkatësisht 1.3 përqind. Sa i përket valutave të vendeve të rajonit, në vitin 2014, euro është vlerësuar kundrejt dinarit serb, kunës kroate dhe denarit maqedon për mesatarisht 3.7, 0.7 përkatësisht 0.1 përqind, përderisa është zhvlerësuar kundrejt lekut shqiptar për 0.2 përqind.

Kutia 1. Performanca e grupeve kryesore bankare që operojnë në Kosovë

ProCredit Holding – PCH (Gjermani)

Vlera e gjithsej asetëve të grupit bankar ProCredit Holding (PCH) arriti në 6.0 miliardë euro në dhjetor 2014, duke shënuar rritje vjetore prej 2.2 përqind. Sipas shtrirjes regjionale, struktura e asetëve të grupit fokusohet në Evropën Juglindore e cila përfshinë 45.0 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Segmenti i dytë është Gjermania me 18.4 përqind të gjithsej asetëve të grupit, pasuar nga Amerika Lindore dhe Evropa Lindore me pjesëmarrje prej 15.5 përqind përkatësisht 13.3 përqind në gjithsej asetet e grupit. Pjesën më të vogël të pjesëmarrjes e kanë Amerika Qendrore dhe Afrika (figura 3).

Performanca e grupit gjatë vitit 2014 është ndikuar nga zhvillimet e përgjithshme makroekonomike në vendet ku operon. Më konkretisht, përkeqësimet në regjionin e Evropës Lindore si rezultat i konfliktit në mes të Rusisë dhe Ukrainës u reflektuan në segmentin bankar të Evropës Lindore. Performanca e grupit varet mjaft shumë edhe nga performanca e bankave në Serbi, Kosovë dhe Bullgari që janë tri institucionet më të mëdha të grupit në Evropën Juglindore, i cili si regjion në vitin 2014 shënoi një rritje të brishtë ekonomike. Regjioni i Amerikës Jugore, më konkretisht vendet në të cilat operon grupi, shënoi rritje ekonomike më të lartë krahasuar me Evropën Juglindore dhe Lindore, duke ndikuar kështu pozitivisht në performancën financiare të grupit.

Modeli i biznesit të grupit vazhdon të jetë tradicional, ku aktiviteti kreditues financohet kryesisht nga depozitat (figura 4). Në dhjetor 2014, gjithsej kreditë e PCH arritën vlerën prej 4.3 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 3.5 përqind krahasuar me rënie prej 0.1 përqind në vitin paraprak. Depozitat e grupit bankar PCH arritën vlerën 4.0 miliardë euro në dhjetor 2014, që paraqet një rritje vjetore prej 5.0 përqind. Rrjedhimisht raporti i kredive ndaj depozitave në dhjetor 2014 u zvogëlua në 108.5 përqind, nga 110.1 përqind në dhjetor 2013.

Grupi PCH gjatë vitit 2014 shënoi përmirësim të indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit,

Figura 3. Struktura e asetëve të ProCredit Holding në përqindje, dhjetor 2014





Figura 4. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave të ProCredit Holding, në përqindje



shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, i cili shënoi normën prej 71.7 përqind në dhjetor 2014 duke paraqitur një rënie prej 2.9 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak (figura 5). Përmirësimi i atribuohet kryesisht rënies më të shpejtë prej 10.9 përqind të shpenzimeve operacionale kundrejt rënies prej 6.8 përqind të të hyrave operacionale. Rënia më e shpejtë e shpenzimeve operacionale ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve për personelin, që shënuan rënie vjetore prej 14.0 përqind, si dhe reduktimit të shpenzimeve administrative që shënuan rënie vjetore prej 8.2 përqind.

Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 9.9 përqind pavarësisht që aktiviteti kreditues i grupit shënoi rritje gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, edhe të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rënie vjetore prej 3.2 përqind gjatë vitit 2014. Përkundër rënies së të hyrave, menaxhimi më i mirë i shpenzimeve siguroi që profiti i grupit deri në dhjetor 2014 të jetë dukshëm më i lartë krahasuar me vitin paraprak. Deri në dhjetor 2014, profiti i realizuar arriti në 50.2 milionë euro (39.0 milionë euro deri në dhjetor 2013). Gjatë vitit

2014, grupi gjithashtu përmirësoi dukshëm normën e kthimit në kapital (ROE) në 9.4 përqind krahasuar me 7.7 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*) u përmirësua në 12.7 përqind në dhjetor 2014 (12.2 përqind në dhjetor 2013), duke vazhduar t'i përmbushë kërkesat rregullative të adekuatshmërisë së kapitalit (figura 5).

Raiffeisen Bank International – RBI (Austri)

Vlera e gjithsej asetëve të grupit bankar Raiffeisen Bank International (RBI) arriti në 121.6 miliard euro në dhjetor 2014, duke shënuar rënie vjetore prej 6.9 përqind. Sipas shtrirjes regjionale, struktura e asetëve të grupit fokusohet në Evropën Qendrore, e cila përfaqëson 33.5 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Segment tjetër i rëndësishëm është edhe ai i Evropës Juglindore, i cili përfaqëson rreth 17.6 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Austria me 35.3 përqind është e treta dhe pasohet nga Rusia dhe Evropa Lindore që kanë përfaqësim prej 10.2 përqind përkatësisht 3.3 përqind të gjithsej asetëve të grupit (figura 6). Shumica e vendeve në të

cilat operon grupi gjatë vitit 2014 u karakterizua me ngadalësim të rritjes ekonomike apo edhe me tkurrje të ekonomisë, gjë që në mënyrë indirekte u reflektua edhe në aktivitetin e grupit. Më konkretisht, zvogëlimi i asetëve të RBI-së u ndikua nga gjendja e pafavorshme gjeopolitike në Ukrainë, sanksioneve ekonomike të vëna ndaj Rusisë dhe zhvlerësimi i valutave të Ukrainës dhe Rusisë ndaj dollarit dhe euros, ndryshimeve në legjislacionin bankar në Hungari si dhe zhvlerësimi i asetëve fikse - 'emrit të mirë' (goodwill) që ndikoi që RBI të ndajë rreth 251 milionë euro për provizione shtesë.

Modeli i biznesit të grupit bankar RBI vazhdon të jetë tradicional duke u bazuar kryesisht në kredi dhe depozita (figura 7). Kreditë, që përfaqësojnë 64.1 përqind të gjithsej asetëve të RBI-së, në dhjetor 2014 arritën vlerën në 77.9 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 3.4 përqind. Kjo rënie në masë të madhe u ndikua nga shtrëngimi i kriterëve kreditues në Rusi dhe Ukrainë. Depozitat, që paraqesin burimin kryesor të financimit të grupit, në dhjetor 2014 arritën vlerën prej 66.1 miliard euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 0.5 përqind. Zvogëlimi i depozitave në Rusi dhe Ukrainë gjatë vitit 2014 kontribuoi në rënien e gjithsej depozitave të RBI-së. Si rrjedhojë e rënies më të theksuar të kredive krahas rënies së

Figura 5. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave dhe ROE dhe CAR (boshti i djathtë) të ProCredit Holding, në përqindje





Figura 6. Struktura e asetëve të Raiffeisen Bank International në përqindje, dhjetor 2014



nivelit të depozitave, raporti kredi/depozita u zvogëlua për 3.5 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 117.9 përqind në dhjetor 2014.


Grupi RBI ka shënuar përmirësim të indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, i shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, i cili u zvogëlua në 56.5 përqind në dhjetor 2014 nga 58.3 përqind sa ishte në dhjetor 2013 (figura 8). Ky përmirësim kryesisht i atribuohet rënies më të shpejtë prej 9.5 përqind të shpenzimeve operacionale, krahas rënies së të hyrave operacionale prej 6.5 përqind në dhjetor 2014. Në kuadër të shpenzimeve operacionale, shpenzimet e personelit u karakterizuan me rënie vjetore prej 11.2 përqind, ndërsa shpenzimet administrative shënuan rënie prej 6.6 përqind deri në dhjetor 2014. Ndërsa, në kuadër të të hyrave operative, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 7.7 përqind, kurse të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rënie vjetore prej 0.3 përqind.

Gjatë vitit 2014, RBI ka ndarë një shumë më të lartë të shpenzimeve për provizione ndaj humbjeve të mundshme nga kreditë për shkak të zhvillimeve në Ukrainë dhe Rusi. Si rrjedhojë, grupi RBI deri në dhjetor 2014 regjistroi humbje neto prej 492.7 milion euro. Grupi shënoi përkeqësim edhe në raport më kthimin në kapital (ROE) i cili në vitin 2014 qëndroi në 0.2 përqind, që paraqet një rënie të konsiderueshme krahasuar me normën prej 7.8 përqind sa ishte në vitin 2013. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) në dhjetor 2014 qëndroi në 16.0 përqind krahasuar me normën prej 15.9 sa ishte në dhjetor 2013 (figura 8). Kurse, raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2014 u rrit në 11.3 përqind krahasuar me 10.7 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Në dhjetor 2014, mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione qëndroi në 67.4 përqind (63.1 përqind në dhjetor 2013).

RBI vazhdon të jetë e vetmja nga tri grupet bankare kryesore që operojnë në Kosovë që tregton aksionet e saj në bursë. Çmimi për aksion të RBI-së në bursën e Vjenës në dhjetor 2014 u zvogëlua në 12.5 euro krahasuar me 25.6 euro sa ishte në dhjetor 2013. Kjo rënie e çmimit të aksionit, ndër tjerash, erdhi si rezultat i paqëndrueshmërisë politike dhe ekonomike në Ukrainë dhe Rusi.


NLB Group (Slloveni) Grupi bankar NLB edhe gjatë vitit 2014 u karakterizua me rënie të aktivitetit, përderisa treguesit e performancës financiare dhe të qëndrueshmërisë shënuan përmirësim. Në dhjetor 2014, vlera e gjithsej aseteve të grupit arriti në 11.9 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 4.6 përqind. Sa i përket shtrirjes regionale të aseteve të grupit, Sllovenia përfaqëson tregun kryesor me 70.3 përqind të gjithsej aseteve të grupit. Evropa Juglindore gjithashtu është një treg mjaft i rëndësishëm për grupin NLB, duke pasur

Figura 7. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave te Raiffeisen Bank International, në përqindje




Burimi: Raportet vjetore të Raiffeisen Bank International (2015)

Figura 8. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave dhe ROE CAR (boshti i djathtë) të Raiffeisen Bank International



Burimi: Raportet vjetore të Raiffeisen Bank International (2015)

Figura 9. Struktura e aseteve të NLB Group në përqindje, dhjetor 2014



Burimi: Raporti vjetor i NLB Group (2015)

parasysh që 28.8 përqind e gjithëj asetëve të grupit janë të investuara në këtë regjion. Pjesa e mbetur e asetëve të grupit janë të investuara në Evropën Perëndimore dhe atë Qendrore me një përfaqësim prej 0.9 përqind (figura 9). Edhe pse gjatë vitit 2014 Sllovenia tregoi shenjat e para të rimëkëmbjes ekonomike, të njëjtat nuk u reflektuan në sektorin bankar i cili vazhdoi fazën e ristrukturimit dhe u karakterizua me zvogëlim të asetëve.

Modeli i biznesit të grupit NLB bazohet kryesisht në dhënie të kredive të cilat kryesisht financohen nga depozitat (figura 10). Gjatë vitit 2014, NLB Group u karakterizua me rënie të nivelit të kreditimit. Në dhjetor 2014, vlera e gjithëj kredive arriti në 9.1 miliard euro, që paraqet rënie vjetore prej 4.8 përqind. Në kuadër të detyrimeve, vlera e gjithëj depozitave në dhjetor 2014 arriti në 8.9 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.3 përqind. Zvogëlimi i kredive dhe rritja e depozitave ka ndikuar që raporti kredi/depozita të zvogëlohet në 101.2 përqind në dhjetor 2014 nga 115.1 sa ishte në dhjetor 2013.

Grupi NLB gjatë vitit 2014 përmirësoi treguesit kyç të efikasitetit dhe performancës financiare. Indikatorit i përgjithshëm i efikasitetit, shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, shënoi rënie vjetore për 36.2 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin prej 59.4 përqind në dhjetor 2014 (figura 11). Ky përmirësim kryesisht i atribuohet rritjes më të shpejtë të të hyrave operacionale prej 46.7 përqind në dhjetor 2014 kundrejt zvogëlimit të shpenzimeve operacionale për 8.8 përqind.

Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi shënuan rritje vjetore prej 0.6 përqind, kurse të hyrat nga tarifat dhe komisionet rritje vjetore prej 1.5 përqind deri në dhjetor 2014. Në kuadër të shpenzimeve operacionale, shpenzimet për personelin shënuan rënie vjetore prej 7.8 përqind deri në dhjetor 2014, kurse shpenzimet e përgjithshme dhe administrative shënuan rënie vjetore prej 11.0 përqind. Si rrjedhojë e rritjes së nivelit të hyrave, menaxhimit më të mirë të shpenzimeve, si dhe zvogëlimit të shpenzimeve për provizione (nga 1.1 miliard në 2013 në 141.4 milionë në 2014), grupi arriti që të rikuperohet nga humbjet e ndodhura në pesë vitet e fundit, duke mbyllur vitin 2015 me profit prej 62.3 milionë euro. Si rrjedhojë, edhe norma e kthimit në kapital (ROE) u përmirësua në 4.7 përqind krahasuar me -135.5 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Po ashtu, grupi ka përfunduar nivelin e kapitalizimit shprehur përmes treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR), që arriti në 17.6 përqind në dhjetor 2014, krahasuar me 15.2 përqind sa ishte në dhjetor 2013 (figura 11). Lëvizje pozitive u shënuan edhe në cilësinë e portofolit kreditor, ku raporti ndërmjet kredive joperformuese dhe gjithëj kredive u zvogëluar në 25.5 përqind në dhjetor 2014 krahasuar me 25.6 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Ndërsa, mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione në dhjetor 2014 ishte 61.4 përqind krahasuar me 63.1 përqind në dhjetor 2013.

Figura 10. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave të NLB Group, në përqindje





Figura 11. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave, ROE dhe CAR (boshti i djathtë) të NLB Group



4. Ekonomia e Kosovës

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2014, sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së, shënoi rritje reale prej 0.9 përqind (figura 12). Ky vlerësim bazohet në rritjen e investimeve prej 1.5 përqind dhe konsumit prej vetëm 1.4 përqind, ndërkohë që neto eksportet e thelluan deficitin tregtar për 3.2 përqind. Komponenta kryesore në kuadër të PBB-së mbetet konsumi, me pjesëmarrje prej 104.5 përqind, investimet me 27.8 përqind dhe neto eksporti me -32.3 përqind.

Në përgjithësi, viti 2014 është karakterizuar me rritje të konsiderueshme të remitencave (11.8 përqind) dhe rritje të kredive konsumuese (48.7 përqind). Poashtu, si rezultat i vendimit të qeverisë për rritje të pagave dhe pensione, edhe shpenzimet rrjedhëse të qeverisë shënuan rritje të konsiderueshme (11.9 përqind). Në anën tjetër, është shënuar rënie e konsiderueshme e investimeve publike (22.3 përqind), ndërkohë që edhe investimet e huaja direkte pothuajse u përgjysmuan në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013.

Rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2014 u reflektua edhe në ekonominë e Kosovës. Inflacioni në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), gjatë vitit 2014 u karakterizua me normë dukshëm më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2014 ishte 0.4 përqind, krahasuar me inflacionin prej 1.8 përqind në vitin 2013 (figura 13). Gjatë vitit 2014, çmimet e energjisë dhe pijeve alkoolike shënuan rritje, ndërsa me rënie të çmimeve u karakterizuan kryesisht mallrat e importuara, gjegjësisht produktet ushqimore dhe pijet joalkoolike. Si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe, si dhe pjesëmarrjes relativisht të lartë të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme në shportën e konsumatorit, lëvizjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare vazhdojnë të jenë përcaktuesi kryesor i lëvizjes së çmimeve në vend. Në vitin 2014, sikurse IÇK-ja, edhe çmimet e importit dhe çmimet e prodhimit u karakterizuan me norma më të ulëta krahasuar me vitin paraprakë. Indeksi i çmimeve të importit shënoi rënie vjetore prej 0.5 përqind (0.2 përqind ishte rritja në vitin 2013) ndërsa çmimet e prodhimit shënuan rritje prej 1.6 përqind (2.4 përqind ishte rritja në vitin 2013).

Figura 12. Rritja Reale e PBB-së, në përqindje






Figura 13. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij



Sektori fiskal në vitin 2014 u karakterizua me rritje të lehtë të të hyrave dhe nivel të ngjashëm të shpenzimeve krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat primare buxhetore shënuan rritje prej 1.5 përqind dhe arritën vlerën prej rreth 1.3 miliardë euro. Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore arriti në rreth 1.5 miliardë euro që paraqet nivel të ngjashëm me vitin paraprak. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej 131 milionë euro apo 2.4 përqind të PBB-së. Borxhi publik në fund të vitit 2014 arriti në rreth 10.6 përqind e PBB-së që është për 1.5 pikë përqindje më i lartë krahasuar me fundin e vitit 2013.

Figura 14. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative në milionë euro



Burimi: ASK (2014)

Sektori i jashtëm u karakterizua me përkeqësim të pozicionit tregtar në vitin 2014 (figura 14). Përkundër rritjes së eksportit të mallrave prej 10.4 përqind, rritja e importit të mallrave prej 3.6 përqind ka ndikuar në rritjen e deficitit tregtar të mallrave për 2.7 përqind. Kategoria e të ardhurave dytësore vazhdon të ndikojë në zvogëlimin e deficitit të komponentës së llogarisë rrjedhëse dhe kapitale të bilancit të pagesave të Kosovës. Remitencat si njëra ndër komponentët kryesore të llogarisë rrjedhëse shënuan rritje prej 11.8 përqind në vitin 2014 dhe arritën vlerën prej 693.7 milionë euro. Llogaria financiare në vitin 2014 regjistroi bilanc negativ prej 145.1 milionë euro krahasuar me bilancin negativ prej 132.2 milionë euro në vitin 2013. Në kuadër të detyrimeve, kategoria kryesore vazhdon të jetë kategoria e IHD-ve, ndërsa tek asetet kategoria kryesore ishin investimet tjera (kryesisht depozita dhe kredi tregtare) jashtë ekonomisë së Kosovës. Bilanci i IHD-ve u karakterizua me përkeqësim në vitin 2014, përcaktuar kryesisht nga rënia e IHD-ve në vend, të cilat u zvogëluan në 151.3 milionë euro nga 280.2 milionë euro sa ishin në vitin 2013.

Sistemi financiar është karakterizuar me zgjerim të aktivitetit dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Roli i sektorit bankar në financimin e aktivitetit ekonomik në vend u përforcua gjatë vitit 2014. Përshpejtimi i rritjes së aktivitetit kreditues gjatë kësaj periudhe, nxitur kryesisht nga ana e ofertës, dhe zvogëlimi i vazhdueshëm i kostos së financimit kanë ndikuar në rritjen e mëtejme të konsumit dhe investimeve private.

Në vitin 2014 u regjistruan 9,404 ndërmarrje të reja apo 16 ndërmarrje më pak se sa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 1,671 biznese apo 163 biznese më shumë se sa në vitin paraprak. Struktura e ndërmarrjeve të reja të regjistruara është e ngjashme me vitin e kaluar ku dominojnë tregtia, hoteleria, prodhimi, ndërtimtaria dhe bujqësia. Krahasuar me vitin paraprak, është shënuar rënie e numrit të bizneseve të regjistruara tek ndërmarrjet me aktivitete të patundshmërisë prej 198 ndërmarrjesh dhe ndërtimtarisë me 140 ndërmarrje më pak të regjistruara, ndërsa hoteleria dhe prodhimi kanë shënuar rritje për 123 përkatësisht 106 ndërmarrje. Rritje kanë shënuar edhe ndërmarrjet e regjistruara në sektorin e tregtisë.

Sa i përket vitit 2015, pritet që ekonomia e Kosovës të përshpejtojë ritmin e rritjes. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e PBB-së. Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet që edhe gjatë vitit 2015 të ketë kontributin kryesor në rritjen ekonomike. Investimet, për dallim nga viti i kaluar, pritet të karakterizohen me rritje të konsiderueshme të investimeve publike. Poashtu, zvogëlimi i normave të interesit në kredi si dhe lehtësimi i

standardeve për aprovimin e kredive nga ana e bankave pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në nxitjen e investimeve të sektorit privat. Edhe IHD-të, të cilat deri në prill të vitit 2015 shënuan rritje të konsiderueshme, pritet të kontribuojnë në rritjen e gjithsej investimeve. Pozicioni i neto eksportit pritet të vazhdojë të ketë ndikim negativ në rritjen e PBB-së. Përkundër parashikimeve për rritje më të lartë të eksporteve, niveli më i lartë i importit të mallrave krahasuar me eksportin do të ndikojë që deficitin tregtar të mallrave të thellohet.

5. Sistemi Financiar i Kosovës

5.1. Karakteristikat e Përgjithshme


Sistemi financiar i Kosovës vazhdoi të zgjerojë aktivitetin e tij gjatë vitit. Në dhjetor 2014, gjithsej asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 4.5 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.4 përqind (figura 15). Rritja e gjithsej asetëve të sistemit financiar kryesisht i atribuohet rritjes së asetëve të bankave komerciale dhe fondeve pensionale. Sektori i sigurimeve, pavarësisht zgjerimit të aktivitetit, kishte kontribut më të vogël në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit financiar, përderisa ndikimi i sektorit mikrofinanciar ishte neutral.

Struktura e sistemit financiar vazhdon të dominohet nga sektori bankar i cili përfaqësoi 70.1 përqind të gjithsej asetëve të sistemit në dhjetor 2014, pasuar nga fondet pensionale që përfaqësojnë 24.1 përqind të gjithsej asetëve (figura 16). Sektori pensional vazhdon të jetë sektori me normën më të lartë të rritjes së asetëve në kuadër të sistemit financiar. Në dhjetor 2014, asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 19.1 përqind, duke bërë që pjesëmarrja e tyre në gjithsej asetet e sistemit financiar të arrijë në 24.1 përqind krahasuar me 21.7 përqind në dhjetor 2013.

Me rritje të përshpejtuar të aktivitetit u karakterizua edhe industria e sigurimeve. Në dhjetor 2014, asetet e kompanive të sigurimit shënuan rritje vjetore prej 5.8 përqind (1.5 përqind në dhjetor 2013). Pjesëmarrja e asetëve të sektorit të sigurimeve në gjithësej asetet e sistemit financiar mbeti e njëjtë me vitin e kaluar në 3.1 përqind.


Sektori mikrofinanciar, që gjatë tri viteve të fundit u karakterizua me zvogëlim të aktivitetit, në vitin 2014 ndërpreu trendin rënës ku vlera e asetëve të sektorit mbeti e pandryshuar me vitin e kaluar. Megjithatë, pjesëmarrja e sektorit në gjithsej asetet e sistemit financiare u zvogëlua në 2.5 përqind (2.7 përqind në dhjetor 2013), kryesisht si rezultat i normës më të lartë të rritjes së asetëve të sektorëve tjerë. Asetet e ndihmësve financiar në dhjetor 2014 shënuan rritje vjetore prej 18.6 përqind, por pesha e tyre në sistemin financiar vazhdon të jetë e ulët me një përfaqësim prej vetëm 0.2 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar.

Figura 15. Ndryshimi vjetor i asetëve të sistemit financiar dhe sektorëve përkatës, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 16. Struktura e asetëve të sistemit financiar, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Gjatë vitit 2014, shkalla e ndërmjetësimit financiar në vend, i llogaritur si raport i asetëve të sistemit financiar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) u thellua duke arritur në 81.3 përqind nga 79.4 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Megjithatë situata ndryshon në raport me sektorët individual financiar ku krahasuar me vitin e kaluar, pesha e sektorit bankar ndaj PBB-së ka shënuar rënie të lehtë si rezultat i rritjes më të ngadalësuar të aktivitetit, duke ndërperë trendin rritës të ndjekur gjatë tri viteve të fundit. Në anën tjetër sektori pensional edhe në vitin 2014 për të katërtin vit me radhë zgjeroi pjesëmarrjen në ndërmjetësimin financiar në vend. Pjesëmarrja e sektorit të sigurimeve në ndërmjetësimin financiar në vend mbeti e njëjtë me vitin e kaluar. Ndërsa, sektori mikrofinanciar zvogëloi peshën e tij në gjithësej ndërmjetësimin financiar (figura 17).

Krahasuar me vendet e rajonit, vërehet se shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë vazhdon të jetë relativisht e ulët në të gjithë sektorët përbërës të sistemit financiar. Bazuar në këtë, mund të kuptohet se, në raport me madhësinë e ekonomisë, sektori financiar i Kosovës ka ende hapësirë për rritje të shkallës së ndërmjetësimit financiar për të konvergjuar drejtë mesatares së vendeve tjera të rajonit (figura 18).

Figura 17. Norma e ndërmjetësimit financiar sipas sektorëve ndaj PBB-së, në përqindje




Figura 18. Norma e ndërmjetësimit financiar të sektorit bankar ndaj PBB-së, në përqindje




Tabela 1. Numri i institucioneve financiare²

Përshkrimi	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
Bankat komerciale	8	9	9	10
Kompanitë e sigurimeve	13	13	13	14
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	34	38	39	42
Institucionet mikrofinanciare	20	17	17	18

Burimi: BQK(2015)

Struktura e sistemit financiar për sa i përket numrit të institucioneve financiare është zgjeruar në krahasim me periudhat e kaluara. Gjatë vitit 2014, sistemit financiar në vend i është një degë bankare me kapital të huaj (të cilës i është dhënë licenca preliminare), duke çuar numrin e bankave që operojnë në vend në dhjetë. Poashtu, sistemit financiar i'u shtua edhe një institucion mikrofinanciar me kapital të huaj si dhe një kompani e sigurimeve gjithashtu me kapital të huaj (të cilës i është dhënë licenca preliminare) duke çuar numrin e tyre në 18 përkatësisht 14. Numri

² Numri i institucioneve financiare paraqet numrin e institucioneve që janë të licencuara të operojnë në tregun e Kosovës.

i ndihmësve financiar arriti në 42 nga 39 sa ishin në vitin paraprak, përderisa numri i fondeve pensionale mbeti i njëjtë. Pjesa më e madhe e institucioneve financiare në vend vazhdon të përbëhet nga institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar, numri i të cilave së bashku arriti në 60 në dhjetor 2014 (tabela 1).


5.2 Ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm

Asetet e sistemit financiar³ të Kosovës që janë të investuara jashtë vendit, në dhjetor 2014, arritën vlerën prej 1.6 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 26.8 përqind.⁴ Rritja e përshpejtuar e aseteve të investuara jashtë vendit erdhi kryesisht si rezultat i zgjerimit të investimeve të fondit pensional të Kosovës në sektorin e jashtëm. Struktura e aseteve të jashtme përbëhet kryesisht nga asetet dhe ekuitetet tjera me pjesëmarrje prej 63.5 përqind, pasuar nga depozitat me pjesëmarrje prej 20.4 përqind dhe letrat me vlerë me pjesëmarrje prej 12.1 përqind. Pjesa e mbetur përfaqësohet nga kreditë me 3.8 përqind dhe asetet tjera me 0.2 përqind (figura 19).

Në kuadër të gjithsej aseteve të jashtme, normën më të lartë të rritjes e shënuan investimet e fondeve pensionale në asetet dhe ekuitete (57.3 përqind) dhe depozitat e bankave të mbajtura në sektorin e jashtëm (33.2 përqind). Kurse, investimet në kategoritë tjera shënuan rënie gjatë vitit 2014. Normën më të theksuar të rënies e shënuan kreditë (-45.2 përqind) gjithashtu me rënie u karakterizuan edhe investimet në letra me vlerë (-24.3 përqind). Rënia e shënuar në të dy kategoritë ishte si rezultat i zvogëlimit të investimeve të bankave komerciale në këto instrumente. Gjithashtu, rënia e letrave me vlerë jashtë vendit ka ardhur si rezultat zhvendosjes së investimeve të bankave nga letrat me vlerë jashtë vendit në ato të Qeverisë së Kosovës të cilat gjatë vitit 2014 janë karakterizuar me norma më të larta të interesit.


Vlera e gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm në dhjetor 2014 arriti në 243.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 2.4 përqind. Struktura e detyrimeve të jashtme dominohet nga kreditë me pjesëmarrje prej 61.5 përqind, pasuar nga depozitat me 37.2 përqind dhe detyrimet tjera me pjesëmarrje prej 1.3 përqind (figura 20). Gjatë vitit 2014, në kuadër të gjithsej detyrimeve të jashtme, kategoria e kredive patën shënoi rritje të ngadalësuar prej 3.1 përqind

Figura 19. Struktura e kërkesave të jashtme, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 20. Struktura e detyrimeve të jashtme, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

³ Në këtë kontekst, sistemi financiar nuk përfshinë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

⁴ Në kuadër të kërkesave të sistemit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm nuk është përfshirë kategoria "paraja e gatshme". Në statistikat monetare dhe financiare, kategoria "paraja e gatshme" trajtohet si aset i jashtëm (kërkesa ndaj jorezidentëve) për faktin se valuta euro nuk është valutë kombëtare e Kosovës, mirëpo në këtë analizë këto mjete nuk janë trajtuar si të tilla për shkak se ato janë mjete që mbahen në bankat në Kosovë.

(28.0 përqind në dhjetor 2013). Kjo i atribuohet kryesisht zvogëlimit të kredive të pranuar nga institucionet mikrofinanciare (-1.5 përqind) dhe rritjes më të ulët të kredive të pranuar nga bankat komerciale (6.5 përqind). Kategoria e depozitave gjatë vitit 2014 shënoi rritje prej 0.2 përqind krahasur me rritjen prej 3.3 përqind në dhjetor 2013.


Rrjedhimisht, deri në dhjetor 2014, vlera e aseteve të jashtme neto (AJN) të sistemit financiar të Kosovës arriti në 1.4 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 32.4 përqind. Rritja e investimeve të fondeve pensionale në sektorin e jashtëm kishte kontributin kryesor në rritjen e AJN-ve. Për më tepër, fondet pensionale vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe të AJN-ve (75.1 përqind), ndërsa pjesa e mbetur përbëhet kryesisht nga AJN-të e sektorit bankar (29.4 përqind). I vetmi segment që shënoi bilanc negativ të AJN-ve vazhdon të jetë sektori mikrofinanciar (-4.5 përqind), kryesisht si rezultat i mbështetjes së lartë në financim të jashtëm, në formë të linjave kreditore (figura 21).

Ekspozimi i gjithsej sistemit financiar ndaj jo rezidentëve vazhdon të mbetet më i theksuar në kuadër të aseteve, krahas ekspozimit më të ulët në kuadër të detyrimeve. Më konkretisht, raporti i aseteve të jashtme ndaj gjithsej aseteve të sistemit financiar në dhjetor 2014 arriti në 35.5 përqind (30.1 përqind në dhjetor 2013), ndërsa ai i detyrimeve të jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sistemit arriti në 5.4 përqind (5.6 përqind në dhjetor 2013) (figura 22).

Sa i përket ekspozimit sektorial, sektori bankar vazhdon të ketë neto ekspozimin më të ulët ndaj sektorit të jashtëm. Raporti i aseteve të jashtme ndaj gjithsej aseteve të sektorit është 18.3 përqind, përderisa raporti i detyrimeve të jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sektorit është 5.7 përqind. Në kuadër të sektorit bankar, bankat e mëdha vërehet të jenë më të ekspozuara ndaj sektorit të jashtëm në krahasim me bankat e vogla, si në kuadër të aseteve ashtu edhe të detyrimeve. Kjo reflekton faktin se bankat më të mëdha, të cilat kryesisht janë banka të huaja, kanë një shkallë më të lartë të ndërveprimit me sektorin e jashtëm dhe veçanërisht me bankat e tyre amë.


Sektori i fondeve pensionale vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj sektorit të jashtëm në kuadër të aseteve. Në dhjetor 2014, asetet e investuara jashtë vendit përbënin 94.0 përqind të gjithsej aseteve të sektorit pensional. Për dallim nga sektorët tjerë, sektori mikrofinanciar është i ekspozuar vetëm në kuadër të detyrimeve dhe deri në dhjetor 2014 niveli i ekspozimit ishte 54.7 përqind e gjithsej detyrimeve. Sektori mikrofinanciar ka ekspozim të lartë në kuadër të

Figura 21. Asetet e jashtme neto sipas institucionieve financiare, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 22. Ekspozimi në kuadër të aseteve dhe detyrimeve, dhjetor 2014, në përqindje



Sistemi financiar nuk përfshinë BQK-në

Burimi: BQK (2015)

detyrimeve për arsye së shfrytëzon linjat kreditore të jashtme për të financuar aktivitetin kreditues, duke pasur parasysh se IMF-të nuk kanë të drejtë ligjore të pranojnë depozita.

6. Sektori Bankar i Kosovës

6.1 Struktura e Sektorit Bankar


Struktura e sektorit bankar vazhdon të dominohet nga bankat me pronësi të huaj, ku nga gjithsej dhjetë banka të licencuara (përfshirë një me licencë preliminare), tetë janë me pronësi të huaj dhe menaxhojnë 90.4 përqind të gjithsej aseteve të sektorit dhe 93.1 përqind të gjithsej kapitalit të sektorit bankar. Pjesa më e madhe e aseteve të sektorit bankar (51.3 përqind e gjithsej aseteve) menaxhohet nga dy bankat me origjinë nga Gjermania dhe Austria. Sllovenia përfaqësohet me një bankë e cila vazhdon të mbetet banka e tretë në

treg me pjesëmarrje prej 15.6 përqind në gjithsej asetet e sektorit. Turqia përfaqësohet nga tri banka, të cilat gjatë katër viteve të fundit zgjeruan pjesëmarrjen, duke arritur në 13.7 përqind në dhjetor 2014. Shqipëria vazhdon të përfaqësohet nga një bankë, e cila ka pjesëmarrje prej 8 përqind në gjithsej asetet e sektorit bankar. Në tregun bankar të Kosovës operon edhe një bankë me origjinë nga Serbia, e cila ka pjesëmarrje prej 1.8 përqind në gjithsej asetet e sektorit. Dy bankat vendore, në dhjetor 2014 kishin një pjesëmarrje prej 9.6 përqind në gjithsej asetet e sektorit bankar, që krahasuar me vitin e kaluar paraqet rënie për 0.5 pikë përqindje. (figura 23).

Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin bankar ka vazhduar të zvogëlohet edhe gjatë vitit 2014. Pjesëmarrja e aseteve të tri bankave më të mëdha, në dhjetor 2014, ka zbritur në 66.9 përqind krahasuar me 67.4 përqind në vitin paraprak. Rënia e shkallës së koncentrimit vërehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), i cili tregon për një rënie të vazhdueshme të koncentrimit të aseteve dhe kredive gjatë periudhës 2011-2014 (figura 24). Rënia e shkallës së koncentrimit në asete dhe kredi ishte si rezultat i rritjes


më të shpejtë të aseteve dhe kreditimit të bankave më të vogla krahas rritjes më të ngadalësuar të aseteve të tri bankave më të mëdha. Tri bankat më të mëdha, në dhjetor 2014 shënuan rritje vjetore prej 3.7 përqind në asete dhe rënie vjetore prej 0.1 përqind në kredi, krahasuar me rritjen vjetore prej 6.2 përqind në asete dhe 13.9 përqind në kredi të bankave tjera. Në anën tjetër, indeksi sugjeron rritje të lehtë të shkallës së koncentrimit në depozita gjatë vitit 2014, përkundër trendit rënës të ndjekur gjatë tri viteve paraprake. Rritja e lehtë e koncentrimit në depozita në vitin 2014 ishte rezultat i rritjes më të lartë të depozitave në tri bankat më të mëdha (rritje

Figura 23. Struktura e aseteve të bankave komerciale



Burimi: BQK (2015)

Figura 24. HHI për asete, kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2015)

vjetore prej 4.4 përqind) krahasuar me rritjen e depozitave në bankat tjera (rritje vjetore prej 2.1 përqind).

6.2. Aktiviteti i Sektorit Bankar

6.2.1. Asetet


Vlera e aseteve të sektorit bankar të Kosovës në dhjetor 2014 arriti në 3.18 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.2 përqind që paraqet një ngadalësim të trendit të rritjes kur kemi parasysh normën e rritjes prej 8.1 përqind të regjistruar në dhjetor 2013 (figura 25). Ngadalësimi i ritmit të rritjes të aktivitetit bankar kryesisht erdhi si rezultat i ngadalësimit të rritjes së depozitave, që kryesisht ishte pasojë e rënies së theksuar të normave të interesit në depozita gjatë vitit 2014.

Në kuadër të strukturës së aseteve të sektorit bankar, vërehet një rritje e lehtë e peshës së kategorive si bilanci me bankat komerciale, letrat me vlerë dhe kreditë, përderisa pjesëmarrja e kategorisë së parasë së gatshme dhe bilancit me BQK në gjithsej asetet shënoi rënie. Lëvizjet në strukturën e aseteve tregojnë për alokimin e tepricës së rezervave mbi minimumin e obliguar të mbajtura në BQK në instrumente që sjellin fitim siç janë kreditë, letrat me vlerë dhe bilancit me bankat komerciale. Rritja e pjesëmarrjes së

kreditimit në gjithsej asetet e sektorit reflekton ritmin e përshpejtuar të rritjes së kredive gjatë vitit 2014 dhe rikuperimin nga rritja e ngadalshme e viteve të fundit. Për dallim nga kreditë, kategoritë e letrave me vlerë dhe bilancit me bankat komerciale shënuan ngadalësim të rritjes gjatë vitit 2014, ndërsa paraaja e gatshme dhe bilanci me BQK u karakterizuan me rënie vjetore (figura 26). Kategoria e bilancit me bankat komerciale, që përfshinë depozitat dhe linjat kreditore në banka jashtë vendit, shënoi rritje prej 15.0 përqind (18.1 përqind në vitin 2013). Ndërsa, paraaja e gatshme dhe bilanci me BQK-në ishte e vetmja kategori në kuadër të aseteve që u karakterizua me rënie gjatë vitit 2014. Kjo kategori ka shënuar rënie vjetore prej 3.5 përqind krahasuar me rritjen prej 8.8 përqind të vitit paraprak (tabela 2). Rënia ishte kryesisht rezultat i rënies vjetore prej 5.1 përqind të rezervave të bankave komerciale në BQK.


Kategoria e investimeve në letra me vlerë në dhjetor 2014 arriti në 383.8 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.3 përqind, dukshëm më të ulët se sa rritja prej 38.2 përqind e shënuar në vitin paraprak. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e letrave me vlerë në asetet e sektorit bankar arriti në 12.0 përqind në dhjetor 2014 nga 11.6 përqind sa ishte në vitin paraprak. Në kuadër të gjithsej investimeve në letra me vlerë, gjatë vitit 2014, vërehet një orientim më i madh i bankave drejt investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në dhjetor 2014,

Figura 25. Struktura e aseteve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2015)


Figura 26. Rritja vjetore e aseteve të sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës shënuan rritje vjetore prej 92.6 përqind, duke rritur pjesëmarrjen në gjithsej portfolion e investimeve në letra me vlerë në 50.2 përqind (28.2 përqind në dhjetor 2013) (figura 27). Orientimi drejt investimeve në vend ishte kryesisht rezultat i normave më të larta të interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës krahasuar me vitin paraprak si dhe krahas normave të ulëta të interesit në letrat me vlerë të qeverive të huaja. Në dhjetor 2014, mesatarja e thjeshtë e normës së interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte 1.6 përqind, krahasuar me normën prej 1.0 përqind sa ishte në vitin paraprak. Faktor tjetër kontribues në rritjen e investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte edhe afati i shkurtër i maturimit të tyre (rreth 73.9 përqind të tyre kishin maturim prej 6 muaj deri në 1 vit.

Figura 27. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Në anën tjetër, investimet në letra me vlerë në sektorin e jashtëm që kryesisht përbëhen nga fletëobligacionet e qeverive të huaja shënuan rënie vjetore prej 25.0 përqind, duke ulur pjesëmarrjen në 49.7 përqind të gjithsej portfolios së investimeve në letra me vlerë (71.8 përqind në dhjetor 2013). Kjo rënie e theksuar e letrave me vlerë në tregun e jashtëm është ndikuar nga rënia e theksuar e normave të interesit nga viti paraprak dhe krahas normave më të larta në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në dhjetor 2014, mesatarja e thjeshtë e normës së interesit e letrave me vlerë të qeverive të huaja⁵ ishte 0.2 përqind krahasuar me normën prej 0.6 përqind sa ishte në vitin paraprak. Investimet në letrat me vlerë të korporatave tjera financiare dhe jo-financiare, që konsiderohen instrumente me shkallë më të lartë të rrezikut, kanë pjesëmarrjen më të ulët në portfolin e investimeve, duke treguar se bankat shmangin investimet me rrezik më të lartë.

Tabela 2. Struktura e aseteve të sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2011		Dhjetor 2012		Dhjetor 2013		Dhjetor 2014	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	331.5	12.5%	425.7	15.0%	463.3	15.1%	447.1	14.0%
Bilanci me bankat komerciale	329.5	12.4%	287.9	10.2%	339.9	11.1%	390.8	12.3%
Letrat me vlerë	202.0	7.6%	256.6	9.1%	354.5	11.6%	383.8	12.0%
Kreditë bruto	1,698.1	64.1%	1,763.4	62.3%	1,805.8	59.0%	1,882.3	59.1%
Asetet Fikse	47.4	1.8%	57.7	2.0%	55.5	1.8%	53.7	1.7%
Asetet Tjera	41.3	1.6%	38.1	1.7%	40.3	1.4%	28.8	0.9%
Gjithsej	2,649.7	100%	2,829.3	100%	3,059.3	100%	3,186.6	100%

Burimi: BQK(2015)


Kreditë

Kreditë vazhdojnë të jenë kategoria kryesore e aseteve të sektorit bankar me pjesëmarrje prej 59.1 përqind në gjithsej asetet e sektorit në vitin 2014. Aktiviteti kreditues ka treguar shenja të rikuperimit duke përsheptuar ritmin e rritjes krahasuar me ngadalësimin e shënuar gjatë dy viteve të fundit. Në dhjetor 2014, vlera e gjithsej kredive arriti në 1.88 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 4.2 përqind (2.4 përqind në dhjetor 2013). Kreditë e reja të lëshuara nga sektori

⁵ Në llogaritje të normës mesatare të interesit për qeveritë e huaja janë përfshirë shtetet: Gjermania, Franca, Belgjika dhe Italia.

bankar në vitin 2014 u karakterizuan me një rritje mjaft të lartë prej 30.4 përqind (kutia 2). Përshpejtimi i rritjes së kreditimit në sektorin bankar erdhi nga ndikimi i ofertës dhe kërkesës për kredi si për ekonomi familjare ashtu edhe për ndërmarrje (figura 28). Rezultatet e anketës së kreditimit bankar për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2014 tregojnë për lehtësim deri në një masë të standardeve dhe kushteve të kreditimit nga ana e bankave, si dhe rritje të kërkesës për kredi nga kredimarrësit (kutia 3). Faktorët kryesor që shpjegojnë politikat më të lehtësuara bankare të kreditimit janë: gjendja e kënaqshme e likuiditetit të sektorit bankar, konkurrenca në sistemin financiar, zhvillimet pozitive në tregun e pasurive të paluajtshme dhe rritja e besueshmërisë së konsumatorëve. Rritja e kërkesës për kredi posaqërisht nga ekonomitë familjare mund të jetë ndikuar nga rritja e pagave për shërbyesit civil dhe lehtësimi i standardeve kredituese nga bankat.

Figura 28. Kontributi në rritjen e kredive sipas sektorëve, në pikë përqindje



Struktura e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë për ndërmarrje të cilat në dhjetor 2014 përfaqësuan 65.9 përqind të gjithsej kredive dhe shënuan rritje vjetore prej 2.1 përqind (2.0 përqind në dhjetor 2013). Megjithatë, kontributin kryesor në rritjen e përshpejtuar të gjithsej kredive e patën kreditë për ekonomitë familjare, të cilat përbëjnë 33.7 përqind të gjithsej kredive dhe shënuan rritje vjetore të përshpejtuar prej 12.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 3.9 përqind në vitin e kaluar. Kreditë tjera, pra ato në valutë jo euro dhe kreditë ndaj organizatave jo qeveritare të cilat përfaqësojnë 0.3 përqind të gjithsej kredive, shënuan rënie vjetore prej 12.0 përqind. Gjithashtu, kreditë ndaj jo rezidentëve (kryesisht kredi të lëshuara për ndërmarrjet e huaja), me pjesëmarrje prej 0.02 përqind në dhjetor 2014 që përfaqësojnë edhe kategorinë më të vogël të gjithsej kreditimit bankar, regjistruan rënie vjetore prej 97.7 përqind.

Kutia 2. Kreditë e reja

Vlera e gjithsej kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar gjatë viti 2014 arriti në 993.9 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 30.4 përqind. (figura 29).

Figura 29. Rritja vjetore e kredive të reja dhe gjithsej kredive, në përqindje






Figura 30. Kreditë e reja sipas sektorëve, në milionë euro



Kreditë e reja vazhdojnë të dominohen nga kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat në dhjetor 2014 përfaqësuan 61.9 përqind të gjithsej kredive të reja dhe shënuan rritje vjetore prej 31.5 përqind (figura 30). Ndërsa,


kreditë e destinuar për ekonomitë familjare përbënë 38.1 përqind të gjithëj kredive të reja dhe shënuan rritje vjetore prej 28.7 përqind (figura 31).

Figura 31. Rritja vjetore e kredive të reja, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 32. Kategoritë kryesore të kredive të reja, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Struktura e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve përbëhet nga kreditë investuese, kreditë jo-investuese dhe kreditë me kushte favorizuese. Kreditë investuese vazhdojnë të dominojnë me pjesëmarrje prej 59.8 përqind në gjithëj kredive të reja të ndërmarrjeve (figura 32). Kreditë jo-investuese dhe ato me kushte favorizuese në vitin 2014 përfaqësuan 31.3 përqind përkatësisht 8.9 përqind të gjithëj kredive të reja të lëshuara për ndërmarrjet.

Struktura e kredive të reja të lëshuara për ekonomitë familjare përbëhet kryesisht nga kreditë konsumuese, kreditë hipotekare dhe kreditë me kushte favorizuese. Kreditë konsumuese, të cilat vazhdojnë të dominojnë kreditë e reja ndaj ekonomive familjare, në vitin 2014 zgjeruan pjesëmarrjen në 74.4 përqind të gjithëj kredive të reja ndaj ekonomive familjare (64.4 përqind në vitin 2013). Kreditë hipotekare vazhduan të kenë pjesëmarrje prej 14.0 përqind në kreditë e reja ndaj ekonomive familjare edhe gjatë vitit 2014. Ndërsa, kreditë me kushte favorizuese zvogëluan pjesëmarrjen në strukturën e kredive të reja për ekonomitë familjare në 8.5 përqind nga 15.6 përqind sa ishin në vitin 2013.

Figura 33. Gjithëj kredite, kreditë e reja, kreditë e paguara dhe kreditë e pakthyer, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Me qëllim që të identifikohet efekti i kredive të reja, kredive të kthyer, si dhe kredive të shlyera (angl. write-offs) në rritjen e stokut të gjithëj kredive aktive, në figurën 33 janë paraqitur trendet e zhvillimit të këtyre tri kategorive të kredive. Të tri kategoritë kanë ndikim të ndryshëm në vlerën e gjithëj kredive aktive, ku kreditë e reja ndikojnë pozitivisht në rritjen e kësaj vlere, ndërsa kthimi i kredive si dhe kreditë e shlyera kanë efekt negativ apo zvogëlues në vlerën e gjithëj kredive aktive. Në figurën 33 mund të shihet që vlera e kredive të reja të akumuluar gjatë një viti është dukshëm më e lartë në 2014 krahasuar me vitet paraprake. Kjo rritje e kredive të reja u reflektua edhe në rritjen e kredive të kthyer të cilat shënuan rritje vjetore prej 28.9 përqind (5.7 përqind në vitin 2013), kurse kreditë e shlyera shënuan rënie vjetore prej 21.6 përqind (rritje prej 18.8 përqind në vitin 2013).

Në vitin 2014, raporti i shumës së kredive të kthyer dhe atyre të shlyera ndaj kredive të reja ishte 92.3 përqind krahasuar me 94.4 përqind në vitin 2013. Kjo nënkupton që përkundër rritjes së lartë të kredive të reja në vitin 2014, efekti i tyre në rritjen e gjithëj stokut të kredive ishte i ulët për shkak të nivelit të lartë të kredive të kthyer dhe atyre të shlyera, pavarësisht që ky raport shënoi rënie për 2.1 pikë përqindje. Megjithatë, zvogëlimi i raportit të shumës së kredive të kthyer dhe atyre të shlyera ndaj kredive të reja ka ndikur në përshpejtimin e trendit të rritjes së gjithëj kredive aktive në vitin 2014.

Raporti i kredive të shlyera ndaj gjithsej kredive të reja u zvogëluar në 1.6 përqind nga 2.6 përqind në 2013, që nënkupton se efekti i kredive të shlyera në 'mënjanimin' e rritjes së gjithsej kredive nga rritja e kredive të reja është duke u zvogëluar. Po ashtu, raporti i kredive të kthyera ndaj gjithsej kredive të reja u zvogëluar në 90.7 përqind nga 91.8 përqind në 2013 dhe ndikoi në rritjen e gjithsej stokut të kredive në vitin 2014.

Në vitin 2014, gjithashtu edhe "raporti i shumës së kredive të kthyera dhe atyre të shlyera ndaj kredive të reja" për ekonomitë familjare dhe për ndërmarrjet u përmirësua krahasuar me vitin e kaluar, por që është më i theksuar tek ndërmarrjet.

Kutia 3. Anketa mbi Kreditimin Bankar

Rezultatet e fundit të Anketës mbi Kreditimin Bankar pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës shtator 2014 – mars 2015, si dhe pritjet mbi ndryshimet në aktivitetin kreditues në periudhën prill – shtator 2015.

Aktiviteti kreditues në gjysmën e dytë të vitit 2014 dhe në muajt e parë të vitit 2015 është karakterizuar me një rritëm të përshpejtuar të rritjes, kundrejt ngadalësimit të rritjes që ishte shfaqur në periudhën paraprake. Dinamika e aktivitetit kreditues në vend vlerësohet të ketë qenë në nivelin më të lartë në tre vitet e fundit. Trendi i përshpejtuar i rritjes së kreditimit që karakterizoi vitin 2014 dhe muajt e parë të vitit 2015 i atribuohet kryesisht ofertës më të lehtësuar kredituese të bankave për ndërmarrjet dhe për ekonomitë familjare gjatë kësaj periudhe, përderisa kërkesa raportohet të ketë qenë më e ulët nga ndërmarrjet e mëdha por më e lartë nga NVM-të dhe ekonomitë familjare.

Oferta e lehtësuar kredituese për ndërmarrjet në përgjithësi i atribuohet lehtësimit të standardeve të kredidhënies, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) dhe për kreditë afatgjata, përderisa rikonfirmohet qasja më konservatore e bankave për kreditimin e ndërmarrjeve të mëdha. Rritja e mbështetjes për NVM-të përmes standardeve më të lehtësuara kreditore, sidomos në sektorët më pak të kredituar më parë si bujqësia dhe prodhimi, si dhe rritja e kreditimit afatgjatë tregon për një lëvizje graduale të bankave nga qasja konservatore drejtë alternativave që mundësojnë zgjerim më të madh të afarizmit të tyre.

Standardet për kreditë që janë dhënë ekonomive familjare u lehtësuan deri në një masë në periudhën raportuese. Standardet kreditore janë lehtësuar për të dy kategoritë, kreditë për blerje të shtëpive dhe kreditë konsumuese. Nëse analizojmë standardet e kredidhënies sipas qëllimit të përdorimit, vërehet se bankat kanë deklaruar standarde më të lehtësuara kredituese si për kreditë konsumuese, ashtu edhe për kreditë për blerje të shtëpive. Sa i përket shkallës së aprovimit të kredive, në periudhën shtator 2014 – mars 2015, bankat deklaruan të kenë aplikuar një qasje më të lehtësuar kryesisht për NVM-të dhe kreditë konsumuese.

Faktorët kryesorë që shpjegojnë politikat më të lehtësuara bankare të kreditimit në periudhën shtator 2014 – mars 2015 ishin pozita e kënaqshme e likuiditetit të bankave komerciale, konkurrenca në sistemin financiar dhe pritjet e bankave mbi zhvillimet ekonomike në vend. Politika më e lehtësuar kredituese e bankave në periudhën raportuese është realizuar kryesisht përmes uljes së normave mesatare të interesit, ofrimit të kredive me afat më të gjatë maturimi dhe rritjes së shumës së kredisë.

Përderisa kërkesa për kredi në periudhën shtator 2014 – mars 2015 u raportua nga bankat pjesëmarrëse në anketë të jetë rritur nga NVM-të dhe ekonomitë familjare përgjithësisht, bankat deklaruan rënie të kërkesës për kredi në këtë periudhë nga ndërmarrjet e mëdha. Në kuadër të ekonomive familjare, kërkesa për kredi ishte kryesisht më e lartë për kreditë për blerje të shtëpive, por edhe për kredi konsumuese. Sa i përket maturitetit të kredive, nga bankat komerciale është theksuar të jetë vënë re një rritje e kërkesës për kredi afatgjata në periudhën raportuese. Rritja e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare ishte në linjë me rritjen e konsumit të brendshëm gjatë kësaj periudhe, e që mund të jetë nxitur nga rritja e pagave dhe mëditjeve për shërbyesit civil në Prill 2014 si dhe nga rënia e vazhdueshme me të cilën është karakterizuar kosto e financimit nga bankat. Në anën tjetër, rritja e kërkesës nga NVM-të është neutralizuar deri në një masë nga rënia e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e mëdha, që mund të atribuohet edhe aktivitetit të dobët investues që karakterizoi vendin përgjithësisht në vitin 2014. Rritja e lehtë e kërkesës për kredi nga NVM-të raportohet të jetë ndikuar pozitivisht nga rritja e kërkesës për financim të investimeve fikse të


ndërmarrjeve, për financim të kapitalit punues dhe ristrukturim të borxhit. Ndërkaq, kërkesa lehtësisht e rritur nga ekonomitë familjare kryesisht i është atribuar zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme dhe rritjes së besueshmërisë së konsumatorëve.

Në gjashtë muajt e ardhshëm (prill-shtator 2015), oferta kredituese e bankave, shprehur përmes standardeve të aplikuara kreditore, pritet të mbetet përgjithësisht e lehtësuar. Lehtësim të standardeve kreditore bankat kanë deklaruar të presin kryesisht për NVM-të sa i përket kreditimit të ndërmarrjeve, përderisa pothuajse të gjitha bankat deklaruan se presin lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore që do të aplikojnë për ekonomitë familjare (kredi konsumuese dhe kredi për blerje të shtëpive). Edhe sa i përket shkallës së aprovimit të kredive, bankat presin një qasje më të lehtë në financim bankar nga NVM-të dhe ekonomitë familjare. Për periudhën prill - shtator 2015, bankat kanë deklaruar se presin një rikuperim të kërkesës për kredi. Kërkesa për kredi pritet të jetë më e lartë nga NVM-të, por edhe nga ndërmarrjet e mëdha. Kërkesë më të lartë bankat presin edhe nga ekonomitë familjare.

Struktura e kredive sipas aktivitetit ekonomik

Struktura e kredive të ndërmarrjeve, sipas aktivitetit ekonomik, mbetet e ngjashme me vitet paraprake (figura 34). Kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë paraqesin kategorinë më të madhe me pjesëmarrje prej 53.4 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet, pasuar nga kreditë e destinuar për sektorin e industrisë (miniera, prodhimtari, energjetikë, dhe ndërtimtari të paraqitura në figurën 35) me pjesëmarrje prej 23.3 përqind në dhjetor 2014. Qasjen më të ulët në financimin bankar vazhdon ta ketë sektori i bujqësisë me pjesëmarrje prej 4.0 përqind në gjithsej kreditë e ndërmarrjeve.


Figura 34. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Gjatë vitit 2014, sektorët ekonomik që shënuan rritje të kreditimit ishin prodhimtaria, bujqësia dhe tregëtia. Rritja i atribuohet kryesisht rënies së normave të interesit për kreditë e këtyre sektorëve gjatë kësaj periudhe. Faktor tjetër që mund të ketë nxitur rritje në sektorët e lartë përmendur është edhe lehtësimi i standardeve për kreditim të ndërmarrjeve nga ana e bankave.

Figura 35. Struktura e kredive të sektorit të industrisë sipas nënkategorive, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Gjatë vitit 2014, kreditë e destinuar për sektorin e prodhimit shënuan rritjen vjetore më të theksuar prej 13.1 përqind për dallim nga rënia vjetore prej 1.0 përqind e shënuar në vitin paraprak. Kjo reflekton rritjen e përkrahjes për sektorin e prodhimit nga bankat komerciale në vend të cilat ofruan normë më të ulët të interesit në këto kredi gjatë vitit. Faktor tjetër që mund të ketë ndikuar rritjen e kreditimit për këtë sektor janë edhe zhvillimet e përgjithshme në sektorin e prodhimit, ku është evidentuar rritje e theksuar e numrit të bizneseve të regjistruara gjatë vitit 2014.

Me rritje të përshpejtuar u karakterizuan edhe kreditë e destinuar për sektorin e bujqësisë të cilat shënuan rritje vjetore prej 7.9 përqind (5.0 përqind në dhjetor 2013) (figura 36). Përveç rënies së normës së interesit, ndikim në rritjen e kreditimit për sektorin e bujqësisë mund të ketë pasur edhe mbështetja e nga USAID përmes projektit për garantimin e kredive të këtij sektori. Bazuar në planet e Qeverisë së Kosovës për hartimin e një skeme për garantimin e kredive të sektorit të bujqësisë, pritjet rritje e mëtejme e kreditimit dhe poashtu përmirësim i mëtejme i kushteve të kreditimit për këtë sektor.

Figura 36. Ndryshimi vjetor në kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Me rritje të përshpejtuar u karakterizuan edhe kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë të cilat në dhjetor 2014 shënuan rritje prej 3.6 përqind krahasuar me vitin e kaluar kur regjistruan rritje prej vetëm 0.8 përqind. Përshpejtimi i kreditimit në sektorin e tregtisë, mes tjerash, reflekton edhe rritjen e aktivitetit tregtar të Kosovës me vendet tjera. Faktor tjetër që mund të ketë ndikuar përshpejtimin e rritjes së kreditimit ishte edhe rritja e numrit të bizneseve të regjistruara në sektorin e tregtisë gjatë vitit 2014 krahasuar me rënien theksuar të shënuar në vitin paraprak.

Në anën tjetër, pavarësisht rënies së normës së interesit për sektorët ekonomik, dhe standardeve të lehtësuara të kreditimit për ndërmarrje nga ana e bankave, sektorët e energjetikës ndërtimtarisë dhe minierave kanë shënuar rënie në vitin 2014.

Në dhjetor 2014, kreditë e lëshuara për sektorin e energjetikës shënuan rënie vjetore prej 17.8 përqind krahasuar me rritjen prej 30.6 përqind të regjistruar në dhjetor 2013. Megjithatë, kreditimi ndaj sektorit të energjetikës gjatë pjesës më të madhe të vitit 2014 u karakterizua me rritje e cila përfundimisht u neutralizua nga rënia e theksuar prej 19.6 përqind në muajin dhjetor 2014. Ndikim të rëndësishëm në rënien e theksuar të kreditimit e sektorit ka pasur përfundimi i linjës kreditore afatmesëme prej 1.8 milion euro në dhjetor 2014. Efekti i kësaj linje kreditore ishte i theksuar duke marrë parasysh që kreditë për këtë sektor dominohen nga kreditë me afat maturimi deri në 1 muaj.

Kreditimi i sektorit të ndërtimtarisë gjatë vitit 2014 u karakterizua me rënie të mëtejme, duke shënuar rënie vjetore prej 12.2 përqind në dhjetor 2014 (rënie prej 5.2 përqind në dhjetor 2013). Rënia e kreditimit për këtë sektor mund të ketë reflektuar zhvillimet e përgjithshme në sektorin e ndërtimtarisë, ku vlerësohet të ketë pasur rënie të aktivitetit. Në vitin 2014, është evidentuar rënie e numrit të ndërmarrjeve të reja të regjistruara në sektorin e ndërtimtarisë, si dhe rritje e numrit të bizneseve të shuara në këtë sektor krahasuar me vitin paraprak.

Me rënie u karakterizuan edhe kreditë për sektorin e minierave, të cilat në dhjetor 2014 shënuan rënie prej 2.2 përqind (rritje prej 24.7 përqind në dhjetor 2013). Rënia e aktivitetit në sektorin e minierave, që paraqitet përmes indeksit të qarkullimit industrial, ka ndikuar që kërkesa për kredi nga ky sektor të zvogëlohet, duke u reflektuar kështu në rënie të kreditimit për sektorin e minierave.

Struktura kredive sipas afatit të maturimit

Struktura e kredive sipas afatit të maturimit gjatë vitit 2014 ishte e ngjashme me periudhat paraprake (figura 37). Pjesa më e madhe e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë me afat më të gjatë maturimi. Kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 vite’ në dhjetor 2014 përfaqësuan 69.2 përqind të gjithsej kredive, duke shënuar zgjerim të lehtë të pjesëmarrjes në krahasim me vitin 2013. Zgjerimi reflekton normën më të lartë të rritjes vjetore prej 7.3 përqind (figura 38) të vlerës së kredive me këtë afat maturimi.


Kreditë me afat më të shkurtër maturimi, gjegjësisht ‘deri në 1 vit’, vazhduan të jenë kategoria e dytë për nga madhësia me pjesëmarrje prej 23.5 përqind në gjithsej kreditë (25.0 përqind në dhjetor 2013). Ndërsa, kreditë me afat të mesëm maturimi, gjegjësisht ‘1 deri në 2 vite’, vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të ulët në kuadër të gjithsej kredive, duke u përfaqësuar me 7.3 përqind në dhjetor 2014 (7.7 përqind në dhjetor 2013). Kreditë me maturim afatshkurtër, gjatë vitit 2014, shënuan rënie të vlerës prej 2.0 përqind.

Rritja e kreditimit afat gjatë është shprehur si te kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu edhe te kreditë ndaj ekonomive familjare. Në kuadër të kreditimit të ndërmarrjeve, rritja e kreditimit afatgjatë është më e theksuar për sektorët e prodhimitarisë, bujqësisë, tregtisë dhe shërbimeve tjera. Faktor kryesor që mund të ketë ndikuar në rritjen e kreditimit afatgjatë është ofrimi i normave më të ulëta të interesit nga bankat komerciale në vend për kreditë afatgjata ndaj këtyre sektorëve të ekonomisë (figura 39).

6.2.2. Detyrimet


Në vitin 2014, struktura e detyrimeve të sektorit bankar të Kosovës vazhdoi të jetë e ngjashme me vitet paraprake. Depozitat vazhdojnë të paraqesin burimin kryesor të financimit për bankat

Figura 37. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Figura 38. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 39. Struktura e maturimit të kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

komerciale në vend, duke përfaqësuar 79.6 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar (tabela 3). Rritja e vazhdueshme e depozitave vendore ka bërë që bankat të përfitojnë nga një burim i qëndrueshëm i financimit dhe të evitojnë ekspozimin ndaj luhatjeve të tregjeve financiare ndërkombëtare.

Kategoria e dytë për nga pjesëmarrja në gjithsej detyrimet e sektorit vazhdon të mbetet ajo e mjeteve vetanake që në dhjetor 2014 përfaqësoi 10.1 përqind të gjithsej detyrimeve. Kjo kategori ka shënuar rritje vjetore prej 16.3 përqind krahasuar me rritjen prej 2.6 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja e theksuar e mjeteve vetanake ishte ndikuar kryesisht nga rritja e përshpejtuar e profitit të akumuluar të sektorit bankar gjatë vitit 2014.

Në kuadër të detyrimeve, rritjen vjetore më të theksuar prej 93.4 përqind ka shënuar kategoria e bilancit nga bankat komerciale që reflekton rritjen e aktivitetit ndërbankar. Në anën tjetër, kategoria e borxhit të ndërvarur ishte kategoria me rënie më të theksuar në kuadër të detyrimeve. Borxhi i ndërvarur, gjatë vitit 2014, ka shënuar rënie prej 16.0 përqind krahasuar me rritjen e theksuar prej 81.5 përqind që u shënuar në vitin 2013. Rritja e theksuar e borxhit të ndërvarur gjatë vitit 2013 ishte rrjedhojë e ndryshimeve të kërkesave rregullatore, të cilat kërkuan rritje të kapitalit nga ana e bankave, ku një pjesë e kapitalit shtesë u financua përmes borxhit të ndërvarur. Ndërsa, performanca e mirë financiare e sektorit bankar gjatë vitit 2014, e shprehur me një rritje të theksuar të profitit, ka zvogëluar nevojën e shfrytëzimit të borxhit të ndërvarur për plotësimin e kërkesave të kapitalit.

Tabela 3. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2011		Dhjetor 2012		Dhjetor 2013		Dhjetor 2014	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	40.0	1.5%	6.0	0.2%	16.5	0.5%	31.8	1.0%
Depozitat	2,104.0	79.4%	2,279.1	80.6%	2,449.0	80.1%	2,537.0	79.6%
Huatë tjera	30.4	1.1%	18.9	0.7%	13.4	0.4%	14.9	0.5%
Detyrimet tjera	191.5	7.2%	223.6	7.9%	246.2	8.0%	232.7	7.3%
Borxhi i ndërvarur	31.0	1.2%	31.0	1.1%	56.3	1.8%	47.3	1.5%
Mjetet vetanake	252.8	9.5%	270.7	9.6%	277.8	9.1%	323.1	10.1%
Gjithsej detyrimet	2,649.7	100%	2,829.3	100%	3,059.3	100%	3,186.8	100%


Burimi: BQK (2015)

Depozitat

Në dhjetor 2014, gjithsej depozitat në sektorin bankar të Kosovës arritën vlerën prej 2.53 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.6 përqind. Ky vit ka regjistruar ngadalësim të trendit të rritjes së depozitave, që kryesisht është pasojë e rënies së theksuar të normës së interesit në depozita gjatë kësaj periudhe. Ngadalësimi i rritjes së depozitave mund të jetë ndikuar edhe nga rritja e emigrimit nga Kosova në muajt e fundit të vitit 2014.

Depozitat e ekonomive familjare, të cilat konsiderohen të jenë më stabile në raport me burimet tjera të financimit, vazhdojnë ta dominojnë

Figura 40. Struktura e depozitave dhe rritja vjetore, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

strukturën e depozitave të sektorit bankar duke përfaqësuar 72.8 përqind të gjithë depozitave (figura 40). Vlera e depozitave të ekonomive familjare, në dhjetor 2014, shënoi rritje vjetore prej 4.1 përqind, në krahasim me rritjen vjetore prej 8.2 përqind në dhjetor 2013, duke paraqitur kështu kontribuesin kryesor në ngadalësimin e rritjes së gjithë depozitave. Depozitat e ndërmarrjeve përbënë 22.1 përqind të gjithë depozitave dhe shënuan rritje vjetore prej 0.7 përqind, e cila poashtu paraqet normë më të ulët të rritjes krahasuar me vitin paraprak (5.4 përqind në dhjetor 2013).


Struktura e depozitave të ndërmarrjeve vazhdon të përfaqësohet kryesisht nga depozitat e korporatave jo-financiare (ndërmarrjet private), të cilat përbëjnë 70.8 përqind të gjithë depozitave të ndërmarrjeve (figura 41). Krahasuar me vitin paraprak, kjo kategori shënoi rënie vjetore prej 0.3 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 18.5 të shënuar në dhjetor 2013). Kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e depozitave të ndërmarrjeve janë depozitat e korporatave tjera financiare, e cila në dhjetor 2014, ishte e vetmja kategori në kuadër të depozitave të ndërmarrjeve e cila shënoi rritje vjetore prej 18.1 përqind. Rritja e saj ishte kryesisht rezultat i rritjes së depozitave të fondeve pensionale dhe kompanive të sigurimit. Kategoria e depozitave të ndërmarrjeve publike është karakterizuar me rënie më të theksuar prej 14.3 përqind, duke u bërë kështu edhe kontribuesi kryesor në ngadalësimin e rritjes së depozitave të ndërmarrjeve.

Në pjesën e mbetur të gjithë depozitave përfshihen depozitat e jorezidentëve me pjesëmarrje prej 3.5 përqind dhe depozitat tjera (qeveria dhe organizatat tjera jo-qeveritare) me pjesëmarrje prej 1.6 përqind. Depozitat e jorezidentëve vlera e të cilave arriti në 88.9 milionë euro gjatë vitit 2014 shënuan rënie vjetore prej 0.2 përqind (figura 42). Ndërsa, depozitat tjera u karakterizuan me rritje vjetore prej 39.0 përqind kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të qeverisë qendrore në bankat komerciale.

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit


Sipas afatit të maturimit, struktura e depozitave ka pësuar ndryshime gjatë vitit 2014. Përderisa në vitin paraprak struktura e depozitave dominohej nga depozitat e afatizuara, në dhjetor 2014, pjesa më e madhe e depozitave ishin në formë të depozitave të transferueshme me pjesëmarrje prej 47.2 përqind të gjithë depozitave. Depozitat e afatizuara rreshtohen si kategoria e dytë për nga madhësia me pjesëmarrje prej 31.7 përqind, ndërsa ato në formë të kursimeve përbëjnë pjesën e mbetur prej 21.1 përqind të gjithë depozitave. Ndryshimet në strukturën e depozitave sipas afatit të maturimit (figura 43) tregojnë se rënia e theksuar e normës së interesit në depozita ka dekurajuar depozitorët të afatizojnë depozitat.

Figura 41. Struktura e depozitave të ndërmarrjeve sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 42. Depozitat e jo-rezidentëve dhe norma e interesit në depozita



Burimi: BQK (2015)


Rritja e pjesëmarrjes së depozitave të transferueshme në strukturën e gjithsej depozitave kryesisht reflekton rritjen e theksuar vjetore prej 33.0 përqind të kësaj kategorie gjatë vitit 2014. Në kuadër të depozitave të transferueshme, depozitat e ekonomive familjare regjistruan rritjen më të theksuar vjetore prej 46.8 përqind (rritje prej 24.4 përqind në dhjetor 2013), duke shënuar kontributin kryesor në rritjen e gjithsej depozitave të transferueshme. Depozitat e transferueshme të ndërmarrjeve janë karakterizuar me rritje më të ngadalsuar prej 12.6 përqind krahasuar me rritjen prej 16.7 përqind të shënuar në vitin paraprak.

Depozitat e afatizuara gjatë vitit 2014 shënuan rënie vjetore prej 29.7 përqind. Kjo rënie ishte kryesisht rezultat i depozitave të afatizuara të ekonomive familjare të cilat shënuan rënie të theksuar prej 31.6 përqind. Depozitat tjera të afatizuara (qeveria dhe organizatat tjera jo-qeveritare) ishin e vetmja kategori që shënoi rritje, duke regjistruar një normë të rritjes vjetore prej 7.9 përqind (33.7 përqind në dhjetor 2013).

Në kuadër të strukturës së depozitave të afatizuara, gjatë vitit 2014 është regjistruar rënie e depozitave afatshkurtëra 'deri në 1 vit', përdërisa është shënuar rritje e depozitave afatmesme 'nga 1 deri në 2 vite' dhe depozitave afatgjata 'mbi 2 vite' (figura 44). Në dhjetor 2014, depozitat me afat marutimi 'deri në një vit', të cilat vazhdojnë të jenë kategoria kryesore e depozitave të afatizuara, kishin pjesëmarrje prej 50.9 përqind në gjithsej depozitat e afatizuara, krahasuar me pjesëmarrjen prej 62.1 përqind në vitin paraprak. Zhvendosja në strukturën e depozitave të afatizuara drejt maturimit afatgjatë mund të jetë refleksion i normave të interesit më të larta që bartin kreditë me afat më të gjatë maturimi.


Depozitat në formë të kursimeve kanë shënuar përsheptim të rritjes në dhjetor 2014, duke regjistruar normë vjetore të rritjes prej 32.4 përqind (13.8 përqind dhjetor 2013). Në kuadër të tyre, depozitat e jorezidentëve kanë shënuar rritje të theksuar prej 40.3 përqind në krahasim me rritjen prej 8.4 përqind të regjistruar në vitin paraprak. Megjithatë, depozitat e ekonomive familjare ishin kontribuesi kryesor në rritje të depozitave të kursimit, duke marrë parasysh që dominojnë strukturën e tyre dhe shënuan rritje prej 32.2 përqind (20.0 përqind në dhjetor 2013). Ndërsa, kategoria e depozitave tjera e cila përbënë 0.04 përqind të gjithsej depozitave të kursimit ishte e vetmja kategori në kuadër të këtyre depozitave që shënoi rënie vjetore prej 36.6 përqind në dhjetor 2014.

Figura 43. Struktura e depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 44. Struktura e depozitave të afatizuara, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


6.2.3. Normat e Interesit

Normat e interesit në kredi dhe depozita vazhduan trendin rënës edhe gjatë vitit 2014. Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 9.2 përqind në dhjetor 2014 nga 11.1 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Zvogëlimi i normës së interesit në kredi reflekton zvogëlimin e normës së interesit në depozita gjatë kësaj periudhe dhe po ashtu mund të jetë rezultat i presioneve më të mëdha konkurruese në tregun bankar, indikacion i të cilave mund të jetë edhe lehtësimi i standardeve dhe kushteve të kreditimit nga bankat. Norma mesatare e interesit në depozita në dhjetor 2014 u zvogëluar në 1.1 përqind nga 2.4 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Rënia ishte kryesisht si rezultat i prezencës së mjaftueshme të likuiditetit në sektorin bankar. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita në dhjetor 2014 u zvogëluar në 8.1 pp, nga 8.7 pp sa ishte në dhjetor 2013 (figura 45).

Trendi rënës i normave të interesit në kredi vërehet si te kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu dhe te kreditë ndaj ekonomive familjare (figura 46). Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve zbriti në 9.4 përqind në dhjetor 2014 nga 10.9 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, kreditë investuese u karakterizuan me me normë mesatare të interesit prej 9.7 përqind në dhjetor 2014 (10.9 përqind në dhjetor 2013), përderisa kreditë tjera të biznesit kishin normë mesatare të interesit prej 10.5 përqind (12.3 përqind në dhjetor 2013) (figura 47).


Sa i përket kredive ndaj ndërmarrjeve sipas maturitetit, norma më e lartë e interesit në dhjetor 2014 u regjistrua te kreditë tjera të biznesit me maturim 'mbi 5 vite' (11.8 përqind), ndërsa më e ulëta u shënua te kreditë investuese me maturim 'mbi 5 vite' (8.4 përqind). Rënia e normave të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve gjatë vitit 2014 u reflektua në rritjen e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve gjatë kësaj periudhe të cilat shënuan rritje të theksuar krahasuar vitin e kaluar.

Figura 45. Mesatarja e normave të interesit, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Normat mesatare të interesit në kredi për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 47. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëluar në 9.0 përqind në dhjetor 2014 nga 11.4 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Në kuadër të kredive ndaj ekonomive familjare, norma e interesit në kreditë konsumuese zbriti në 9.1 përqind në dhjetor 2014 (11.7 përqind në dhjetor 2013), ndërsa norma mesatare e kredive hipotekare zbriti në 8.2 përqind (9.7 përqind në dhjetor 2013) (figura 48). Tek kreditë hipotekare ulja më e theksuar e normave të interesit në 8.0 përqind në dhjetor 2014 nga 10.4 përqind në dhjetor 2013 u shënuar të kreditë me maturim 'mbi 5 deri në 10 vite'. Rënia e normave të interesit në kreditë për ekonomitë familjare gjithashtu u reflektua në rritjen e kredive të reja gjatë vitit 2014, të cilat shënuan rritje të theksuar krahasuar me vitin paraprak.

Sa i përket normave të interesit në kredi sipas sektorëve ekonomik, sektori i bujqësisë vijon të karakterizohet me normën më të lartë të interesit në kredi përkundër uljes së regjistruar gjatë vitit ku norma mesatare zbriti në 12.6 përqind nga 15.0 përqind sa ishte në dhjetor 2013 (figura 49). Megjithatë mbetet në nivel më të lartë krahasuar me sektorët tjerë, norma e interesit për kreditë e sektorit të bujqësisë u karakterizua me rënie më të theksuar gjatë periudhës 2011-2014, duke ngushtuar kështu dukshëm dallimin me normat e interesit për kreditë e sektorëve tjerë. Norma mesatare e interesit për kreditë e sektorit të industrisë në dhjetor 2014 zbriti në 8.9 përqind nga 11.0 përqind sa ishte në dhjetor 2013, ndërsa për sektorin e shërbimeve (përfshirë edhe tregtinë) zbriti në 9.9 përqind nga 10.9 përqind në dhjetor 2013. Gjatë vitit 2014, norma më e lartë e interesit prej 12.8 përqind është regjistruar në sektorin e bujqësisë të kreditë me afat maturimi 'deri 1 vit', ndërsa norma më e ulët prej 7.8 përqind u regjistrua në sektorin e industrisë të kreditë me afat maturimi 'mbi 5 vite'.


Norma mesatare e interesit në depozita gjatë vitit 2014 shënoi rënie të theksuar krahasuar me vitin paraprak. Rënia në masë të madhe u ndikua nga zvogëlimi i normës në depozitat e ekonomive familjare që edhe dominojnë strukturën e gjithsej depozitave. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare zbriti në 0.9 përqind në dhjetor 2014 nga 2.8 përqind sa ishte

Figura 48. Normat mesatare të interesit në kreditë për ekonomitë familjare, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Figura 49. Normat mesatare të interesit në kredi sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 50. Normat mesatare të interesit në depozita për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

në dhjetor 2013. Gjithashtu, kontribut të rëndësishëm në rënien e normës mesatare të depozitave kishte edhe zvogëlimi i interesit në depozitat e ndërmarrjeve gjatë vitit 2014. Norma mesatare e interesit ishte e ulët pothuajse gjatë tërë vitit, me thekst të veçantë gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë, duke u rikuperuar gjatë tremujorit të fundit në 1.9 përqind në dhjetor 2014 (1.2 përqind në dhjetor 2013) (figura 50)

6.3. Performanca e Sektorit Bankar

Sektori bankar i Kosovës në vitin 2014 ka shënuar një përmirësim të theksuar të performancës financiare. Neto profiti i realizuar në vitin 2014 arriti vlerën prej 60.1 milionë euro, përderisa neto profiti i regjistruar në vitin 2013 ishte 26.0 milionë euro (figura 51).


Gjatë vitit 2014, të hyrat e sektorit bankar shënuan rënie të lehtë, kryesisht si rezultat i rënies së të hyrave nga interesi në kredi dhe të hyrave nga tarifat dhe komisionet. Rrjedhimisht, rritja e profitit të sektorit bankar gjatë vitit 2014 ishte si rezultat i reduktimit të shpenzimeve, veçanërisht atyre për provizione (mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë) dhe shpenzimeve të interesit në depozita.

Duke pasur parasysh performancën jo të kënaqshme të të hyrave, profiti i sektorit bankar mbetet mjaft i ndjeshëm ndaj një rritje të mundshme të normës së interesit në depozita, e cila mund të ndodhë duke marrë parasysh përshpejtimin e rritjes së kreditimit. Poashtu, profiti mbetet i ndjeshëm kundrejt një përkeqësimi të mundshëm të cilësisë së portofolit kreditor, që do të nevojën e rritjes së shpenzimeve për provizione. Prandaj, për të siguruar një nivel të qëndrueshëm të profitit, bankat duhet të gjenerojnë më tepër të hyra, të cilat në kushtet e rënies së normës së interesit në kredi, kërkojnë rritje më të madhe të portofolit kreditor. Sidoqoftë, rritja e kreditimit duhet bërë duke i respektuar parimet e kreditimit të shëndoshë në mënyrë që të sigurohet mirëmbajtja e cilësisë së mirë të portofolit kreditor. Sigurimi i qëndrueshmërisë së profitit poashtu kërkon masa për rritjen e efikasitetit operacional të bankave, që nënkupton një zvogëlim më të qëndrueshëm të shpenzimeve bankare.

Të hyrat


Të hyrat e sektorit bankar në dhjetor 2014 arritën vlerën prej 244.2 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 1.9 përqind. Struktura e të hyrave të sektorit dominohet kryesisht prej të hyrave nga interesi, të pasuara prej të hyrave nga jo-interesi, dhe të hyrave nga rivlerësimi. Të hyrat nga interesi, që përfshijnë të hyrat nga interesi

Figura 51. Profiti neto, të hyrat dhe shpenzimet, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 52. Struktura e përgjithshme e të hyrave, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

në kredi, nga interesi në letra me vlerë, nga interesi në plasmanet me bankat tjera dhe të hyrat tjera, përfaqësojnë 80.2 përqind të gjithë të hyrave të sektorit bankar (figura 52).


Të hyrat nga interesi në dhjetor 2014 shënuan rënie vjetore prej 1.2 përqind (rënie prej 1.1 përqind në dhjetor 2013) duke dhënë kontributin kryesor në rënien e gjithë të hyrave të sektorit bankar. Ndërsa, të hyrat nga jo-interesi të cilat janë kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e përgjithshme të të hyrave, në dhjetor 2014 shënuan rënie vjetore prej 3.6 përqind (rritje prej 6.4 përqind në dhjetor 2013). Efekti i të hyrave nga rivlerësimi në trendin e gjithë të hyrave ka pasur ndikim të ulët duke marrë parasysh pjesëmarrjen prej vetëm 0.2 përqind në strukturën e gjithë të hyrave.

Rënia e gjithë të hyrave nga interesi ishte kryesisht rezultat i rënies së të hyrave nga interesi në kredi, të cilat edhe janë përcaktues kryesor i trendit të të hyrave nga interesi duke marrë parasysh që përbëjnë 96.7 përqind të gjithë të hyrave të interesit (figura 53). Kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e gjithë të hyrave, të hyrat nga jo interesi gjithashtu shënuan rënie kryesisht si rezultat i rënies së të hyrave nga tarifat dhe komisionet, të cilat përbëjnë 93.1 përqind të gjithë të hyrave të jo interesit.

Kategoria e të hyrave nga interesi në kredi në dhjetor 2014 shënoi rënie vjetore prej 1.6 përqind, e cila përkon me rënien e normave të interesit në kredi gjatë kësaj periudhe (figura 54). Të hyrat nga tarifat dhe komisionet gjatë vitit 2014 shënuan rënie vjetore prej 2.6 përqind, përkundër shtrenjëtimit të çmimeve për shërbime të caktuara bankare. Kjo mund të reflektojë rritjen e numrit dhe vëllimit të transaksioneve e-banking gjatë vitit 2014, të cilat kanë tarifa më të ulëta. Deri në dhjetor 2014 numri i transaksioneve e-banking u rrit në 1.6 milionë (1.1 në 2014), përderisa vlera e transaksioneve në 4.2 miliardë euro (2.7 miliardë në 2013)


Kategoria e të hyrave nga interesi në letra me vlerë ishte kategoria e vetme e të hyrave e cila u karakterizua me rritje gjatë vitit 2014. Kjo kategori shënoi rritje vjetore prej 25.8 përqind në

Figura 53. Struktura e të hyrave sipas kategorive, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Figura 54. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 55. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

dhjetor 2014, krahasuar me rënien prej 24.5 të shënuar në vitin paraprak. Rritja reflekton orientimin e bankave komerciale në vend drejt investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës të cilat gjatë vitit kishin norma më të larta të interesit krahasuar me vitin paraprak dhe krahasuar me letrat me vlerë të qeverive të huaja. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës në vitin 2014 ishte 1.6 përqind krahasuar me 1.0 përqind në vitin 2013. Ndikim të rëndësishëm në rritjen e të hyrave nga interesi në letra me vlerë ka pasur edhe plasimi në treg i fletëobligacioneve qeveritare me afat maturimi dy vjeçar, të cilat bartin norma më të larta të interesit.

Shpenzimet


Gjithsej shpenzimet e sektorit bankar, në dhjetor 2014, arritën vlerën prej 184.2 milionë euro, duke shënuar rënie prej 17.4 përqind krahasuar me vitin paraprak. Struktura e shpenzimeve dominohet nga kategoria e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative e cila ka zgjeruar pjesëmarrjen në krahasim me vitin paraprak duke arritur në 55.3 përqind në dhjetor 2014 (45.1 përqind në dhjetor 2013). Kategoria e shpenzimeve të interesit dhe kategoria e shpenzimeve të jo-interesit kanë ngushtuar pjesëmarrjen në strukturën e gjithsej shpenzimeve, duke zbritur pjesëmarrjen në 23.9 përkatësisht 17.2 përqind (figura 55).

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative gjatë vitit 2014 shënuan rritje vjetore prej 1.2 përqind krahasuar me rënien prej 1.9 përqind në 2013 (figura 56). Në kuadër të kësaj kategorie, shpenzimet e përgjithshme shënuan rënie prej 2.2 përqind, ato të personelit shënuan rritje prej 0.1 përqind, kurse shpenzimet tjera nga jo interesi shënuan rritje prej 8.8 përqind.

Shpenzimet e interesit, gjatë vitit 2014, shënuan rënie vjetore prej 31.1 përqind krahasuar me rritjen prej 1.1 përqind të regjistruar në vitin paraprak. Rënia i atribuohet kryesisht zvogëlimit të shpenzimeve të interesit në depozita, komponentit kryesor të kësaj kategorie me pjesëmarrje prej 82.7 përqind në gjithsej shpenzimet e interesit. Shpenzimet e interesit në depozita shënuan rënie vjetore prej 37.3 përqind si rezultat i zvogëlimit të theksuar të normës së interesit në depozita gjatë vitit 2014 (figura 57).


Kategoria e shpenzimeve të jo-interesit ishte kategoria që u karakterizua me rënien më të theksuar prej 43.0 përqind në dhjetor 2014, duke dhënë kontributin kryesor në rënien e gjithsej shpenzimeve gjatë vitit 2014. Zvogëlimi i këtyre shpenzimeve i atribuohet rënies vjetore prej 55.4 përqind të shpenzimeve të provizioneve për humbje ndaj kredive, të cilat edhe përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të jo-interesit. Shuma më e ulët e provizioneve të ndara gjatë kësaj periudhe ishte si rezultat i përmirësimit të cilësisë së portofolit kreditor, përkatësisht zvogëlimit

Figura 56. Rritja vjetore e shpenzimeve sipas kategorive kryesore, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 57. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

të vlerës së kredive jo-performuese në 2014 krahasuar me vitin paraprak (figura 58). Përkundër faktit se shpenzimet për provizione shënuan rënie të theksuar, shkalla e mbulueshmërisë me provizione vazhdon të jetë në nivel të kënaqshëm duke qëndruar në 114.4 përqind në dhjetor 2014 (110.5 përqind në dhjetor 2013).

Profitabiliteti dhe efikasiteti


Rritja e theksuar e profitit në vitin 2014 ndikoi në përmirësimin e dukshëm të treguesve të profitabilitetit të sektorit bankar krahasuar me vitet e kaluara. Kthimi në Mesataren e Aseteve (angl. Return on Average Assets: ROAA) arriti në 1.9 përqind nga 0.9 përqind sa ishte në vitin 2013. Kthimi në Mesataren e Kapitalit (angl. Return on Average Equity: ROAE) gjithashtu shënoi rritje duke arritur në 20.2 përqind nga 9.4 përqind sa ishte në vitin 2013 (figura 59).

Zvogëlimi i theksuar i shpenzimeve, përkundër rënies së lehtë të të hyrave, ka ndikuar në përmirësimin e indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, i cili shprehet përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave të përgjithshme. Në dhjetor 2014, ky indikator u zvogëluar në 75.4 përqind nga 89.6 përqind sa ishte në vitin paraprak (figura 60).

Përmirësim më i lehtë i efikasitetit të sektorit bankar vërehet në raportin e shpenzimeve operacionale ndaj gjithsej asetëve, që në dhjetor 2014 u zvogëluar për 0.1 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (tabela 4). Po ashtu, margjina neto e interesit⁶ shënoi rritje të lehtë për 0.1 pikë përqindje, në 5.8 përqind në dhjetor 2014. Rritja e këtij indikator reflektonte rritjen më të shpejtë të hyrave neto nga interesi (si rezultat i rënies së shpenzimeve të interesit në depozita) krahasuar me rritjen e asetëve që sjellin interes.


Në tabelën 5 janë paraqitur disa tregues të kapacitetit të sektorit bankar, zhvillimi i të cilëve gjatë viteve të fundit sugjeron rritje të shfrytëzimit të kapacitetit të sektorit. Kjo shprehet përmes indikatorëve që paraqesin raportin e vlerës mesatare të asetëve të menaxhuara nga një

Figura 58. Rritja vjetore e provizioneve për humbjet e kredive dhe kredive joperformuese, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Figura 59. Treguesit e profitabilitetit



Burimi: BQK (2015)

Figura 60. Raporti shpenzime/të hyra, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

⁶ Margjina neto e interesit paraqet raportin ndërmjet të hyrave neto nga interesi dhe mjeteve mesatare fitimprurëse.

punëtor si dhe raportit të numrit mesatar të kredive të lëshuara nga një punëtor. Të dhënat për të dy indikatorët deri në dhjetor 2014 sugjerojnë rritje të shfrytëzimit të kapacitetit nga sektori bankar i Kosovës.

Tabela 4. Tregues kyç të efikasitetit të sektorit bankar, në përqindje

Përshkrimi	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
Shpenzimet operacionale/ Gjithsej Asetet	3.7%	3.6%	3.3%	3.2%
Margjina neto e interesit	6.3%	6.0%	5.7%	5.8%

Burimi: BQK (2015)

Përmirësimi i këtyre dy indikatorëve u ndikua nga rritja e aktivitetit të sektorit bankar në vitin 2014 krahas rënies së lehtë të numrit të të punësuarëve në sektorin bankar në 3,504 në dhjetor 2014 nga 3,549 në vitin paraprak. Një tregues tjetër i kapacitetit bankar, shprehur si raport i profitit të realizuar për një punëtor, ka shënuar përmirësim të lartë. Kjo erdhi si rezultat i profitit të lartë të realizuar gjatë vitit 2014 si dhe rënies së numrit të të punësuarëve. Kurse, raporti ndërmjet gjithsej shpenzimeve të personelit dhe numrit të të punësuarëve në dhjetor 2014 shënoi rritje krahasuar me vitin e kaluar, gjë që paraqet rritjes së kostos së faktorit punë për bankat në Kosovë. Niveli i ngjashëm i shpenzimeve të personelit krahas rënies së numrit të të punësuarëve në sektorin bankar gjatë kësaj periudhe ka ndikuar që ky indikator të shënojë rritje.

Tabela 5. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar


Përshkrimi	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
Asetet/nr i punëtorve (në mijëra euro)	710.8	759.1	862.0	908.7
Numri i kredive/nr i punëtorve	103.2	119.7	121.5	135.4
Profiti/nr i punëtorve (në mijëra euro)	9.6	5.0	7.3	17.1
Shpenzime e personelit/nr i punëtorëve (në mijëra euro)	10.9	11.4	11.9	12.1

Burimi: BQK (2015)

6.4 Rreziqet e Sektorit Bankar

Rreziqet ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar i Kosovës mbeten në nivel të ulët pa ndonjë ndryshim të konsiderueshëm gjatë vitit 2014. Në figurën 61, e cila paraqet indikatorët kryesor të rreziqeve bankare dhe performancës së sektorit, mund të shihet se të gjithë indikatorët e rrezikut kanë shënuar përmirësim, me përjashtim të rritjes ekonomike në vend e cila ka shënuar rënie. Ky përmirësim i përgjithshëm i zhvillimeve me ndikim në sektorin bankar është reflektuar në ngritje të theksuar të performancës në krahasim me vitin paraprak. Ambienti i jashtëm makroekonomik ka shënuar përmirësim duke kaluar në normë pozitive të rritjes për dallim nga

Figura 61. Harta e rreziqeve të sektorit bankar (në %)



Burimi: BQK (2015)

viti 2013 kur ekonomia e eurozonës kishte shënuar renie ekonomike.⁷ Sa i përket ambientit të brendshëm makroekonomik, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje edhe në vitin 2014, por me normë më të ulët krahasuar me vitin 2013.

Kapitali i sektorit bankar shënoi rritje gjatë vitit 2014 si rrjedhojë e rritjes së fitimit neto, duke rezultuar në ngritje të cilësisë së kapitalit si dhe treguesve të kapitalizimit të sektorit. Pozita e përforcuar e kapitalit sugjeron qëndrueshmëri të lartë të sektorit bankar dhe aftësi të kënaqshme të përballimit të humbjeve potenciale. Rreziku kreditor ka shënuar rënie në vitin 2014, duke u pasqyruar me normë më të ulët të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive si dhe me rënie të trendit të koncentrimit të rrezikut kreditor krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë është rritur, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme. Pozita e likuiditetit të sistemit bankar mbetet në nivel të kënaqshëm përkundër rritjes më të shpejtë të kreditimit në krahasim me rritjen e depozitave. Depozitat kanë shënuar ngadalësim të rritjes dhe orientim drejt maturitetit më të shkurtër që, së bashku me rritjen më të lartë të kreditimit gjatë vitit 2014, janë reflektuar në rënie të rezervave të likuiditetit dhe rënie të lehtë të treguesit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra. Megjithatë, që të dy këta indikatorë të likuiditetit mbesin mjaft mbi nivelet minimale të përcaktuara me kërkesat rregulatore. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut, marrë parasysh faktin se pothuajse të gjitha kreditë dhe depozitat vazhdojnë të bartin norma fikse të interesit si dhe për faktin se bilanci i gjendjes së sektorit bankar pothuajse në tërësi është i denominuar në valutën euro dhe rrjedhimisht ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.


6.4.1 Rreziku i likuiditetit

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit mbetet i ulët përkundër rritjes së lehtë që ka shënuar gjatë vitit 2014. Depozitat kanë shënuar ngadalësim të rritjes dhe orientim drejt maturitetit më të shkurtër, duke reflektuar pjesërisht ndjeshmërinë e rritjes së depozitave ndaj rënies së normës së interesit.

Megjithatë, depozitat pritet se do të vazhdojnë të rriten duke pasur parasysh prospektet për rritje më të lartë ekonomike në Kosovë dhe Eurozonë gjatë vitit 2015, zhvillime të cilat pritet të pasqyrohen në performancë më të mirë të biznesit dhe nivel më të lartë të remitencave. Rritja më e lartë e kreditimit gjatë vitit 2014 si dhe ngadalësimi i rritjes së depozitave janë reflektuar në rënie të rezervave të likuiditetit dhe rënie të lehtë të treguesit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra, por që

të dy këta indikatorë mbesin mbi nivelet minimale të përcaktuara me kërkesat rregulatore. Financimi i jashtëm, megjithëse tradicionalisht është shfytëzuar në masë të vogël nga sektori bankar i Kosovës, mund të jetë më lehtë i çashtëm në periudhën vijuese duke marrë parasysh programin e lehtësimit sasior të Bankës Qendrore Evropiane që pritet të reflektohet në rritjen e likuiditetit në tregun e jashtëm.

Figura 62. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

⁷ Norma e rritjes vjetore së PBB-së së Kosovës për vitin 2014 është vlerësim i BQK-së, ndërsa norma e rritjes vjetore të PBB-së së Eurozonës është marrë nga statistikat e FMN-së.


Raporti i kredive ndaj depozitave shënoi ngritje të lehtë në 74.2 përqind në dhjetor 2014 krahasuar me 73.7 përqind një vit më parë (figura 62). Siç vërehet edhe në figurën 62, raporti ndërmjet kredive dhe depozitave në vazhdimësi është karakterizuar me efekte sezonaliteti. Sezonaliteti në përgjithësi është më i theksuar te depozitat, të cilat pothuajse gjithmonë tentojnë të bien në tremujorin e dytë të vitit. Në anën tjetër, kreditimi tregon tendencë më të theksuar të rritjes në tremujorin e dytë. Arsyeja e sezonalitetit në kredi dhe depozita mund të jetë rritja e kërkesës për shpenzime në ekonomi gjatë kësaj periudhe. Kreditë e reja kanë vlerën më të lartë në këtë periudhë, që sugjeron për rritje të kërkesës për shpenzime në ekonomi, e cila mund të nënkuptojë se mjetet e disponueshme për kursim dhe, rrjedhimisht depozitat, tentojnë të jenë më të ulëta gjatë kësaj periudhe të vitit.

Në vitin 2014, depozitat kanë shënuar ngadalësim më të theksuar të rritjes në tremujorin e fundit dhe kjo ka ndikuar në rritjen e raportit kredi/depozita në fund të vitit për dallim prej viteve të mëhershme kur raporti kredi/depozita në fund të viti arrinte vlerat minimale. Megjithatë, raporti kredi/depozita vazhdon të mbetet nën normën prej 80 përqind, që gjë që mund të konsiderohet si tregues i nivelit të lartë të likuiditetit në sektor, duke sugjeruar se ekziston hapsirë për rritje të mëtejme të kreditimit duke mos rrezikuar pozitën e likuiditetit të sektorit bankar.

Rritja e aktivitetit kreditor në vitin 2014 ka ndikuar në zvogëlimin e aseteve likuide afatshkurtëra. Në dhjetor 2014, asetet afatshkurtëra shënuan rënie vjetore prej 3.7 përqind, duke zbritur pjesëmarrjen në gjithsej asetet në 34.3 përqind krahasuar me 37.2 përqind në dhjetor 2013. Në anën tjetër, detyrimet afatshkurtëra u rritën për 6.4 përqind. Si rrjedhojë, raporti i aseteve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtëra shënoi rënie në 43.3 përqind krahasuar me 48 përqind në dhjetor 2013, mirëpo vazhdon të mbetet dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore (figura 63).


Në kuadër të aseteve likuide, rënien më të theksuar e shënuan letrat me vlerë të tregtueshme të qeverive dhe bankave qendrore, të pasuara nga depozitat me bankat dhe institucionet e tjera

Figura 63. Raporti mjete likuide 'gjithëpërfshirëse'/ detyrime afatshkurtëra




Burimi: BQK (2015)

Figura 64. Rezervat e sistemit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 65. Hendeku i likuiditetit, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

financiare dhe llogaria me BQK-në. Ndërsa, rritjes së detyrimeve afatshkurtra i kontribuan kryesisht depozitat e transferueshme.


Rezervat e detyrueshme të sektorit bankar gjithashtu kanë vazhduar të qëndrojnë në nivel më të lartë se sa kërkesat rregullatore, mirëpo pjesa e teprcës së rezervës në vitin 2014 ka qenë më e ulët krahasuar me vitin paraprak (figura 64). Në dhjetor 2014, kërkesat minimale për rezervë të detyrueshme ishin në vlerë 224 milionë euro, ndërsa rezerva e përgjithshme e sektorit ishte më e lartë për 69 përqind. Mbajtja e rezervave në nivel të lartë mund të konsiderohet si pozitive ngase zvogëlon ekspozimin e sektorit ndaj zhvillimeve me rrezik potencial për likuiditetin e sektorit. Megjithatë, kjo paraqet kosto oportune për bankat të cilat nuk arkëtojnë interes për teprcën e rezervës, gjë e cila mund të transmetohet në rritje të kostos së shërbimeve bankare. Andaj, në këtë kontekst, tendenca rënese e rezervave të tepërta në vitin 2014 mund të konsiderohet si një zhvillim i favorshëm ngase sugjeron për menaxhim më të mirë të aseteve likuide në kuptim të minimizimit të kostos oportune, duke i vënë asetet likuide në funksion të aktiviteteve siç është kreditimi që sigurojnë të hyra për bankat dhe i kontribuojnë zhvillimit ekonomik të vendit.

Gjatë vitit 2014, sektori bankar i Kosovës është karakterizuar me rritje të 'rrezikut strukturor të likuiditetit', që pasqyrohet përmes rritjes së mospërputhjes së afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve të intervalit të njëjtë të maturitetit (figura 65).⁸ Hendeku i likuiditetit është rritur konsiderueshëm për pothuajse të gjitha kategoritë. Rritja më e theksuar është shënuar në kategorinë '1-7 ditë', ku hendeku është dyfishuar në -878 milionë euro nga -431.8 në dhjetor 2013. Kjo ndikoi që hendeku negativ për periudhën kumulative 'deri në 3 muaj' të rritet në -669.3 milionë euro nga -271 milionë euro në dhjetor 2013. Rritja e konsiderueshme e hendekut negativ për periudhën '1-7 ditë' gjithashtu ndikoi që hendeku negativ për periudhën kumulative 'deri në 1 vit' të rritet dukshëm, por që efekti negativ i saj është zbutur pak nga rritja e hendekut pozitiv për kategoritë '31-90 ditë' dhe '91-180 ditë', si dhe kalimin në hendek pozitiv të kategorisë '181-365 ditë'.

Rritja e hendekut negativ u ndikua kryesisht nga zhvillimet në zërat kryesorë të bilancit të gjendjes, gjegjësisht në kredi dhe depozita. Rritja e kreditimit është reflektuar në zvogëlimin e aseteve me maturitet të shkurtër si dhe rritjen e atyre me maturitet më të lartë se një vit. Në anën e detyrimeve, rritja e depozitave me interes për kategorinë e maturimit '1-7 ditë' dhe rënia e depozitave për të gjitha kategoritë tjera të maturimit, tregon për zhvendosje të depozitave në kategorinë me maturitetin më të shkurtër. Ky zhvillim përkon me rënien e normave të interesit në depozita, gjë që ka zvogëluar atraktivitetin e afatizimit të depozitave.

Këto zhvillime në strukturën e depozitave theksojnë nevojën e rritjes së depozitave me afat më të gjatë maturimi, ngase një zhvillim i tillë do të zvogëlonte rrezikun e likuiditetit dhe njëkohësisht do të krijonte mundësi më të mëdha për rritjen e kreditimit afatgjatë, zhvillim ky mjaft i dëshirueshëm për përmirësimin e kushteve të financimit të investimeve.

Figura 66. Raporti NPL/gjithsej kreditë, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

⁸ Hendeku negativ nënkupton që asetet për intervalin e caktuar të maturitetit tejkalojnë detyrimet dhe anasjelltas.

6.4.2 Rreziku kreditor


Ekspozimi i sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut kreditor ka treguar tendencë rënëse gjatë vitit 2014. Raporti i kredive joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive ka zbritur në 8.3 përqind nga 8.7 përqind në dhjetor 2013 (figura 66). Rënia e raportit të kredive joperformuese është rezultat i rënies vjetore të vlerës së NPL-ve si dhe rrites më të shpejtë të stokut të kredive në vitin 2014 (figura 67). Ndërsa, një ndër faktorët që mund të ketë kontribuar që cilësia e portofolit kreditor të sektorit të përmirësohet është fakti që bankat në vitet e fundit kanë aplikuar standarde më strikte të kreditimit të ekonomisë.

Sektori i ekonomive familjare vazhdon të mbetet me ekspozimin më të ulët ndaj rrezikut kreditor. Raporti i NPL-ve mbetet në nivel të ngjashëm me vitin paraprak, me një rritje të lehtë në 2.7 përqind krahasuar me 2.6 përqind në dhjetor 2013.

Sektori më i ekspozuar ndaj rrezikut kreditor vazhdoi të jetë sektori i ndërmarrjeve, në kuadër të të cilit ekspozimi ishte më i theksuar te energjia dhe pasuritë e patundshme (figura 68). Norma e NPL-ve për këta dy sektorë ka shënuar rritjen vjetore më të theksuar. Në sektorin e energjisë, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë arriti në 17.4 përqind nga 14.1 përqind sa ishte një vit më parë, ndërsa për pasuritë e patundshmërive në 13.7 përqind nga 12.2 përqind në dhjetor 2013. Rritja e normës së NPL-ve në të dy sektorët paraqet rritjen vjetore të vlerës së NPL-ve prej 8.1 përqind për energjinë dhe 3.5 përqind për patundshmëritë dhe, në anën tjetër, rënie e vlerës së stokut të gjithsej kredive për këta sektorë (12.5 përqind rënie vjetore e kredive të energjisë dhe 8.1 përqind rënie për kreditë për patundshmëri).


Në anën tjetër, sektori i prodhimit dhe ai i tregtisë kanë shënuar rritje të vlerës së gjithsej kredive dhe zvogëlim të vlerës së NPL-ve, që rezultuan në rënie të normës së NPL-ve në të dy sektorët. Në sektorin e prodhimit, norma e NPL-ve zbriti në 12.0 përqind nga 15.2 përqind

Figura 67. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve




Burimi: BQK (2015)

Figura 68. NPL-të sipas sektorëve



Burimi: BQK (2015)

Figura 69. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2015)


në vitin 2013, përderisa në sektorin e tregtisë, norma e NPL-ve zbriti në 11.5 përqind nga 12.2 përqind sa ishte një vit më parë. Sektor tjetër që u karakterizua me përmirësim të konsiderueshëm të cilësisë së portfolios kreditorë ishte sektori i shërbimeve dhe turizmit, i cili përkundër rënies së vlerës së gjithsej kredive, zbriti pjesëmarrjen e kredive joperformuese në gjithsej kreditë në 8.7 përqind nga 11.3 përqind sa ishte një vit më parë.

Sektori i bujqësisë është karakterizuar me përmirësim të cilësisë së portfoliit kreditor, ku norma e NPL-ve zbriti lehtësisht në 7.9 përqind nga 8.0 përqind në dhjetor 2013.

Në aspektin e strukturës së kredive sipas klasifikimit, në vitin 2014 është shënuar rritje e pjesëmarrjes së kredive pa asnjë vonesë (standard) si dhe të kredive të humbura, ndërsa kategoritë tjera kanë shënuar rënie (figura 69). Rritja e pjesëmarrjes së kredive standarde reflekton rritjen më të theksuar të kreditimit që ka karakterizuar këtë periudhë. Ndërsa, rritja e pjesëmarrjes së kredive të humbura në njërin anë, dhe zvogëlimi i pjesëmarrjes së kredive të dyshimta, nënstandarde dhe vrojtuese, në anën tjetër, sugjeron se një pjesë e këtyre kategorive me vonesa kanë shënuar përkeqësim duke migruar drejt kategorisë së fundit.


Sidoqoftë, ecuria e kredive sipas klasifikimeve kreditorë, e paraqitur në figurën 70, tregon për përmirësim të trendit për të tri klasifikimet kreditorë: kreditë me vonesa, kreditë e klasifikuara si dhe kreditë joperformuese.⁹ Rënia e pjesëmarrjes së kredive joperformuese në gjithsej kreditë i atribuohet zvogëlimit të pjesëmarrjes së kredive të dyshimta, ngase kreditë e humbura kanë rritë pjesëmarrjen në strukturën e gjithsej kredive.

Figura 70. Ecuria e kredive sipas klasifikimeve kreditorë, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Figura 71. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2015)

Figura 72. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2015)

⁹ Sipas rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut kreditor, klasifikimet kreditorë të mësipërme grupohen në tri kategori të ekspozimit të rrezikut kreditor: Kreditë me vonesa, të cilat përfshijnë kategoritë vrojtuese, nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura; Kreditë e klasifikuara që përfshijnë kategoritë nën standarde, të dyshimta dhe të humbura, dhe Kreditë joperformuese që përfshijnë kreditë të dyshimta dhe të humbura.

Sektori bankar ka rritur shkallën e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione për mbulim të humbjeve të mundshme nga kreditë. Raporti i mbulimit të kredive joperformuese me provizione është rritur në 114.4 përqind nga 110.6 përqind sa ishte në dhjetor 2013 (figura 71). Raporti i mbulimit me provizione të kredive të klasifikuara ka shënuar rritje gjithashtu, në 82.0 përqind në dhjetor 2014 nga 78.2 përqind në dhjetor 2013.

Kreditimi i ekonomisë është rimëkëmbur në vitin 2014 dhe trend i ngjashëm i rritjes pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2015. Sipas rezultateve të anketës së bankave të dhjetorit 2014, oferta dhe kërkesa për kredi për të gjithë sektorët pritet të rritet. Ky zgjerim i kreditimit mund të ketë ndikim pozitiv në kapacitetin për zgjerim të ndërmarrjeve dhe të reflektohet pozitivisht në kapacitetin e tyre për kthimin e kredive ekzistuese dhe atyre të reja. Sidoqoftë, lehtësimi i standardeve të kreditimit, i shoqëruar me zvogëlimin e normave të interesit në kredi, mund të tërheqë aplikacione për kredi edhe nga klientët me “gradim” më të ulët financiar, prandaj kërkohet që zgjerimi i mëtejshëm i kreditimit të bëhet në përputhje me parimet e kreditimit të shëndoshë.

Koncentrimi i rrezikut kreditor

Një aspekt tjetër i rrezikut kreditor është edhe shkalla e koncentrimit të ekspozimeve kreditore. Viti 2014 ka shënuar rënie të trendit të koncentrimit të rrezikut kreditor për dallim nga vitet e kaluara kur ky tregues kishte shënuar rritje (figura 72). Raporti i ekspozimeve të mëdha¹⁰ kreditore në raport me kapitalin e klasit të parë,¹¹ si indikator kryesor i rrezikut të koncentrimit kreditor, ka rënë në 99.6 përqind në dhjetor 2014 nga 129.7 përqind një vit më parë. Rënia i atribuohet rritjes së kapitalit të klasit të parë (rritje vjetore prej 22.5 përqind) dhe poashtu rënies së vlerës së ekspozimeve të mëdha që zbriti në 299.8 milionë euro në dhjetor 2014 (rënie vjetore prej 6.0 përqind).


Numri i ekspozimeve të mëdha të sektorit bankar u zvogëlua gjithashtu. Nga 68 në dhjetor 2013, numri i ekspozimeve të mëdha zbriti në 56 në dhjetor 2014. Megjithatë, vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha ishte më e lartë se vitin paraprak, duke qendruar në 5.4 milionë euro në dhjetor 2014 (4.7 milion euro në dhjetor 2013) duke sugjeruar për përqëndrim më të lartë të rrezikut kreditor në një numër më të vogël të ekspozimeve kreditore.

6.4.3 Rreziku i solvencës

Sektori bankar i Kosovës përforcoi pozitën e kapitalit gjatë vitit 2014. Në dhjetor 2014, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl.

Capital Adequacy Ratio: CAR), që paraqet raportin e gjithsej kapitalit rregullator ndaj aseteve të peshuara ndaj rrezikut, arriti në 17.8 përqind krahasuar me 16.7 përqind një vit më parë (figura 73).¹² Ngritja e treguesit të kapitalizimit ishte rezultat i rritjes së kapitalit rregullator me normë

Figura 73. Kapitalizimi i sistemit bankar



Burimi: BQK (2015)

¹⁰ Ekspozim i madh konsiderohet shuma e të gjitha ekspozimeve direkte dhe indirekte ndaj një huamarrësi të vetëm apo grupi të huamarrësve të ndërlidhur vlera e të cilave kalon 10% të vlerës së kapitalit të klasit të parë të bankës përkatëse.

¹¹ Sipas rregullores për ekspozime të mëdha, shuma e të gjitha ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj personit apo grupeve të personave, kur secili nga ekspozimet e tejkalon dhjetë përqind (10%) të kapitalit të klasit të parë të bankës, kufizohet në 300% të kapitalit të klasit të parë.


¹² Sipas rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullativ në raport me RWA dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me RWA.

prej 14.1 përqind, në krahasim me rritjen prej 7.3 përqind të Aseteve të Peshuara ndaj Rrezikut (angl. Risk Weighted Assets: RWA) (figura 74). Rritja e treguesit të kapitalizimit vendosë Kosovën mbi nivelin mesatar të kapitalizimit të rajonit, i cili në dhjetor 2014 kishte, në mesatare, CAR prej 16.8 përqind.¹³ Rritja e kapitalit rregullator gjatë vitit 2014 i atribuohet rritjes së kapitalit të klasit të parë (rritje prej 22.5 përqind), përderisa kapitali i klasit të dytë shënoi rënie (rënie prej 13 përqind). Ky zhvillim ka ndikuar në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së kapitalit të sektorit bankar, që është reflektuar në rritjen e normës së kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj rrezikut, si dhe në rritjen e raportit të levës. Në dhjetor 2014, treguesi i kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik (angl. Tier I capital to RWA) arriti në 14.6 përqind krahasuar me 12.8 në dhjetor 2013.

Raporti i levës, i cili paraqet nivelin e ekuitetit në raport me gjithsej asetet, arriti në 10.8 përqind nga 9.7 përqind sa ishte në dhjetor të vitit paraprak. Ngritja e raportit të levës ishte rezultat i rritjes më të theksuar të ekuitetit (16.3 përqind rritje vjetore) krahas rritjes së gjithsej asetëve të sektorit (4.16 përqind rritje vjetore). Raporti aktual i levës tejkalon kërkesën rregullatore që kërkon një raport minimal prej 7 përqind.¹⁴ Sidoqoftë, niveli aktual vazhdon të mbetet nën nivelin e vendeve të rajonit, të cilat në dhjetor 2014, në mesatare, kishin raport të levës prej afër 14.0 përqind.¹⁵


Vlera e kapitalit rregullator të sektorit bankar të Kosovës arriti në 366.6 milionë euro në dhjetor 2014, duke tejkaluar kërkesën minimale për kapital rregullator (apo 12 përqind të RWA-ve) për 119.4 milionë euro. Siç u theksua më lartë, cilësia e kapitalit rregullator ka shënuar përmirësim në vitin 2014, për dallim prej trendit të tij rënës në vitet e fundit. Në dhjetor 2014, trendi i rënies graduale të pjesëmarrjes së kapitalit të klasit të parë dhe rritjes së financimit me burime të kapitalit të klasit të dytë përfundoi, me ç'rast pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin rregullator u ngrit në 82.1 përqind nga 76.5 përqind në vitin paraprak (figura 75). Ky nivel i pjesëmarrjes së kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin

Figura 74. Kapitali rregullativ dhe RWA-të



Burimi: BQK (2015)

Figura 75. Struktura e kapitalit rregullativ të sistemit bankar



Burimi: BQK (2015)

¹³ Mesatarja e Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (Kapitalit të klasit I dhe II ndaj Aseteve të Peshuara me Rrezik) për rajon (vendet e Ballkanit Perëndimor, si: Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria dhe Serbia). Të dhënat janë marrë nga Global Financial Stability Report i Fondit Ndërkombëtar Monetar. Periudha raportuese përfshinë dhjetorin 2014, me përjashtim të Malit të Zi ku të dhënat janë të periudhës mars 2014.

¹⁴ Rregullorja e BQK-së për Mjaftueshmërinë e Kapitalit.

¹⁵ Mesatarja e raportit të levës për rajonin (vendet e Ballkanit Perëndimor, si: Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria dhe Serbia) të kalkuluar nga BQK nga raportet e bilanceve të gjendjes të vendeve përkatëse, të raportuara në Bankat Qendrore përkatëse. Të dhënat përfshijnë periudhën e dhjetorit 2014.


rregullator është i përafërt me mesataren e rajonit e cila në qershor 2014 qëndronte në rreth 85 përqind.¹⁶

Rritja e konsiderueshme e profitit të sektorit gjatë vitit 2014 është faktori kryesor në rritjen e kapitalit të klasit të parë, që nënkupton përmirësim të cilësisë së kapitalit. Konsolidimi konform ndryshimeve rregulatore të fuqizuara në dhjetor të vitit 2012, që u manifestua me zvogëlimin gradual të ekspozimeve të sektorit ndaj personave të ndërlidhur me bankën, ishte faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e nivelit të kapitalit të klasit të parë.¹⁷ Gjithashtu, shtimi i kapitali aksionar nga disa banka kishte peshë të rëndësishme në rritjen e kapitalit të klasit të parë.

Në anën tjetër, shpërndarja e dividendës nga disa banka ishte pothuajse faktori i vetëm që zvogëloi kapitalin rregullator përmes zvogëlimit të profitit të pashpërndarë. Struktura e kapitalit të klasit të parë mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Kapitali aksionar mbetet kategoria dominuese, por me rënie të lehtë të pjesëmarrjes (76.8 përqind nga 90.0 përqind në dhjetor 2013) si rezultat i rritjes së pjesëmarrjes së kategorisë së dytë për nga madhësia që përbëhet nga profiti (figura 76).


Kapitali i klasit të dytë, në anën tjetër, shënoi rënie si rezultat i zvogëlimit të borxhit të ndërvarur. Në dhjetor 2014, vlera e borxhit të ndërvarur zbriti në 45.7 milionë euro në krahasim me 56.3 milionë euro në dhjetor 2013 kur borxhi i ndërvarur i sektorit kishte shënuar rritjen më të lartë (pothuajse ishte dyfishuar në raport me vitet paraprake) (figura 77). Rritja e theksuar e borxhit të ndërvarur gjatë vitit 2013 ishte kryesisht rezultat i nevojës për rritje të kapitalit për plotësim të kërkesave të reja rregulatore që hynë në fuqi në fund të vitit 2012 dhe në korrik të vitit 2013. Në vitin 2014, sektori veçse kishte arritur konsolidimin konform kërkesave rregulatore. Gjithashtu, performanca e mirë financiare e sektorit bankar gjatë vitit 2014, e shprehur me një rritje rekorde të profitit, ka shërbyer për rritjen e kapitalit të sektorit duke zvogëluar nevojën për borxh të ndërvarur. Ndërsa, provizionet e përgjithshme për kreditë shënuan rritje në vitin 2014, duke arritur vlerën 19.8 milionë euro në krahasim me 19.0 milionë euro në dhjetor 2013.¹⁸ Për dallim nga vitet e

Figura 76. Struktura e kapitalit të klasit të parë, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 77. Struktura e kapitalit të klasit të dytë, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

¹⁶ Mesatarja e raportit të kapitalit të klasit të parë ndaj gjithsej kapitalit rregullator për vendet e rajonit, e kalkuluar nga të dhënat e raportuara në kuadër të Tregueseve të Shëndetit Financiar të Fondit Monetar Ndërkombëtar –FMN-së si dhe nga publikimet e Bankave Qendrore të vendeve përkatëse.

¹⁷ Huazimet ndaj personave të ndërlidhur me bankën zbriten në përllogaritjen e kapitalit të klasit të parë, andaj zvogëlimi i këtyre ekspozimeve ka ndikuar në rritjen e nivelit të kapitalit të klasit të parë. Në kuadër të pozicioneve të reja të cilat zbriten nga përllogaritja e kapitalit të klasit të parë, peshën më të madhe e kanë pikërisht huazimet ndaj personave të ndërlidhur, vlera e të cilave paraqet 5.4 përqind të kapitalit të klasit të parë në dhjetor 2014 në krahasim me 10.8 përqind në dhjetor 2013.

¹⁸ Vlera e provizioneve të ndara nga bankat për kreditë me klasifikim standard dhe vrojtuese llogaritet si pjesë e kapitalit të klasit të dytë, limituar deri në 1.25 përqind të aseteve të peshuara ndaj rrezikut.

mëhershme, kur bankat megjithëse në përqindje shumë të vogël, shfrytëzonin instrumentet e borxhit detyrimisht të konvertueshëm në aksione për plotësim të kapitalit, në dy vitet e fundit këto instrumente nuk gjetën aplikim.

Asetet e peshuara ndaj rrezikut

Vlera e aseteve të peshuara ndaj rrezikut (angl. Risk-Weighted Assets: RWA) në dhjetor 2014 arriti në 2.06 miliardë euro nga 1.92 miliardë euro një vit më parë. Rritja e RWA-ve ishte kryesisht rezultat i rritjes së aseteve me peshë rreziku prej 100 përqind, të cilat përfshijnë kreditë si dhe zërat jashtë-bilancorë. Vlera e këtyre aseteve arriti në 1.6 miliardë euro nga 1.4 miliardë në vitin paraprak, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në gjithsej RWA-të në 78.1 përqind nga 72.4 përqind në dhjetor 2014 (figura 78).


Në anën tjetër, asetet me peshën e rrezikshmërisë prej 75 përqind kanë shënuar rënie të konsiderueshme, duke zvogëluar efektin e rritjes së gjithsej RWA-ve nga rritja e theksuar e aseteve me peshë rreziku prej 100 përqind. Këto asete të cilat përfshijnë kreditë mbuluara me kolateral të rendit të parë¹⁹ kanë zbritur në 187 milionë euro nga 292 milionë euro në vitin paraprak, ndërsa pjesëmarrja e tyre në gjithsej RWA-të zbriti në 9.1 përqind nga 15.2 përqind.

Kategoritë tjera të RWA-ve nuk pësuan ndonjë ndryshim të theksuar. Nga gjithsej asetet e sektorit,²⁰ vlera e aseteve të cilat nuk bartin rrezik, apo që peshohen me peshë rreziku prej 0 përqind, shënoi rënie në afër 60 përqind të vlerës së RWA-ve nga 65 përqind në dhjetor 2013. Kjo mund të sugjerojë për prirje të rritjes së rrezikut nga sektori bankar i Kosovës. Prirja për rrezik më të lartë mund të mbështetet edhe në analizimin e raportit të RWA-ve ndaj gjithsej aseteve, i cili ka shënuar ngritje (figura 79). Në dhjetor 2014, pjesëmarrja e aseteve që bartin rrezik në gjithsej asetet e sektorit bankar ka arritur në 60.8 përqind nga 58.6 përqind në dhjetor 2013.²¹

6.4.4 Rreziku i tregut


Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut, që nënkupton rrezikun nga lëvizjet e kursit të këmbimit valutor si dhe ndryshimet nga lëvizjet në normat e interesit, vazhdon të mbetet në

Figura 78. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2015)

Figura 79. Raporti i RWA-ve ndaj gjithsej mjeteve të sektorit



Burimi: BQK (2015)

¹⁹ Specifikisht, asetet e peshuara me 75 përqind shkallë rreziku përfshijnë kreditë apo pjesë të tyre të mbuluara me kolateral të rendit të parë në formë të hipotekave të banimit si dhe kreditë për ndërtuesit për të financuar ndërtimin e pasurive të patundshme ku prona e financiar ka qenë e shitur apo e lëshuar me qira,

²⁰ Në këtë kalkulim janë përfshirë edhe asetet jashtë-bilancorë për shkak të përfshirjes së tyre në llogaritjen e gjithsej RWA-ve.

²¹ Përfshirja e mjeteve për rrezik operacional në RWA është bërë efektive në korrik 2013, andaj RWA-të e periudhës dhjetor 2011 dhe 2012 nuk përfshijnë këto mjete.

nivel të ulët. Pozicioni i agreguar neto i hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë ka shënuar rënie duke zbritur edhe më tej ndjeshmërinë edhe ashtu të ulët të sektorit ndaj ndryshimeve në kurset e këmbimit. Kreditë në valutë të huaj, të cilat edhe ashtu kanë pjesëmarrje mjaft të ulët në gjithsej portofolin kreditor (0.3 përqind në dhjetor 2014), kanë shënuar rënie dhe në këtë mënyrë nuk paraqesin rrezik për sektorin bankar. Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit vazhdon të mbetet i ulët. Zërat kryesor të bilancit të gjendjes së sektorit bankar, gjegjësisht kreditë dhe depozitat, bartin kryesisht norma fikse të interesit dhe nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit në afat të shkurtër. Megjithatë, ekziston rreziku i normës së interesit në kuptimin e rifinancimit dhe riinvestimit të mjeteve, ku ndryshimet e mundshme në norma të interesit reflektohen më shpejtë në anën e detyrimeve të sektorit për shkak të maturitetit më të shkurtër të detyrimeve që bartin interes në raport me asetet. Meqenëse diferenca mes asetëve dhe detyrimeve që bartin interes ndaj gjithsej asetëve mbetet e ulët, sugjeron se ndryshimet në norma të interesit mund të kenë pak ndikim në qëndrueshmërinë e sektorit.


Rreziku nga normat e këmbimit valutor

Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj është rritur lehtësisht gjatë vitit 2014. Asetet në valutë të huaj shënuan rënie në 123.1 milionë euro (vlerë ekuivalente) nga 145.3 milionë në dhjetor 2013. Detyrimet në valutë të huaj shënuan rënie më të ulët, nga 145.4 milionë në 126.9 milionë euro vlerë ekuivalente, duke bërë që pozicioni i hapur neto të zgjerohet në -3.7 milionë euro vlerë ekuivalente (-0.03 milionë euro vlerë ekuivalente në dhjetor 2013). Në anën tjetër, pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat²² shënoi rënie në 5.7 milionë euro vlerë ekuivalente në dhjetor 2014 nga 6.4 milionë euro vlerë ekuivalente një vit më parë. Kjo rënie, së bashku me rritjen e nivelit të kapitalit të klasit të parë të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe bëri që raporti i pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë të zbresë në 1.9 përqind krahasuar me 2.6 përqind në dhjetor 2013 (figura 80).

Në aspektin e disagreguar valutor, pozicionin më të lartë neto të hapur ndaj kapitalit të klasit të parë e arriti dollari


amerikan, për dallim nga franga zvicerane në vitin e kaluar. Në dhjetor 2014, ky raport për dollarin amerikan arriti në -0.8% (-0.4% në dhjetor 2013), ndërsa për frankun zviceran raporti

Figura 80. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj Kapitalit të Klasit të Parë



Burimi: BQK (2015)

Figura 81. Kreditë dhe detyrimet në valutë të huaj



Burimi: BQK (2015)

²² Pozicioni i agreguar neto i hapur nënkupton shumën e pozicioneve të gjata dhe të shkurtra në të gjitha valutat. Për shembull, një pozicion neto i shkurtër (-) në dollar prej 1 milionë vlerë ekuivalente të euros dhe një pozicion neto i gjatë (+) në franga zvicerane prej një milionë vlerë ekuivalente të euros rezultojnë në neto pozicion të agreguar prej 2 milionë euro, përderisa pozicioni neto i hapur do të ishte 0.

ndërroi kahje dhe zbriti në -0.2% (nga 0.5% në dhjetor 2013). Raporti i pozicioneve neto të hapura për valuta individuale ndaj kapitali të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën maksimumin prej 15 përqind të lejuar nga BQK. Bazuar në këto të dhëna, mund të sugjerohet që sektori bankar vazhdon të mbetet mjaft mirë i mbrojtur nga lëvizjet në kurset e këmbimit.

Kreditimi në valutë të huaj nga sektori bankar i Kosovës vazhdon të jetë mjaft i ulët. Në dhjetor 2014, kreditë e lëshuara në valutë të huaj zbritën në 5.9 milionë nga 6.1 milionë euro vlerë ekuivalente një vit më parë. Raporti i tyre ndaj gjithsej portofolit kreditor gjithashtu zbriti në 0.32 nga 0.34 përqind në dhjetor 2013. Depozitat në valutë të huaj, në anën tjetër, kanë pjesëmarrje më të lartë. Gjatë vitit 2014, vlera e tyre shënoi rënie nga 113.1 milionë në 136.9 milionë euro vlerë ekuivalente në vitin 2013 si dhe pjesëmarrja e tyre në gjithsej depozitat zbriti në 4.5 përqind nga 5.6 përqind një vit më parë. Rënia më e lartë e depozitave krahasuar me kreditë në valutë ndikoi që raporti i kredive ndaj depozitave në valutë të huaj të ngritet në 5.3 përqind nga 4.4 përqind në dhjetor 2013 (figura 81).


Rreziku nga ndryshimet në normat e interesit

Sektorit bankar i Kosovës është i mbrojtur relativisht mirë ndaj ndryshimeve në normat e interesit, për faktin që kreditë dhe depozitat kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe të hyrat dhe shpenzimet e interesit nga këto zëra nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit deri në maturim. Afër 91 përqind e gjithsej kredive kishin normë fikse të interesit në dhjetor 2014, ndërsa depozitat me normë fikse të interesit përbënin 100 përqind të gjithsej depozitave (figura 82).

Megjithatë, ndryshimi i normave të interesit mund të ketë ndikim në kuptimin e rrezikut të rifinancimit dhe riinvestimit të mjeteve varësisht nga kompozicioni i afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve që bartin interes (figura 83), si dhe kahut të lëvizjes së normës së interesit. Dallimi mes aseteve dhe detyrimeve që bartin interes është pothuajse më i larti për kategorinë e maturimit deri në 30 ditë, ku detyrimet që bartin interes tejkalojnë asetet. Gjatë vitit 2014, ky hendek ka shënuar rritje në -416.7 milionë euro nga -384.8 milionë euro në dhjetor 2013. Marrë


parasysh që hendeku është negativ për këtë kategori maturiteti (vëllimi i detyrimeve që bartin interes është më i lartë se i aseteve), ndryshimet e mundshme në norma të interesit në afat të shkurtër reflektohen më shumë në shpenzime krahasuar me të hyrat e sektorit. Pjesa dominuese e detyrimeve që bartin interes në Kosovë janë depozita, andaj sektori bankar është i ekspozuar ndaj rritjes së mundshme të normave të interesit në afat të shkurtër në kuptimin që kosto e

Figura 82. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit, sipas llojit të normës së interesit



Burimi: BQK (2015)

Figura 83. Hendeku i mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

rifinancimit të depozitave rritet më shpejtë se që mund të rriten të hyrat e arkëtuara nga normat më të larta të interesit për investime ngase maturimi i aseteve është më i gjatë.

Sidoqoftë, në afat prej një viti, hendeku kumulativ ka kaluar në hendek pozitiv kryesisht për shkak të rënies së detyrimeve që bartin interes. Në dhjetor 2014, hendeku i aseteve dhe detyrimeve që bartin interes për periudhën e maturitetit deri në 1 vit arriti në 151.2 milionë euro për dallim nga hendeku -239.0 milionë euro në dhjetor 2013. Në këtë situatë të hendekut pozitiv, ndryshimi i normave të interesit në periudhën një vjeçare ndikon më shumë në të hyrat se në shpenzimet e sektorit, andaj ekspozimi i përgjithshëm i sektorit ndaj rritjes së normave të interesit pothuajse neutralizohet.

Kutia 4. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë

Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike paraqet një vegël të rëndësishme për vlerësimin e vazhdueshëm të shkallës së rëndësisë sistemike të bankave komerciale në vend. Në përgjithësi, një bankë konsiderohet të ketë rëndësi sistemike nëse pritet që dështimi i mundshëm i saj të manifestohet me pasoja të rëndësishme negative për funksionimin dhe stabilitetin e tërë sektorit dhe për ekonominë në tërësi. Andaj, monitorimi i vazhdueshëm i shkallës së rëndësisë sistemike konsiderohet të jetë i rëndësishëm së veçantë për stabilitetin financiar për shkak se mundëson identifikimin e bankave dështimi i mundshëm i të cilave do të mund të kishte ndikim më të madh për sektorin financiar dhe ekonominë në përgjithësi. Gjithashtu, ky model mundëson hartimin e rekomandimeve për politikat dhe masat e nevojshme për sigurimin adekuat të kapaciteteve absorbuese të humbjeve të mundshme të bankave konform shkallës së rëndësisë së tyre sistemike.

Ky artikull paraqet vlerësimin e shkallës së rëndësisë sistemike për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja që operojnë në tregun e Kosovës duke u bazuar në të dhënat e muajit dhjetor 2014 të bilanceve të gjendjes së bankave përkatëse. Për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave, modeli bazohet në katër kritere bazë: kriterin e madhësisë, zëvendësueshmërisë, ndërlidhjes dhe kompleksitetit. Dy kriteret e para të sugjeruara nga modeli bazë (madhësia dhe zëvendësueshmëria) janë konsideruar si kritere themelore për përcaktimin e rëndësisë sistemike në rastin e Kosovës, andaj dhe pesha e tyre në model është dominuese me nga 40 përqind secila.

Tabela 6. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë

Kriteri	Indikatorët
Madhësia (pesha 40%)	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në Pjesëmarrja në tregun e aseteve të sektorit Pjesëmarrja në tregun e depozitave të sektorit Kapitali vetanak i bankës në raport me gjithsej kapitalin e sektorit Pjesëmarrja e letrave me vlerë të sektorit Numri i depozitorëve të bankës në raport me gjithsej depozitorët Pjesëmarrja e mjeteve likuide të sektorit
Zëvendësueshmëria (pesha 40%)	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja në kreditë për bujqësi të gjithsej sektorit Pjesëmarrja në kreditë për konsum të ekonomive familjare Pjesëmarrja në kreditë e industrisë, prodhimit, energjisë dhe ndërtimitarisë Pjesëmarrja në kreditë e tregtisë Numri i transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës Pjesëmarrja në tregun e gjithsej kredive
Ndërlidhshmëria (pesha 10%)	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja e depozitave dhe huazimeve nga korporatat tjera financiare dhe bankat tjera Pjesëmarrja e kredive për korporatat tjera financiare Pjesëmarrja e plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë)
Kompleksiteti (pesha 10%)	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor

Burimi: BQK (2015)

Ndërsa dy kriteret tjera (ndërlidhja dhe kompleksiteti) janë peshuar me nga 10 përqind duke u bazuar në faktin që sektori bankar i Kosovës ka shkallë të ulët të ndërlidhshmërisë së institucioneve në kuptimin e kreditimit dhe huazimit të ndërsjellë, si dhe është i bazuar në aktivitete tradicionale të bankingut ku shkalla e kompleksitetit është e ulët ngase financimi bazohet kryesisht në depozita dhe produktet kryesore janë kreditë. Për secilin nga kriteret janë përcaktuar indikatorët përmes të cilëve synohet matja e shkallës së rëndësisë sistemike të bankave individuale. Indikatorët e përdorur janë paraqitur në tabelën 6, dhe secilit prej indikatorëve brenda kriterit të caktuar i është dhënë peshë e barabartë.

Përzgjedhja e indikatorëve është bërë konform teorisë përkatëse dhe sugjerimeve të kornizës mbi të cilin është zhvilluar ky model. Supozimi i përgjithshëm në raport me kriterin e madhësisë, i konsideruar si kriteri kryesor për matjen e rëndësisë sistemike të një institucioni, është që sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e një banke në gjithsej sektorin, aq më e madhe është rëndësia e saj sistemike me që palët e ndikuara në rast të tronditjeve në këtë bankë janë më të shumta dhe kostot për tërë sektorin dhe ekonominë janë më të mëdha. Madhësia e institucioneve është synuar të matet si në aspektin e përgjithshëm të pjesëmarrjes së aseteve në gjithsej asetet e sektorit, ashtu edhe në aspekte të veçanta të bilancit të gjendjes siç janë pjesëmarrja e depozitave të bankës përkatëse në gjithsej depozitat e sektorit, numri i depozitorëve, pjesëmarrja e parave të gatshme dhe rezervave, etj. për të reflektuar kështu rëndësinë e tyre në aspekte/segmente të veçanta të sektorit bankar, si p.sh. numri i depozitorëve që mund të ndikohet në rast të paraqitjes së problemeve apo falimentimit të mundshëm të një banke të caktuar.

Kriteri i zëvendësueshmërisë synon që të masë shkallën e zëvendësueshmërisë së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të bankës përkatëse nga bankat tjera në treg, në rast të dështimit të saj. Supozimi kryesor për kriterin e zëvendësueshmërisë është që sa më e madhe pjesëmarrja e një banke në një segment të caktuar të tregut apo në ofrimin e një lloji të caktuar të shërbimit, aq më të larta janë kapacitetet teknike dhe njohuritë për funksionim në sektorin përkatës (p.sh. vlerësimin e rrezikut të kredive për sektorin e bujqësisë), gjë që e bëjnë më të vështirë zëvendësimin e rolit të saj në atë fushë nga bankat ekzistuese apo edhe nga hyrësit e ri në treg. Andaj, edhe rëndësia sistemike e një institucioni rritet kur vështirësitë për zëvendësimin e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të saj janë më të mëdha.

Kriteri i ndërlidhshmërisë ka për qëllim që të masë shkallën e ndërlidhshmërisë së institucioneve bankare ndërmjet vete si dhe me institucionet tjera financiare në vend në mënyrë që të identifikojë rrezikun e efektit shpërndarës së krizës së një institucioni tek institucionet tjera financiare dhe sektori real. Ky kriter është i një rëndësie të veçantë për matjen e rrezikut sistematik në vendet me sektorë të zhvilluar financiar ku ndërlidhjet mes institucioneve janë të shumta dhe komplekse. Në Kosovë, tregu ndër-bankar është pothuajse joekzistent dhe ndërlidhjet mes institucioneve financiare kryesisht kufizohen në depozitat dhe kreditë që institucionet tjera financiare si kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit tjerë financiar kanë në bankat komerciale në vend. Rrjedhimisht, ndërlidhja mes institucioneve financiare tentohet të matet përmes pjesëmarrjes së plasmanëve në bankat tjera dhe ekspozimit kreditor për korporatat tjera financiare, si dhe pjesëmarrjes së depozitave dhe huamarrjeve nga korporatat tjera financiare.

Sa i përket kriterit të kompleksitetit, synimi i tij është që të masë shkallën e kompleksitetit të modelit të biznesit dhe operacioneve të një banke nën supozimin se sa më kompleks aktiviteti i një banke, aq më të shumta janë ndërlidhjet dhe marrëveshjet me palë të treta, të cilat i rrisin kostot dhe kohën e adresimit të problemeve në rast të falimentimit. Në rastin e Kosovës, si indikator i përafërt për matjen e kompleksitetit të një banke është marrë pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancorë në gjithsej portfolion e aseteve të asaj banke.

Për të identifikuar rëndësinë sistemike të një bankë është krahasuar vlera e secilit indikator me vlerën mesatare të indikatorit përkatës për tërë sektorin. Në rastet kur vlera e indikatorit të një institucioni ka tejkaluar vlerën mesatare të sektorit, atëherë ai institucion është konsideruar të ketë rëndësi sistemike për indikatorin përkatës. Kur indikator ka rezultuar mbi mesataren e sektorit (i rëndësisë sistemike), atij i është dhënë vlera 1, ndërsa në të kundërtën i është përcaktuar vlera 0. Në vazhdimësi, këto vlera janë shumëzuar me peshën e indikatorit përkatës, dhe kur një bankë ka rezultuar të ketë rëndësi sistemike në gjysmën apo më shumë se gjysmën e indikatorëve të një kriteri, atëherë ajo është konsideruar të ketë rëndësi sistemike për kriterin përkatës. Në fund, bankat të cilat kanë rezultuar të kenë shumën e mesatares së peshuar të kritereve të barabartë ose më të lartë se 50% , atëherë ato banka janë konsideruar

të kenë rëndësi sistemike. Sa më e lartë mesatarja e peshuar, aq më e lartë rëndësia sistemike e atij institucioni.

Rezultatet

Rezultatet e përgjithshme të modelit me të dhëna të muajit dhjetor 2014 janë paraqitur në tabelën 7. Rezultatet mbesin të ngjashme me ato të një viti më parë në kuptimin që katër bankat më të mëdha që operojnë në Kosovë vazhdojnë të konsiderohen me rëndësi të përgjithshme sistemike. Sidoqoftë, intervali i shkallës së rëndësisë sistemike ka shënuar ngritje dhe shtrihet nga 65%, për bankën sistemike me shkallën më të ulët të rëndësisë sistemike, deri në 100% për bankën sistemike me shkallën më të lartë, për dallim nga viti 2013 kur intervali ishte 53 – 89 %. Dy nga bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike, ngjashëm me vitin paraprak, rezultuan me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret. Ndërsa dy të tjerat, përkundër rëndësisë sistemike të përgjithshme, nuk rezultuan të kenë rëndësi sistemike në kriterin e ndërlidhshmërisë (në dhjetor 2013 njëra nga këto bankat nuk rezultoi me rëndësi sistemike as në kriterin e zëvendësueshmërisë).

Tabela 7. Rezultatet e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë, sipas kriterëve

Bankat/Kriteri	Madhësia	Zëvendësueshmëria	Ndërlidhshmëria	Kompleksiteti	TOTAL
Banka 1					
Banka 2					
Banka 3			√	√	
Banka 4					
Banka 5	√	√	√	√	√
Banka 6	√	√		√	√
Banka 7	√	√	√	√	√
Banka 8	√	√		√	√
Banka 9					

Burimi: BQK (2015)

Rezultatet gjithashtu sugjerojnë që njëra nga bankat më të vogla, e cilat nuk rezultoi me rëndësi të përgjithshme sistemike për shkak të pjesëmarrjes më të ulët në treg, megjithatë doli të ketë rëndësi sistemike në dy nga kriteret – atë të ndërlidhshmërisë dhe kompleksitetit (në dhjetor 2013 kjo bankë ishte me rëndësi sistemike vetëm në kriterin e kompleksitetit). Gjithashtu, vlen të theksohet se disa nga bankat, megjithëse nuk rezultuan të kenë rëndësi sistemike për tërë kriterin e zëvendësueshmërisë dhe ndërlidhshmërisë, dolën të kenë pjesëmarrje të rëndësishme në disa indikatorë si numrin e transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave, pjesëmarrjen në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, si dhe pjesëmarrjen e depozitave dhe huazimeve nga korporatat tjera financiare dhe plasmanët në banka tjera duke mos përfshirë bankat amë. Një rezultat i tillë ku bankat kanë rëndësi sistemike në disa indikatorë dhe kriteret të caktuara, por jo edhe rëndësi sistemike të përgjithshme, sugjeron që efekti i dështimeve të mundshme të këtyre bankave megjithatë mund të jetë i rëndësishëm për sektorë dhe aspekte të caktuara të sektorit financiar dhe atij real.

6.5. Analiza Stres-Test

Analiza stres-test paraqet një vegël të rëndësishme të vlerësimit të qëndrueshmërisë së sektorit ndaj tronditjeve të mundshme në portofolin kreditor si dhe në pozitën e likuiditetit, të cilat mund të pasojnë nga zhvillimet jo të favorshme ekonomike dhe ndryshimet në kushtet e tregut. Përmes kësaj analize vlerësohet ndikimi i këtyre tronditjeve në kualitetin e portofolit kreditor, të hyrat e bankës, pozitën e likuiditetit, si dhe gjendjen e saj të përgjithshme financiare – nivelin e kapitalit.

Analiza e prezantuar më poshtë ka për bazë të dhënat e sektorit bankar të Kosovës për muajin dhjetor 2014, të cilat janë shfrytëzuar për vlerësimin e qëndrueshmërisë së sektorit ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit valutor (rreziku i tregut). Në analizë është testuar gjithashtu aftësia e sektorit që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike mbi tërheqje të konsiderueshme të depozitave (rreziku i likuiditetit).

Rezultatet e analizës stres-test në vazhdimësi sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit për të përballuar 'situatat ekstreme' të ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve.

Rreziku kreditor

Metodologjia

Skenari bazë: Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se gjendja ekonomike në eurozonë dhe në rajon do të përkeqësohet, dhe kjo do të reflektohet në ekonominë e Kosovës kryesisht përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, rritja ekonomike në vend supozohet të përkeqësohet duke zgjeruar kështu hendekun e prodhimit dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e portofolit kreditor. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 3.5 përqind në pesë vitet e fundit si dhe është supozuar rënie ekonomike prej 2.5 përqind për vitin 2014. Në këtë situatë, hendeku i prodhimit do të ishte 6.0 përqind, ndërsa ndikimi në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL), është vlerësuar duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të NPL ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8,²³ që nënkupton rritje prej 4.8pp të pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Si pasojë e tronditjeve në sektorin real, është supozuar që kreditimi nuk do të shënoj rritje në vitin pasues.

Në një skenar shtesë ndaj skenarit bazë, krahas rrezikut kreditor janë konsideruar edhe efektet e rrezikut të tregut në të hyrat e sektorit. Pra, rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit. Normat e interesit për pjesën e aseteve janë supozuar të bien për 3.0pp, ndërsa për pjesën e detyrimeve për 0.8pp ngase niveli i tyre bazë tashmë është mjaft i ulët. Zhvlerësimi i valutës euro ndaj valutave të tjera është supozuar të jetë 20 përqind, me përjashtim të frangut zviceran ndaj të cilit zhvlerësimi është supozuar të jetë në nivel më të lartë, respektivisht 30%.²⁴

Efektet e supozimeve të mësipërme në sektorin bankar reflektohen si në vijim: rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve; zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon në humbjet/fitimet e të hyrave neto nga interesi duke marrë parasysh afatin e maturimit të aseteve dhe detyrimeve dhe riinvestimin/rifinancimin e tyre.

Krahas këtyre supozimeve, është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se profiti gjithashtu do të ndikohet nga tronditjet e lartpërmendura, kryesisht përmes rënies së aftësisë së gjenerimit të hyrave nga interesi si rezultat i mos rritjes së kreditimit si dhe dështimit të kredive (rritjes së NPL-ve). Andaj, profiti i pritshëm i bankave është llogaritur duke marrë për bazë profitin neto pas tatimit të vitit 2014, ndaj të cilit fillimisht është aplikuar tronditje prej 40 përqind për të reflektuar

²³ Notë e papublikuar e FMN-së "CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise", Korrik 2009.

²⁴ Zhvlerëzimi më i lartë i euros ndaj frangut është konsideruar për shkak të zhvlerësimit të lartë në janar 2015 që pasoi si rezultat i ndërprerjes së masës së ndërlidhjes (angl: unpeg) së vlerës së këtyre valutave.

efektin e mos rritjes së kreditimit, dhe pastaj janë zbritur edhe të hyrat që do të realizoheshin po që se NPL nuk do të rritej.²⁵

Rritja e supozuar e NPL-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive joperformuese (të dyshimta dhe të humbura). Kjo rritje është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej NPL-të. Rritja e NPL-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e NPL-ve aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin shtesë është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj valutave të huaja për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sektorit bankar vazhdon të jetë minor për shkak të vlerës së ulët të pozicioneve të hapura neto në valutë të huaj.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 3pp për asetet dhe 0.8pp për detyrimet në bilancin e gjendjes. Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në marginën neto të interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), kryesisht duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave ngase pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit dhe ndryshimet në norma të interesit nuk reflektohen deri në maturim. Efekti negativ në të hyra nga rënia e normës së interesit në anën e aseteve neutralizohet në një masë nga efekti pozitiv që ka rënia e normës së interesit për detyrimet, por që efekti mbetet negativ për shkak të rënies më të theksuar të normës së interesit në asete.

Skenarë tjerë shtesë: Krahas skenarëve bazë të lartpërmendur, skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i kredimarrësve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përballues i NPL-ve për secilën bankë para se të shfaqen problemet me kapitalizim.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të skenarëve hipotetik në nivelin e kapitalit rregullator të sektorit bankar, aseteve të peshuara me rrezik dhe, rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR).

Rezultatet

Gjendja e sektorit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit të bankave në dhjetor 2014 ishte mjaft e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) në 17.8 përqind (tabela 8). Sektori bankar vazhdoi të qëndrojë mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë, të cilat qëndruan në 8.3 përqind, si dhe mbulueshmërisë së tyre me provizione të cilat në dhjetor 2014 ishin në nivelin prej 114.4 përqind. Andaj, si rezultat i pozicionit të mirë fillestar si dhe profitabilitetit më të lartë që nga fillimi i funksionimit të tij, sektori bankar i Kosovës ka treguar nivel të lartë të qëndrueshmërisë ndaj rrezikut kreditor edhe nën kushtet e supozimit të skenarëve hipotetik të përshkruar më lartë.

Nën supozimet e skenarit bazë për vlerësimin e rrezikut kreditor (bilancor dhe jashtë bilancor) - në të cilin pjesëmarrja e NPL-ve në portfolion kreditor do të rritej për 4.8pp, ndërsa profiti i prituri për tërë vitin do të shfrytëzohej për absorbimin e humbjeve – treguesi i mjaftueshmërisë

²⁵ Vlerësimi i të hyrave të 'humbura' si pasojë e rritjes së NPL-ve është bërë fillimisht duke llogaritur ex-post normën e përgjithshme të interesit në kredi për secilën bankë, e cila më pastaj është shumëzuar me vlerën e shtuar të NPL-ve.

së kapitalit (CAR) i sektorit bankar do të zbriste në normën prej 15.6 përqind,²⁶ që është mbi minimumin prej 12 përqind të kërkuar nga BQK-ja. Sidoqoftë, në nivel të bankave individuale, CAR për tri nga bankat do të zbriste nën nivelin 12 përqind. Mjetet e nevojshme për të rikthyer kapitalizimin në nivelin e kërkuar do të arrinin në 8.6 milionë euro (ekuivalent me 0.16 përqind të vlerës së PBB-së së parashikuar për vitin 2014). Në këto rrethana, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të arrinte në 13.1 përqind, ndërsa në nivel të bankave individuale niveli më i lartë i normës së NPL-ve do të ishte 15.8 përqind.

Duke u bazuar në supozimet e lartpërmendura të tronditjeve, gjithsej humbja e sektorit bankar do të arrinte vlerën prej 72.3 milionë euro (1.3 përqind të PBB-së). Megjithatë, kjo vlerë nuk mund të konsiderohet në tërësi si humbje eventuale e sektorit me që duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i prituri për periudhën e konsideruar. Gjithashtu, një pjesë e humbjeve kthehen nga realizimi i kolateralit apo nga riprogramimi, por që ky aspekt nuk është konsideruar për qëllim të kësaj analize.

Tabela 8. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku kreditor

Përshkrimi	Numri i bankave ^{1/}			CAR %			NPL %			Rikapitalizimi	
	CAR <0	CAR 0-8%	CAR 8-12%	N. më i ulët	N. më i lartë	N. i sektorit	N. më i ulët	N. më i lartë	N. i sekt.	Në mln. €	Si % e PBB-së
Nivelet para goditjeve	0	0	1	11.2	20.4	17.8	6.3	11.0	8.3		
Rezultatet e makroskenarëve											
<i>Skenari bazë</i>	0	0	3	7.2	18.3	15.6	4.8	15.8	13.1	8.6	0.16
<i>Kombinimi me rrezik të tregut</i>	0	0	3	6.2	17.2	14.5	4.8	15.8	13.1	11.6	0.21
<i>Dështimi i tre kredimarrësve</i>	2	0	2	-14.6	17.5	12.9	8.5	60.9	17.1	25.3	0.46
<i>Dështimi i pesë kredimarrësve</i>	2	1	3	-30.5	17.5	9.8	8.5	80.2	20.6	79.9	1.46

Shënim:1/ Nga nëntë bankat e konsideruara në analizën stress-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullator, i ndarë sipas kategorive.

Shënim: 2/ Në raportin të vlerave minimale dhe maksimale të indikatorëve në nivel të bankave, në disa raste janë përjashtuar vlerat e larta të CAR si dhe vlera e NPL prej 0 përqind, të cilat karakterizojnë bankat në fillim të veprimtarisë.

Burimi: BQK (2015)

Rezultatet e skenarit shtesë në të cilin rreziku kreditor kombinohet me rrezikun e tregut – në të cilin rast krahas rritjes së normës së NPL-ve për 4.8pp, përfshihet edhe zhvlerësimi i euros dhe rënia e normave të interesit në nivelet e supozuara më lartë - treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) të sektorit bankar do të zbriste në 14.5 përqind. Tri banka do të zbrisnin nën minimumin rregullator të CAR prej 12 përqind, dhe nevojat për rikapitalizim do ishin 11.6 milionë euro (0.21 përqind të PBB-së). Në këtë skenar, efekti i zhvlerësimit të euros ishte i ulët si rezultat i vlerës së ulët të pozicionit të hapur neto, ndërsa efekti nga rënia e normave të interesit ishte më i theksuar.

Një skenar tjetër shtesë supozon dështimin e ekspozimeve të mëdha. Rezultatet e skenarit në të cilin supozohet dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat sugjeron që CAR i sektorit do të zbriste në 12.9 përqind. Në këto rrethana, në katër banka, CAR do të zbriste nën nivelin minimal të kërkuar prej 12 përqind dhe mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të ishin 25.3 milionë euro (vlerë ekuivalente me 0.46 përqind të PBB-së së vlerësuar për vitin 2014). Në supozimin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, CAR i sektorit do të zbriste në 9.8 përqind, ndërsa numri i bankave të nën-kapitalizuara do të arrinte në gjashtë. Vlera e nevojshme për rikapitalizimin e sektorit bankar do të arrinte në 79.9 milionë euro (vlerë ekuivalente me 1.46 përqind të PBB-së së vlerësuar për vitin 2014).

²⁶ Vlen të theksohet se në këtë edicion, ashtu si në Raportin e Stabilitetit nr.6, ka ndryshim metodik në vlerësimin e rrezikut kreditor, ku humbjet e vlerësuarat vjetore tash e tutje nuk zbriten nga asetet e peshuara me rrezik për qëllim të kalkulimit të normës së kapitalizimit (CAR) pas tronditjeve. Ky ndryshim është konform praktikës që kreditë e klasifikuara si të humbura nuk ndodhë të shlyhen nga bilanci i gjendjes para se të kalojë një vit, dhe me që horizonti kohor i analizës stress-test është një vit, sugjerohet që humbjet e tilla të mbeten në kuadër të asetëve të peshuara me rrezik me faktor (peshë) të njëjtte të rrezikut. Ky ndryshim metodik paraqet qasje më konservative të vlerësimit të rrezikut kreditor në krahasim me edicionet paraprake.

Nivelet përbaluese të NPL-ve të secilës bankë para se të shfaqen probleme me kapitalizim (para se Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të zbres nën nivelin 12 përqind) duken të jenë mjaft të larta për shumicën e bankave. Në një prej bankave, NPL do të mund të rritej deri në 22.5 përqind të gjithsej portofolit të kredive të asaj banke para se të paraqitet nevoja për kapital shtesë. Në disa banka, nivelet përbaluese të normës së NPL-ve paraqiten më të ulëta, ku niveli më i ulët në njërin nga bankat është 11.9 përqind (vetëm 2.8pp më shumë se niveli i NPL-ve para tronditjes). Njëra nga bankat mund të përballojë rritje të raportit të NPL-ve për vetëm 1.7pp para se të paraqiten nevojat për kapitalizim shtesë. Sektori bankar në tërësi është në gjendje të përballojë një raport të NPL-ve deri në 18.1 përqind pa u paraqitur nevoja për injektim kapitali shtesë për mbajtjen e CAR të sektorit në nivelin e kërkuar rregullator prej 12 përqind.

6.5.2. Rreziku i likuiditetit

Metodologjia²⁷

Skenari bazë: Analiza e rrezikut të likuiditetit mbështetet në skenarin bazë të tërheqjes së një vlere të theksuar të depozitave nga sektori bankar, duke vlerësuar kështu aftësinë e sektorit që të përballojë një tronditje të tillë. Më specifikisht, është konsideruar tërheqja e 8 përqind të depozitave në baza ditore, përgjatë pesë ditëve të njëpasnjëshme, duke ndarë asetet likuide në vlerë të 5 përqind të depozitave të mbetura pas çdo dite për qëllime të operimit të bankës në ditën vijuese. Ndarja e aseteve likuide në vlerë të 5 përqind të depozitave nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind të depozitave do të përgjysmohej në 5 përqind. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të aseteve të mbetura likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind, përderisa mundësia e konvertimit të aseteve jolikuide në para të gatshme do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre aseteve brenda ditës. Gjithashtu, është supozuar se bankat nuk kanë mundësi të financimit përmes burimeve të jashtme të financimit.

Skenarë shtesë: Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i depozitorëve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përbalues i tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të paraqitet nevoja për likuiditet shtesë.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së aseteve likuide të bankave për të përballuar tërheqje mjaft të mëdha të depozitave si dhe mjaftueshmërinë e aseteve likuide për të përballuar rrezikun e mundshëm nga koncentrimi i depozitave.

Rezultatet

Sektori bankar i Kosovës u karakterizua me likuiditet të lartë në dhjetor të vitit 2014, ku indikator i kyç i likuiditetit (raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra) qëndroi në 43.3 përqind. Andaj, si rezultat i pozitës së mirë të likuiditetit, sektori bankar në tërësi tregoi aftësi të kënaqshme të përballimit të skenarëve të supozuar mjaft konservativ të tërheqjes së depozitave.

²⁷ Metodologjia e llogaritjes së aseteve likuide ka ndryshuar për të qenë konform rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Paraprakisht asetet likuide për qëllim të analizës stres-test janë llogaritur sipas metodologjisë së Treguesve të Shëndetit Financiar të FMN-së.

Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: Rreziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave ^{1/}	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mln. euro)
Pas ditës së parë	1	0.9
Pas ditës së dytë	1	3.3
Pas ditës së tretë	1	5.8
Pas ditës së katërt	3	24.4
Pas ditës së pestë	5	51.2

Shënim: 1/ Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.

Burimi: BQK (2015)

Rezultatet e skenarit bazë të tërheqjes së 8 përqind të depozitave në ditë, për pesë ditë në vazhdimësi, sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës do të fillonte të ketë nevojë për likuiditet shtesë në ditën e parë, ku vetëm njëra nga bankat do të kishte mungesë të aseteve likuide prej 0.9 milionë euro (tabela 9). Në fund të ditës së tretë, problemet me likuiditet do të vazhdonin të mbesin të koncentruara vetëm në njëren bankë, nevojat për likuiditet të së cilës do të arrinin në 5.8 milionë euro. Në fund të ditës së katërt, problemet do të shfaqeshin edhe në dy banka tjera, ku nevojat e përgjithshme për injektim të likuiditetit do të arrinin në 24.4 milionë euro. Pas ditës së pestë, gjithsej pesë banka do të kishin mungesë të aseteve likuide për përballim të tërheqjeve të supozuara të depozitave. Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në ditën e pestë do të arrinte në 34 përqind, dhe shuma e aseteve likuide shtesë të nevojshme për tejkalimin e problemeve të likuiditetit do të arrinte në 51.2 milionë euro (0.93 përqind e PBB-së së supozuar për vitin 2014).

Supozimi i dështimit të depozitorëve më të mëdhenj në secilën nga bankat rezulton të mos jetë shqetësues për gjendjen e përgjithshme të likuiditetit në sektorin bankar. Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimeve të financimit (depozitat si përbërësit kryesorë të detyrimeve); prandaj, tërheqja e menjëhershme e depozitave nga individë apo kompani me vlerën e depozitave më të mëdha nuk paraqet rrezik serioz për sektorin.

Nivelet përbaluese të tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të shfaqen probleme me likuiditet rezultojnë të jenë të larta në përgjithësi. Banka me pragun më të ulët qëndron në 10.3 përqind, ndërsa ajo me pragun më të lartë në 45.7 përqind. Në nivel të sektorit, pragu i tërheqjes së gjithsej depozitave ishte afër 33.2 përqind, që nënkupton se sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e një të tretës (1/3) së gjithsej depozitave pa pasur nevojë për asete likuide shtesë. Në këtë rast, nën supozimin që vlera e kredive nuk do të rritet, raporti kredi/depozita për sektorin bankar do të arrinte në 110.5 përqind.

6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë

6.6.1. Sistemi i Pagesave

Sistemet e pagesave luajnë rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi, duke marrë parasysh që funksionimi efikas dhe i sigurt i tyre paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar është sistem hibrid i pagesave, përmes të cilit procesohen pagesat me vlera të vogla, me vlera të mëdha si dhe pagesa urgjente.

Numri i transaksioneve të përpunuara nga SEKN në dhjetor 2014, arriti në 9.1 milionë (6.8 milionë në dhjetor 2013), duke shënuar rritje vjetore prej 33.2 përqind. Kurse vlera e gjithsej

transaksioneve deri në dhjetor 2014, arriti në 6.8 miliardë euro (6.4 miliardë në dhjetor 2013), që paraqet një rritje vjetore prej 6.1 përqind. Mesatarja ditore e transaksioneve përmes SEKN arriti në 36.4 mijë të tilla, ndërsa vlera e tyre në 27.4 milionë euro.

Në raport me numrin e transaksioneve, pagesat e rregullta masive vazhdojnë ta kenë pjesëmarrjen më të lartë prej 41.2 përqind në kuadër të instrumenteve të pagesave (tabela 10). Këto pagesa janë kryesisht të realizuara për institucionet qeveritare. Më pas vijnë pagesat prioritare masive me një pjesëmarrje prej 35.7 përqind, që janë kryesisht të realizuara nga institucionet qeveritare (siç janë pagesat e pagave dhe pensione), dhe pagesat e rregullta të cilat kanë një pjesëmarrje prej 11.4 përqind. Pagesat prioritare masive janë pagesat të cilat kanë shënuar rritjen më të shpejtë në numër (3,233,049 në dhjetor 2014 nga 1,797,330 në dhjetor 2013) kryesisht si rezultat i fillimit të procesimit të pagave të administratës dhe pensione të MPMS përmes SEKN-së që nga prilli i vitit 2013.

Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së, në përqindje

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
Të rregullta	14.3%	11.4%	51.6%	48.8%
Prioritare	0.4%	0.3%	11.9%	9.8%
Të rregullta - masive	48.5%	41.2%	8.3%	7.9%
Prioritare - masive	26.5%	35.7%	5.8%	9.4%
Pagesat xhiro	10.2%	11.2%	14.0%	13.9%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	8.3%	10.2%
Debitim Direkt	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK (2015)

Në raport me vlerën e transaksioneve, pagesat e rregullta vazhdojnë të kryesojnë strukturën e pagesave (48.8 përqind në gjithsej vlerën e transaksioneve). Pagesat kos-xhiro edhe pse shënuan rënie të pjesëmarrjes në vlerën e gjithsej pagesave (13.9 përqind në dhjetor 2014 krahasuar me 14.0 përqind në dhjetor 2013) vazhdojnë të qëndrojnë në vendin e dytë. Pagesat prioritare masive dhe letrat me vlerë u karakterizuan me rritjet më të theksuara në vlerë gjatë kësaj periudhe, gjë që u reflektua edhe në rritjen e dukshme të pjesëmarrjes së tyre në strukturë të pagesave. Pagesat prioritare masive të procesuara përmes SEKN rritën pjesëmarrjen në 9.4 përqind në dhjetor 2014 nga 5.8 përqind sa ishin në dhjetor 2013, kryesisht si rezultat i rritjes së theksuar së tyre në vlerë (645.3 milionë në dhjetor 2014 nga 374.5 milionë në dhjetor 2013). Siç edhe ceket më lartë, procesimi i pagave të administratës dhe pensione të MPMS përmes SEKN-së, nga prilli i vitit 2013, është faktori kryesor i rritjes së lartë të këtij instrumenti. Pagesa e letrave me vlerë përmes SEKN gjithashtu shënoi rritje të theksuar (695.4 milionë euro në dhjetor 2014 nga 534.0 milionë euro në dhjetor 2013) që rezultoi në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në strukturë në 10.2 përqind në dhjetor 2014 (8.3 përqind në dhjetor 2013).

Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare arriti në 1.92 milionë llogari në dhjetor 2014, që nënkupton që mesatarisht çdo qytetar në Kosovë është i pajisur me llogari bankare.²⁸ Nëse e krahasojmë numrin e llogarive bankare në vend në dhjetor 2014 me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi një rritje të gjithsej llogarive bankare për 3.3 përqind.²⁹

Llogaritë bankare E-banking përmes të cilave shfrytëzuesit i qasen shërbimeve bankare 'online' nga interneti kanë vazhduar të rriten. Deri në dhjetor 2014 numri i gjithsej llogarive E-banking

²⁸ Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në dhjetor 2013 popullsia e përgjithshme rezidente ishte 1,820,631.

²⁹ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

arriti në 157,761 një rritje vjetore prej 20.1 përqind. Rrjedhimisht, edhe numri dhe vëllimi i transaksioneve përmes shërbimit E-banking është rritur. Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 1,579,838 deri në dhjetor 2014 (1,056,655 në dhjetor 2013). Vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking deri në dhjetor 2014 arriti në 4.2 miliardë euro (2.7 miliardë në dhjetor 2013).

Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë rezidente me një pjesëmarrje prej 97.2 përqind në dhjetor 2014. Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë 79.7 përqind të gjithsej llogarive të rezidentëve dhe pjesa e mbetur nga 20.3 përqind nga llogaritë afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jo-rezidentëve dominohet nga llogaritë individuale (92.0 përqind në dhjetor 2014), përderisa llogaria afariste ka një pjesëmarrje prej 8.0 përqind.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme shënoi rritje vjetore prej 6.0 përqind në dhjetor 2014. Numri i kartelave me funksion debiti në dhjetor 2014 arriti në 678,090, kurse me funksion krediti në 121,652. Përkundër shkallës më të ulët të përdorimit, numri i kartelave të kreditit u karakterizua me rritje më të shpejtë (11.3 përqind) krahasuar me kartelat e debitit (5.1 përqind). Pjesëmarrjen më të lartë si në kartelat e kreditit dhe debitit deri në dhjetor 2014 e kishin kartelat Visa (90.9 përqind përkatësisht 73.2 përqind), pasuar nga kartelat Master Card (9.1 përqind përkatësisht 26.8 përqind)

Infrastruktura bankare në vend sa i përket rrjetit të bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) dhe pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale) ka shënuar rritje. Numri i pajisjeve ATM dhe POS (që mundësojnë pagesat në pika të shitjes) shënuan rritje vjetore prej 0.4 përqind përkatësisht rritje prej 3.1 përqind deri në dhjetor 2014. Numri i ATM-ve të instaluar nga bankat komerciale në dhjetor 2014 ishte 498 përderisa numri i POS arriti në 9,349 (tabela 11).

Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
Numri i ATM-ve	460	483	496	498
Numri i POS-ve	7,534	8,592	9,071	9,349
Numri i llogarive 'e-banking'	68,990	97,089	131,365	157,761

Burimi: BQK (2015)

Deri në dhjetor 2014, numri i tërheqjeve përmes ATM-ve arriti në 9.9 milionë (9.3 milionë në dhjetor 2013), me një qarkullim prej 996.2 milionë euro (936.2 milionë deri në dhjetor 2013). Numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në терминаlet POS deri në dhjetor 2014 arrit në 4.7 milionë me vlerë prej 238.1 milionë euro. Vlera e tërheqjes së parave përmes ATM-ve ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arriti në 78.9 përqind deri në dhjetor 2014, që tregon për nivel të lartë të përdorimit të parasë së gatshme. Ndërsa, vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arrit në 18.9 përqind deri në dhjetor 2014.

Përkundër pjesëmarrjes së lartë të tërheqjeve cash në vlerën e përgjithshme të transaksioneve me kartela, nga tabela 12 vërehet se krahasuar me vitet e mëparshme është shënuar rënie e pjesëmarrjes së tërheqjeve cash në vlerën e përgjithshme të transaksioneve me kartela.

Përderisa tërheqjet cash në terminale ATM në vitin 2013 përbënin 81.0 për qind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartela, në vitin 2014 tërheqjet cash përbëjnë 78.9 për qind të vlerës së përgjithshme, duke zvogëluar pjesëmarrjen e tyre me 2.1 pp.

Tabela 12. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje

Përshkrimi	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
ATM tërheqje cash	81.8%	81.1%	81.0%	78.9%
ATM depozitime	0.0%	0.0%	0.2%	1.1%
Kredit Transfere nëpërmjet ATM	0.1%	0.1%	0.1%	0.0%
Tërheqje cash në terminale POS	3.3%	2.3%	2.1%	1.1%
Pagesa me kartela në terminale POS	14.8%	16.5%	16.6%	18.9%

Burimi: BQK (2015)

Njëkohësisht, pjesëmarrja e pagesave me kartela në vlerën e përgjithshme të transaksioneve me kartela ka shënuar rritje në vitet e fundit. Përderisa në vitin 2013 pagesat me kartela përbënin 16.6 për qind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartela, në vitin 2014 pagesat me kartela përbëjnë 18.9 për qind të vlerës së përgjithshme, duke rritur pjesëmarrjen e tyre me 2.3 pp.

7. Sektori Pensional

7.1 Struktura e Sektorit Pensional

Sektori pensional vazhdon të jetë sektori me normën më të lartë të rritjes së aseteve në kuadër të sistemit financiar të Kosovës. Vlera e aseteve të sektorit pensional, deri në dhjetor 2014, arriti në 1.1 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 19.1 përqind. Sektori pensional i Kosovës përbëhet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Pjesa më e madhe e kursimeve pensionale në Kosovë vazhdon të administrohet nga FKPK-ja, që menaxhon me 99.5 përqind të gjithë aseteve të sektorit të pensioneve të cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 19.1 përqind. Ndërsa pjesa e mbetur administrohet nga FSKP-ja të cilat shënuan rritje vjetore prej 9.2 përqind.

Tabela 13. Struktura e fondeve pensionale sipas pronësisë


Përshkrimi	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
Kosovë	99.2%	99.3%	99.4%	99.5%
Slloveni-Kosovë	0.8%	0.7%	0.6%	0.5%

Burimi: BQK (2015)

Sa i përket FKPK-së, struktura e aseteve deri në dhjetor 2014, u dominua nga investimet në tregun e jashtëm me një pjesëmarrje prej 94.1 përqind (figura 84). Pjesa e mbetur e aseteve përbëhet nga investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës (5.0 përqind) dhe nga depozitat në BQK (0.9 përqind). Krahasuar me vitin e kaluar, FKPK ka tërhequr pjesën më të madhe të depozitave të mbajtura në BQK dhe ka investuar në fonde investuese në sektorin e jashtëm kryesisht si rezultat i normës së kthimit më të lartë. Pjesa më e madhe e këtyre investimeve jashtë vendit janë në formë të aksioneve dhe bonove të thesarit të qeverive të huaja.


Investimet jashtë vendit dominojnë edhe strukturën e aseteve të FSKP-së. Deri në dhjetor 2014, jashtë vendit janë investuar gjithsej 79.6 përqind të aseteve të FSKP-së, ndërsa pjesa e mbetur prej 20.4 përqind paraqet investimet në Kosovë. Në figurën 84 mund të vërehet një tendencë e vazhdueshme e rritjes së investimeve në sektorin e jashtëm nga FSKP-ja.

Figura 84. Struktura e investimeve të fondeve pensionale, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 85. Mjetet nën menaxhimin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës




Burimi: BQK (2015)

7.2. Performanca e Sektorit Pensional

Sektorit pensional gjatë vitit 2014 u karakterizua me performancë pozitive financiare. Të dy fondet shënuan ngritje të çmimit të aksionit dhe kthim pozitiv nga investimet (figura 85 dhe 86). Vlera e çmimit të aksionit³⁰ të FKPK-së, në dhjetor 2014, arriti në 1.29 euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.5 përqind. Njëherit, çmimi i aksionit të FKPK-së ka arritur vlerën më të lartë ndonjëherë të regjistruar krahasuar me periudhat paraprahe, duke u rikuperuar nga rënia e konsiderueshme në vitin 2008 si pasojë e krizës globale financiare.

Gjithashtu, vlera e çmimit të aksionit të FSKP-së ka vazhduar trendin rritës, duke arritur në 145.16 euro në dhjetor 2014, që paraqet rritje vjetore prej 4.8 përqind. Performanca pozitive e investimeve reflekton përmirësimin e kushteve në tregjet ndërkombëtare të aksioneve, ku edhe janë investuar pjesa më e madhe e mjeteve të sektorit pensional të Kosovës. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2014, FKPK-ja ka realizuar 66.7 milionë euro kthim bruto nga investimet. Ndërsa, kthimi bruto në investimet e FSKP-së deri në dhjetor 2014 arriti në 371.9 mijë euro.

Figura 86. Mjetet nën menaxhimin e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK (2015)


³⁰ Vlera bazë e çmimit të aksionit për FKPK-në është =1, ndërsa për FSKP-në është =100.

8. Sektori i Sigurimeve

8.1 Struktura e Sektorit të Sigurimeve

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e sigurimit 'jo-jetë' i cili përfaqëson 89.9 përqind të gjithë asetëve të sektorit, ndërsa pjesa e mbetur prej 10.1 përqind e asetëve përfshinë shërbimet e sigurimit 'jetë'. Nga gjithësej 14 kompani të sigurimeve që operojnë në Kosovë, 11 kompani ofrojnë produkte të sigurimit 'jo-jetë', ndërsa 3 kompani ofrojnë produkte të sigurimit 'jetë'. Sektori i sigurimeve në Kosovë vazhdon të dominohet nga kompanitë me pronësi të huaj, të cilat në dhjetor 2014 menaxhuan 67.4 përqind të gjithë asetëve të sektorit të sigurimeve.

Figura 87. Struktura e asetëve të kompanive të sigurimit, në përqindje



Austria dhe Shqipëria, që përfaqësohen me 5 kompani, vazhdojnë të zotërojnë 37.8 përqind të gjithë asetëve të sektorit të sigurimeve. Në treg operojnë 4 kompani vendore të cilat përfaqësojnë së bashku 32.6 përqind të asetëve të sektorit. Sllovenia përfaqësohet nga 2 kompani të cilat menaxhojnë 14.3 përqind të asetëve të sektorit. Ndërsa, Turqia përfaqësohet nga 1 kompani e cila menaxhon 8.2 përqind të gjithë asetëve të sektorit të sigurimeve (figura 87).

Shkalla e koncentrimin të tregut në sektorin e sigurimeve mund të konsiderohet e ulët, sidomos në krahasim me shkallën e koncentrimin të tregut bankar. Indeksi Herfindahl-Hirschman i kalkuluar për asetet e kompanive të sigurimeve tregon 884.5 pikë në dhjetor 2014. Megjithatë, shkalla e koncentrimin për primet ishte më e lartë se sa për asetet, ku në dhjetor 2014 Indeksi Herfindahl-Hirschman për primet ishte 1077.1 pikë. Diferencë e ngjashme vërehet edhe nëse krahasohet pjesëmarrja e tri kompanive më të mëdha në gjithësej asetet dhe primet e sektorit, ku në dhjetor 2014 pjesëmarrja në gjithësej asetet ishte 34.0 përqind, ndërsa në gjithësej primet ishte 41.3 përqind.

Tabela 14. Depërtimi dhe densiteti i sektorit të sigurimeve të vendeve të rajonit³¹

Përshkrimi	Prime/PBB	Primet/Numri i Popullsisë
	Dhjetor 2013	Dhjetor 2013
Maqedoni	2.0%	56.6 euro
Shqipëri	0.6%	28.7 euro
Mali i Zi	2.2%	56.8 euro
Serbi	1.8%	78.0 euro
Kosovë (2014)	1.5%	45.1 euro
Kroaci	2.8%	279 euro
Sloveni	5.5%	941 euro

Burimi: Statistikat zyrtare të vendeve përkatëse (2015)

Shkalla e depërtimit të shërbimeve të sigurimit në ekonominë e Kosovës, që llogaritet si raport i përqindjes së bruto primeve të pranuar ndaj PBB-së dhe matë zhvillimin e tregut të sigurimeve,

³¹ Me qëllim që të bëhet një krahasim më i saktë i depërtimit dhe densitetit të sigurimeve të Kosovës me vendet e rajonit, jemi bazuar me të dhënat më të reja të fundvitit të vendeve përkatëse.

tregon një normë relativisht të ulët prej 1.5 përqind në dhjetor 2014 (tabela 14). Në kuadër të vendeve të rajonit, niveli më i lartë i raportit 'prime/GDP' është regjistruar në Slloveni, ndërsa raporti më i ulët është shënuar në Shqipëri. Shkalla e densitetit të shërbimeve të sigurimit në Kosovë, që llogaritet si raport i bruto primeve të pranuar ndaj numrit të popullsisë poashtu mbetet relativisht e ulët duke shënuar vlerën prej 45.09 euro për kokë banori. Në krahasim me vendet e rajonit, Kosova është një ndër shtetet me raportin më të ulët prime/popullsi pas Shqipërisë ndërsa Sllovenia ka nivelin më të lartë të këtij indikator.

8.2. Aktiviteti i Sektorit të Sigurimeve


Në dhjetor 2014, vlera e aseteve të kompanive të sigurimit arriti në 140.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 5.8 përqind, që paraqet përshpejtim të rritjes krahasuar me normën vjetore të rritjes prej 1.5 përqind në dhjetor 2013. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit vazhdoi të dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 60.2 përqind të gjithsej aseteve. Pjesa tjetër përfaqësohet nga asetet fikse, paraja e gatshme, asetet teknike, etj. (figura 88).

Në kuadër të gjithsej aseteve të sektorit të sigurimeve, k ategoritë që shënuan rritje më të theksuar ishin asetet e paprekshme (61.5 përqind), pasuar nga paraja e gatshme (36.4 përqind), debitorët e primeve (11.9 përqind) dhe depozitat (9.5 përqind). Kurse, aksionet dhe letrat me vlerë dhe asetet tjera financiare shënuan rënie. Në dhjetor 2014, asetet tjera financiare kanë shënuar rënie vjetore prej 27.2 përqind, ndërsa rënia e letrave me vlerë gjatë vitit 2014 erdhi si rezultat i maturimit të letrave me vlerë të investuara gjatë viteve paraprake.

Në kuadër të detyrimeve, rezervat teknike kryesojnë me 56.7 përqind të gjithsej detyrimeve, ndërsa në pjesën e mbetur hyjnë kapitali vetanak, detyrimet tjera dhe kreditë (figura 89). Kapitali vetanak në dhjetor 2014 shënoi rritje vjetore prej 4.1 përqind. Në rritjen e kapitalit vetanak, kontributin më të lartë e kishin rezervat e përgjithshme dhe speciale, si dhe zvogëlimi i humbjeve gjatë viti 2014 krahasuar me humbjet në vitin paraprak. Në anën tjetër, niveli i kapitalit të kompanive të sigurimit u ndikua negativisht nga tërheqja e një pjese të profitit të mbajtur gjatë viteve të kaluara.


Deri në dhjetor 2014, vlera e bruto primeve të shkruara arriti në 82.0 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 3.7 përqind (tabela 15). Në kuadër të tyre, vlera e bruto primeve të shkruara të sigurimit 'jo-jetë' arriti në 79.6 milionë euro dhe shënoi rënie vjetore prej 3.3 përqind. Në kuadër të sigurimit 'jo-jetë', primet e pranuar nga sigurimi i përgjegjësishë ndaj palës së tretë (TPL)

Figura 88. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit, dhjetor 2014, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 89. Detyrimet dhe ekuiteti i kompanive të sigurimit, dhjetor 2014, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

arritën vlerën prej 42.3 milionë euro deri në dhjetor 2014, që paraqet një rënie vjetore prej 3.6 përqind. Kurse, primet e pranuar nga 'polisat kufitare' dhe 'polisat vullnetare' shënuan rritje vjetore prej 11.4 përqind përkatësisht 13.7 përqind deri në dhjetor 2014. Vlera e primeve të shkruara në kuadër të sigurimit 'jetë' shënoi një rritje vjetore prej 18.9 përqind, duke arritur vlerën prej 2.4 milionë euro në dhjetor 2014.

Tabela 15. Bruto primet e arkëtuara, në milionë euro

Përshkrimi	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
Prime bruto 'jo jetë'	77.1	79.6
Prime bruto 'jetë'	2.1	2.4

Burimi: BQK (2015)

Vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) deri në dhjetor 2014 arriti në 32.4 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 16.6 përqind, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të dëmeve të paguara ndaj sigurimit 'jo-jetë' (tabela 15). Në kuadër të sigurimit 'jo-jetë', rënia u shkaktua kryesisht nga zvogëlimi i dëmeve të paguara për kategorinë 'jo-përgjegjësitë ndaj palës së tretë' që shënoi vlerën 10.8 milionë euro që paraqet një rënie vjetore prej 31.4 përqind. Dëmet e paguara nga sigurimi 'jetë' deri në dhjetor 2014 arritën në 0.2 milionë euro, ndërsa dëmet e paguara nga BKS-ja shënuan vlerën 4.2 milionë euro (5.2 milionë euro në dhjetor 2013).

Tabela 16. Dëmet e paguara, në milionë euro

Përshkrimi	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
Dëmet 'jo jete'	33.4	28.0
Dëmet 'jete'	0.2	0.2
Dëmet BKS	5.2	4.2


Burimi: BQK (2015)

Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara tregon përmirësim të performancës së sektorit krahasuar me vitin paraprak. Ky raport në vitin 2014 u zvogëlua në 39.5 përqind krahasuar me 49.1 përqind në dhjetor 2013, si rezultat i zvogëlimit të dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit (figura 90).

8.3. Performanca e Sektorit të Sigurimeve

Indikatorët kyç të performancës dhe stabilitetit të sektorit të sigurimeve në vitin 2014 kanë shënuar përmirësim të lehtë në krahasim me vitin 2013. Profitabiliteti vazhdon të paraqes shqetësimin kryesor për sa i përket performancës së këtij sektori. Deri në dhjetor 2014, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 318.8 mijë euro, e cila është me e ulët në krahasim me humbjen prej 754.6 mijë euro të

Figure 90. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

regjistruar në vitin 2013. Sigurimi 'jo-jetë' vazhdon të karakterizohet me humbje për dallim nga sigurimi 'jetë' i cili rezultoi profitabil. Në vitin 2014, sigurimi 'jo-jetë' ka zvogëluar humbjen për 22.6 përqind, kurse sigurimi 'jetë' shënoi rritje të profitit për 69.6 përqind krahasuar me dhjetor 2013. Përmirësimi i pozicionit financiar ishte kryesisht rezultat i menaxhimit më të mirë të shpenzimeve krahasur me vitin e kaluar.

Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return of Average Assets: ROAA) në dhjetor 2014 ishte -0.23 përqind krahasuar me -0.26 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Ndërsa, Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE) ishte -0.68 përqind krahasuar me -0.74 përqind sa ishte në dhjetor 2013.

Gjendja e sektorit të sigurimeve është më e mirë për sa i përket kapitalizimit. Sektori mbetet mirë i kapitalizuar, me normë kapitalizimi prej 33.9 përqind, që do të thotë se tregu do të ishte në gjendje të mirë për t'u ballafaquar me tronditjet e mundshme. Po ashtu, kompanitë e sigurimeve gjatë kësaj periudhe kishin një nivel të kënaqshëm të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj dhe rezervave teknike qëndroi në 121.4 përqind në dhjetor 2014 (123.3 përqind në dhjetor 2013), kurse raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj dhe gjithsej detyrimeve qëndroi në 104.3 përqind (99.0 përqind në dhjetor 2013).

9. Sektori Mikrofinanciar dhe Ndihmësit Financiar


9.1. Aktiviteti i Sektorit Mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar gjatë vitit 2014 ka ndërprerë trendin e tkurrjes së aktivitetit të ndjekur gjatë viteve të fundit. Në dhjetor 2014, vlera e gjithsej asetëve të institucioneve mikrofinanciare ishte 112.9 milionë euro që paraqet nivel të ngjashëm me vitin 2013 (figura 91).

Kreditë, të cilat përfaqësojnë 65.9% të gjithsej asetëve të sektorit, janë karakterizuar me rritje vjetore prej 2.9 përqind, dhe kanë arritur vlerën prej 74.4 milionë euro në dhjetor 2014. Në kuadër të gjithësej kredive 34.1 përqind janë të destinuar për ndërmarrje kurse 65.9 përqind për ekonomitë familjare (figura 92). Kreditë e destinuar për ndërmarrje shënuan rritje vjetore prej 10.0 përqind dhe kishin kontributin kryesor në zgjerimit a aktivitetit kreditor të IMF-ve. Ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjareu karakterizuan me rënie vjetore prej 0.4 përqind. Rënia e kreditimit të ekonomive familjare mund të jetë ndikuar nga konkurrenca prej sektorit bankar duke pasur parasysh se kreditimi i ekonomive familjare nga ky sektor gjatë të njëjtës periudhë u karakterizua me rritje të përshpejtuar. Ndërkaq, pavarësisht konkurrencës prej sektorit bankar që ka lehtësuar standardet dhe kushtet për kreditimin e ndërmarrjeve, IMF-të shënuan rritje të kreditimit për ndërmarrjet që mund të jetë ndikuar nga rritja e kërkesës për kredi.


Struktura e kredive, sipas sektorëve ekonomik, mbetet e ngjashme me vitin paraprak. Kreditimi i sektorit të shërbimeve kryeson strukturën e kredive të destinuar për ndërmarrje me pjesëmarrje prej 46.5 përqind. Ndryshe nga sektori bankar, sektori mikrofinanciar karakterizohet me një kreditimi më të madh të sektorit të bujqësisë. Në dhjetor 2014, kreditë e lëshuara për sektorin e bujqësisë kishin pjesëmarrje prej 25.4 përqind në gjithsej kreditë e lëshuara për ndërmarrje. Pjesa tjetër e kredive është destinuar për ndërtimtari, industri dhe energjetikë (figura 93).

Figura 91. Asetet e institucioneve mikrofinanciare, rritja vjetore




Burimi: BQK (2015)

Figura 92. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 93. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


Sipas maturitetit, struktura e kredive mbetet e ngjashme me vitin paraprak, duke u dominuar nga kreditë afatmesme 'mbi 1 vit deri në 5 vite' të cilat përfaqësojnë 86.3 përqind të gjithë kredive. Kreditë afatshkurta 'deri në 1 vit' përbëjnë 13.4 përqind të kredive, dhe pjesa e mbetur përfaqësohet nga kreditë afatgjata (figura 94).

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me cilësi të mirë të portofolit kreditor. Në dhjetor 2014, raporti i kredive joperformuese (angl. non-performing loans: NPL) ndaj gjithë kredive ishte 4.8 përqind (5.2 përqind në dhjetor 2013). Gjithashtu, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione vazhdon të jetë në nivel të kënaqshëm duke u përmirësuar në 113.1 përqind në dhjetor 2014 krahasuar me nivelin prej 107.0 përqind në dhjetor 2013. Rritja e pagave në sektorin publik mund të ketë ndikuar në rënien e nivelit të kredive jo performuese duke qenë se pjesa më e madhe e kredive të lëshuara nga IMF-të janë të destinuara për ekonomitë familjare.

Lizingu përfaqëson kategorinë e dytë më të rëndësishme të asetëve të IMF-ve me pjesëmarrje prej 19.8 përqind në gjithë asetet. Deri në dhjetor 2014, lizingu arriti vlerën 22.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 1.4 përqind. Për dallim nga periudhat paraprake, në dhjetor 2014 struktura e lizingut dominohet nga lizingu i destinuar për ekonomitë familjare, i cili përbënë 53.5 përqind të gjithë aktivitetit (figura 95). Lizingu për ekonomitë familjare dyfishoi vlerën krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i rritjes së theksuar të lizingut hipotekar. Kurse, rënia vjetore prej 35.0 përqind e lizingut për ndërmarrje në dhjetor 2014 erdhi si rezultat i rënies së theksuar të lizingut financiar në formë të kredive hipotekare dhe lizingut për pajisje të destinuara për biznese.


Meqenëse IMF-të nuk kanë të drejtë ligjore të financohen nga depozitat e klientëve, pjesa kryesore e detyrimeve të këtyre institucioneve përbëhet nga linjat kreditore të jashtme. Prandaj, ekspozimi i sektorit mikrofinanciar në kuadër të detyrimeve është i lartë. Në dhjetor 2014,

Figura 94. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, dhjetor 2014, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Figura 95. Struktura e lizingut të IMF-ve sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 96. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

raporti i detyrimeve të jashtme ndaj gjithsej aseteve të IMF-ve arriti në 54.7 përqind (55.5 përqind në dhjetor 2013).

Normat mesatare të interesit për kreditë e IMF-ve vazhdojnë të jenë dukshëm më të larta krahasuar me normat e aplikuara nga sektori bankar. Norma mesatare e interesit në kreditë e IMF-ve, në dhjetor 2014, ishte 23.3 përqind (22.6 përqind në dhjetor 2013) (figura 96). Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare arriti në 23.8 përqind nga 23.7 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Ndërsa, norma e interesit në kredi për ndërmarrje arriti në 22.6 përqind nga 19.8 sa ishte në dhjetor 2013 (figura 97).

Norma mesatare e interesit për sektorin e bujqësisë në dhjetor 2014 arriti në 25.5 përqind (25.0 në dhjetor 2013), ndërsa për sektorin e shërbimeve arriti në 21.7 përqind (20.4 përqind në dhjetor 2013). Në anën tjetër, norma e interesit për sektorin e industrisë u zvogëlua në 23.8 përqind nga 25.3 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Normat e interesit të sektorit financiar vërehet se karakterizohen nga efekte sezonaliteti, ku gjatë gjysmës së parë të vitit kanë tendencë të rritjes krahasuar me trendin rënës gjatë gjysmës së dytë të vitit (figurën 97).

Figura 97. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

9.2. Performanca e Sektorit Mikrofinanciar

Sektori i institucioneve mikrofinanciare në vitin 2014 realizoi profit në vlerë prej 1.3 milionë euro krahasuar me humbjen prej 324.4 mijë euro në vitin paraprak. Operimi me fitim ishte kryesisht rezultat i rënies më të theksuar të shpenzimeve krahas rritjes së lehtë të hyrave.

Të hyrat e sektorit arritën vlerën prej 19.3 milionë euro në dhjetor 2014, që paraqet rritje vjetore prej 0.6 përqind. Struktura e të hyrave vazhdon të dominohet nga të hyrat e interesit me pjesëmarrje prej 83.1 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rënie prej 7.7 përqind, në kuadër të cilave kontribuues kryesor ishin shpenzimet për provizionet për humbjet në kredi (rënie prej 60.0 përqind) dhe shpenzimet e personelit të cilat shënuan rënie për 3.9 përqind. Treguesi i përgjithshëm i efikasitetit, i cili shprehet përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, është përmirësuar në 93.3 përqind nga 101.7 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Përmirësimi i performancës financiare u pasqyrua edhe në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit. Kthimi mesatar në asete (angl. Return on Average Assets: ROAA) u përmirësua në 1.1 përqind nga -0.3 përqind sa ishte në vitin 2013. Gjithashtu, kthimi mesatar në kapital (ang. Return on Average Equity: ROAE) arriti në 4.3 përqind nga -1.1 përqind sa ishte në vitin 2013.

Treguesit kyç të kapacitetit të sektorit, të paraqitur në tabelën 17, nuk janë në harmoni në mes vete. Numri i të punësuarve në sektorin mikrofinanciar u rrit në 776 në fund të vitit 2014 krahasuar me 765 në fund të vitit paraprak. Kurse, numri i kredive të aprovuara u zvogëlua në 34,564 në vitin 2014 krahasuar me 36,805 në vitin paraprak. Kjo ndikoi që indikatorin që mat raportin e numrit të kredive për punëtor të zvogëlohet krahasuar me vitin e kaluar (tabela 17). Po ashtu, indikatorin që matë mesataren e aseteve të menaxhuara për punëtor shënoi rënie krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i mos zgjerimit të aktivitetit të sektorit, pavarësisht

rritjes së numrit të punëtorëve. Në anën tjetër, profiti i realizuar për punëtor dhe shpenzimet e personelit për punëtor shënuan përmirësim krahasuar me vitin e kaluar. Raporti i profitit të realizuar për punëtor ka shënuar rritje në 2014 si rezultat i operimit me fitim të sektorit krahasuar me operimin me humbje në 2013. Kurse, raporti i shpenzimeve të personelit ndaj numrit të punëtorëve shënoi rënie duke e ulur koston mesatare të shpenzimeve për një punëtor, si rezultat i menaxhimit më të mirë të shpenzimeve. Rrjedhimisht pavarësisht faktit që IMF-të kanë shënuar progres në disa indikator kyç të efikasitetit, zgjerimi i aktivitetit si dhe menaxhimi më efikas i punëtorve janë disa nga sfidat e këtij sektori financiar.

Tabela 17. Tregues shtesë të efikasitetit të sektorit

Përshkrimi	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
Asetet/nr. i punëtorve (në mijëra euro)	128.1	147.6	145.5
Profiti/nr i punëtorve (në mijëra euro)	-5.0	-0.4	1.7
Numri i kredive/nr. i punëtorve	44.5	48.1	44.5
Shpeznimet e personelit/nr. i punëtorve (në mijëra euro)	13.8	14.8	14.0

Burimi: BQK (2015)

9.3 Ndhmësit Financiar

Struktura e ndihmësve financiar përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Ky sektor përbënë numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, mirëpo menaxhon pjesën më të vogël të aseteve të sistemit financiar (0.2 përqind në dhjetor 2014). Vlera e aseteve të ndihmësve financiar në dhjetor 2014 arriti në 9.0 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 18.6 përqind.

Deri në dhjetor 2014, të hyrat e ndihmësve financiar arritën vlerën 6.6 milionë euro, duke paraqitur rritje prej 17.0 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiar dominohet nga kategoria e të hyrave nga transferet, me pjesëmarrje prej 73.4 përqind, që u karakterizuan me rritje vjetore prej 5.8 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet arritën vlerën prej 3.4 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 26.8 përqind. Neto fitimet për sektorin e ndihmësve financiarë arritën vlerën prej 3.2 milionë euro deri në dhjetor 2014, që paraqet rritje vjetore prej 7.6 përqind.

10. Shtojca statistikore

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sistemi bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2014
M aftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	17.6	14.2	16.7	17.8
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	14.8	11.6	12.8	14.6
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	4.4	7.4	7.8	4.7
Çlësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	5.8	7.5	8.7	8.3
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive	Korporatat tjera financiare	0.5	1.1	1.1	0.4
	Korporatat publike jofinanciare	0.09	0.08	0.01	0.03
	Korporatat tjera jofinanciare	69.2	66.7	66.4	65.7
	Ekonomitë familjare	30.1	30.8	31.3	33.9
	OJSHEF	0.09	0.02	0.05	0.01
	Jo-rezidente	0.00	1.28	1.10	0.02
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
Profitabiliteti	Kthimi në asete (ROA)*	1.7	0.8	1.0	2.2
	Kthimi në kapital (ROE)*	17.4	8.6	10.6	22.5
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	75.2	74.7	73.1	75.9
	Shpenzimet jo-interes ndaj të hyrave bruto	76.8	87.8	84.8	66.6
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	26.6	25.3	27.7	25.9
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	31.3	32.6	36.6	32.8
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	33.7	31.7	35.7	32.4
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	39.6	40.8	47.1	41.0
Senziitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	2.5	0.7	2.3	1.8
Grupi i zgjeruar i indikatorëve					
	Kapitali ndaj asetëve	10.2	10.0	9.7	10.8
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	77.8	80.4	107.4	97.1
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	38.7	38.1	38.5	41.7
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	10.2	9.1	8.7	8.1
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	117.5	122.6	131.6	129.3
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	4.9	4.3	4.6	0.0

* Janë konsideruar të hyrat neto para taksës.

Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)

Tabela 2. Bilancet e gjendjes së bankave komerciale, dhjetor 2014, në milionë euro

Procredit Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	159.8	Bilanci nga bankat tjera	0.3
Bilanci me bankat komerciale	112.42	Depozitat	678.3
Letrat me vlerë	94.5	Huamarrjet tjera	-
Kreditë	443.7	Detyrimet tjera	47.8
Asetet fikse	15.3	Borxhi i ndërvarur	14.5
Asetet tjera	7.5	Mjetet vetanake	92.3
GJITHSEJ ASETET	833.2	GJITHSEJ DETYRIMET	833.2

Burimi: BQK (2015)

Raiffeisen Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	76.0	Bilanci nga bankat tjera	6.2
Bilanci me bankat komerciale	85.0	Depozitat	603.1
Letrat me vlerë	142.8	Huamarrjet tjera	0.5
Kreditë	471.8	Detyrimet tjera	66.1
Asetet fikse	6.9	Borxhi i ndërvarur	19.0
Asetet tjera	5.6	Mjetet vetanake	93.2
GJITHSEJ ASETET	788.0	GJITHSEJ DETYRIMET	788.0

Burimi: BQK (2015)

Banka për Biznes

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	26.3	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	4.3	Depozitat	103.0
Letrat me vlerë	7.2	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	80.0	Detyrimet tjera	7.3
Asetet fikse	0.8	Borxhi i ndërvarur	1.8
Asetet tjera	2.2	Mjetet vetanake	8.8
GJITHSEJ ASETET	120.9	GJITHSEJ DETYRIMET	120.9

Burimi: BQK (2015)

Banka Ekonomike

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	18.7	Bilanci nga bankat tjera	0.5
Bilanci me bankat komerciale	7.6	Depozitat	154.5
Letrat me vlerë	28.0	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	120.8	Detyrimet tjera	13.8
Asetet fikse	6.7	Borxhi i ndërvarur	1.0
Asetet tjera	1.6	Mjetet vetanake	13.6
GJITHSEJ ASETET	183.4	GJITHSEJ DETYRIMET	183.4

Burimi: BQK (2015)

Banka Kombëtare Tregtare

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	37.0	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	32.5	Depozitat	211.0
Letrat me vlerë	49.2	Huamarrjet tjera	10.0
Kreditë	127.5	Detyrimet tjera	18.4
Asetet fikse	3.6	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	2.7	Mjetet vetanake	13.0
GJITHSEJ ASETET	252.5	GJITHSEJ DETYRIMET	252.5

Burimi: BQK (2015)

NLB Prishtina

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	54.5	Bilanci nga bankat tjera	1.0
Bilanci me bankat komerciale	93.6	Depozitat	401.7
Letrat me vlerë	49.2	Huamarrjet tjera	3
Kreditë	280.9	Detyrimet tjera	36.7
Asetet fikse	12.6	Borxhi i ndërvarur	-
Asetet tjera	2.5	Mjetet vetanake	51.4
GJITHSEJ ASETET	493.3	GJITHSEJ DETYRIMET	493.3

Burimi: BQK (2015)

TEB Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	60.5	Bilanci nga bankat tjera	5.0
Bilanci me bankat komerciale	7.4	Depozitat	312.0
Letrat me vlerë	7.3	Huamarrjet tjera	-
Kreditë	311.9	Detyrimet tjera	30.3
Asetet fikse	5.1	Borxhi i ndërruarur	11
Asetet tjera	2.8	Mjetet vetanake	36.6
GJITHSEJ ASETET	394.9	GJITHSEJ DETYRIMET	394.9

Burimi: BQK (2015)

Komercijalna Banka

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	5.5	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	47.6	Depozitat	48.5
Letrat me vlerë	0.0	Huamarrjet tjera	1
Kreditë	3.6	Detyrimet tjera	1.2
Asetet fikse	0.0	Borxhi i ndërruarur	0.0
Asetet tjera	1.0	Mjetet vetanake	7.1
GJITHSEJ ASETET	57.8	GJITHSEJ DETYRIMET	57.8

Burimi: BQK (2015)

Türkiye İş Bankası

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	8.9	Bilanci nga bankat tjera	18.1
Bilanci me bankat komerciale	0.3	Depozitat	11.1
Letrat me vlerë	5.6	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	20.7	Detyrimet tjera	0.4
Asetet fikse	0.9	Borxhi i ndërruarur	0.0
Asetet tjera	0.3	Mjetet vetanake	7.1
GJITHSEJ ASETET	36.6	GJITHSEJ DETYRIMET	36.6

Burimi: BQK (2015)

Tabela 3.1. Pasqyra e korporatave financiare - asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto								Kërkesat e brendshme								
	Kërkesat ndaj jorezidentëve	prej të cilave:						Minus: detyrime ndaj jorezidentëve	Kërkesat ndaj qeverisë qendrore			Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	prej të cilave:				
		Ari monetar dhe DST-të	Depozita	Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kuota në FMN	Asetet dhe ekuitete tjera	Kërkesat ndaj qeverisë qendrore		Minus: detyrimet ndaj qeverisë qendrore	Depozita	Kreditë						
											Korp. tjera jofinan.		Ek. familjare				
2005 Dhjetor	827.3	890.9	---	422.6	242.4	---	145.3	63.6	348.9	-225.7	---	225.7	225.7	574.6	565.6	439.6	126.0
2006 Dhjetor	1,173.6	1,245.7	---	660.0	341.3	---	170.8	72.1	231.7	-475.0	---	475.0	475.0	706.6	694.3	548.2	146.1
2007 Dhjetor	1,622.4	1,704.6	---	955.0	408.9	---	175.4	82.3	124.5	-853.3	---	853.3	853.3	977.8	965.9	765.1	200.6
2008 Dhjetor	1,593.1	1,726.7	---	795.1	661.6	---	128.2	133.6	419.6	-871.8	---	871.8	871.8	1,291.5	1,276.8	995.7	281.0
2009 Dhjetor	1,700.5	2,036.2	60.3	910.1	724.5	64.3	144.3	335.7	571.5	-846.3	---	846.3	846.3	1,417.8	1,396.1	1,052.3	343.5
2010 Dhjetor	1,957.5	2,387.7	64.0	1,257.8	525.2	68.5	269.3	430.2	766.8	-824.8	---	824.8	824.8	1,591.6	1,568.3	1,127.7	434.2
Mars	2,027.1	2,456.6	61.8	1,250.7	586.5	66.2	294.0	429.5	734.3	-913.5	---	913.5	913.5	1,569.9	1,542.6	1,181.2	438.8
Qershor	1,988.0	2,421.3	60.9	1,171.3	640.0	65.4	293.9	433.3	840.1	-905.2	---	905.2	905.2	1,745.3	1,716.2	1,233.3	482.1
Shtator	2,108.2	2,511.5	63.3	1,297.5	539.1	68.0	332.7	403.3	862.2	-905.5	---	905.5	905.5	1,767.7	1,740.8	1,235.1	504.2
2011 Dhjetor	2,067.8	2,446.0	65.1	1,359.4	230.0	70.1	533.1	378.2	987.5	-798.4	---	798.4	798.4	1,785.8	1,785.8	1,242.1	514.6
Mars	2,087.9	2,449.5	63.8	1,179.7	346.9	68.8	580.9	361.6	1,000.8	-788.9	29.9	818.8	818.8	1,789.7	1,762.0	1,238.7	521.1
Qershor	2,081.2	2,445.1	66.4	1,257.2	239.1	71.9	598.7	363.9	1,057.1	-801.1	29.9	831.0	831.0	1,858.3	1,832.9	1,281.9	548.6
Shtator	2,301.6	2,716.8	65.0	1,129.0	598.8	70.7	622.1	415.1	985.7	-848.8	73.6	922.3	922.3	1,834.5	1,809.6	1,260.9	546.3
2012 Dhjetor	2,337.1	2,773.4	63.3	1,260.7	486.0	68.8	666.5	436.3	1,079.9	-764.7	73.8	838.5	838.5	1,847.2	1,819.4	1,271.3	546.3
Mars	2,376.5	2,821.3	63.3	1,189.5	515.7	69.0	734.5	444.8	1,112.0	-751.8	73.9	825.7	825.7	1,863.8	1,838.7	1,287.5	549.8
Qershor	2,352.5	2,793.0	61.9	1,008.6	646.2	67.8	777.9	440.4	1,110.8	-798.6	110.9	909.5	909.5	1,909.4	1,882.0	1,314.8	566.1
Shtator	2,541.1	3,003.2	60.7	982.4	826.8	66.8	816.9	462.1	1,095.2	-783.8	130.8	914.6	914.6	1,879.0	1,853.2	1,291.5	560.6
2013 Dhjetor	2,558.5	3,014.1	59.6	1,143.6	818.7	65.9	651.2	455.6	1,263.4	-620.8	153.2	774.0	774.0	1,884.2	1,859.9	1,291.1	567.7
Mars	2,592.4	3,060.7	59.5	1,104.0	899.8	66.2	660.9	468.2	1,286.9	-620.7	190.1	810.8	810.8	1,907.7	1,883.2	1,313.4	568.5
Qershor	2,589.6	3,001.1	59.9	1,045.1	803.3	66.9	752.4	411.5	1,294.6	-580.4	230.4	810.8	810.8	1,973.4	1,949.3	1,351.3	597.0
Shtator	2,700.7	3,158.9	61.6	1,243.8	574.9	69.1	967.4	458.2	1,373.8	-589.1	227.0	816.1	816.1	1,962.9	1,939.2	1,325.5	613.4
2014 Dhjetor	2,648.4	3,113.3	62.5	1,414.7	315.7	70.4	1,024.4	464.9	1,507.4	-488.5	247.4	735.9	735.9	1,995.8	1,971.5	1,331.8	639.0

Burimi: BQK (2015)

Tabela 3.2. Pasqyra e korporatave financiare - detyrimet

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Depozitat									Kreditë	Rezerva teknike të sigurimit			Asetet dhe ekuitete tjera	Zëra tjerë (neto)
	Depozitat e transferueshme	prej të cilave:			Depozitat tjera	prej të cilave:			Ek. neto i ek. familjare në fondet e pens.		Pagesa e premive dhe rezervave				
		Korporat publike jofinanciare	Korporat tjera jofinanciare	Ek. familjare		Korporat publike jofinanciare	Korporat tjera jofinanciare	Ek. familjare							
2005 Dhjetor	830.6	315.0	67.6	76.8	155.5	515.6	181.3	33.7	298.9	3.0	174.5	152.4	22.1	165.8	2.2
